


RAPORT MONITORIMI

AGJENDA KOMBËTARE PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE 2021-2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MIRËQENIES SOCIALE



Dokumenti është hartuar me asistencën teknike të UNICEF në Shqipëri. Kjo ndërmarrje është realizuar në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas” (LNB), financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

RAPORT MONITORIMI

**AGJENDA KOMBËTARE
PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE
2021-2026**

SHKURTIME

AKSK	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike
AKDF	Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve
AMA	Autoriteti i Mediave Audio-vizive
AP	Avokati i Popullit
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
ASPSKN	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
DPAP	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
ELP	Edukimi Ligjor Publik
EKFH	Edukimi dhe Kujdesi në Fëmijërinë e Hershme
HPV	Virusi Human Papiloma
INSTAT	Instituti i Statistikave
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
KAP	Kujdestaria Alternative Profesionale
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KKBDF	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve
KKDMF	Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve
LNB	Leave no one behind (Askush të mos mbetet pas)
MA	Ministria e Arsimit
MD	Ministria e Drejtësisë
MICS	Anketa e Grupimit të Treguesve të Shumëfishtë
MM	Ministria e Mbrojtjes
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
NE	Ndihma Ekonomike
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
NJVNR	Njësia e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave
NJVV	Njësia e Vetëqeverisjes Vendore
NJVKSH	Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetsor
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJF	Organizatat Jofitimprurëse
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
OSHMA	Ofrues të Shërbimeve Mediatike Audiovizive
PMF	Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve
PAK	Personat me Aftësi të Kufizuar
QKEV	Qendra Kombëtare për Edukimin në Vazhdim
QKSHM	Qendra Kombëtare për Shëndetin Mendor
QSHA	Qendra e Shërbimeve Arsimore
SMIP	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar
SHMFF	Shërbimi Mbështetës për Fëmijën dhe Familjen
SHPS	Shërbimi Psiko-Social
SHQK	Shkolla Qendra Komunitare
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
WVA	World Vision Albania
ZVAP	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 (AKDF) synon të krijojë një mjedis mbështetës për rritjen dhe mirëqenien e fëmijëve, duke u siguruar atyre akses në shërbime cilësore, mundësi për pjesëmarrje të mirëfilltë, mbështetje për prindërim pozitiv, mbrojtje nga çdo formë dhune dhe zhvillim të sigurt në epokën digjitale.

AKDF-ja parashikon që ndikimi i saj të reflektohet në cilësinë e jetës së fëmijëve dhe adoleshentëve, si në familje ashtu edhe në mjedise të tjera sociale.

Ky raport paraqet ecurinë e zbatimit të Agjendës përgjatë periudhës 2021–2025, duke analizuar progresin disaveçar të institucioneve përgjegjëse dhe partnerëve të tyre në realizimin e masave të përcaktuara. Struktura e raportit është konceptuar për të ofruar të dhëna të detajuara për secilin objektiv të AKDF-së, si edhe një përmbledhje të rezultateve kryesore sipas shtyllave strategjike.

Në përmbajtjen e saj, AKDF-ja përfshin 20 masa, 185 aktivitete dhe 20 tregues strategjikë të rezultateve, të cilat synojnë arritjen e 9 objektivave specifike, të ndara në kuadër të katër qëllimeve strategjike:

1. Qeverisje e mirë për respektimin, mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve.
2. Eliminimi i të gjitha formave të dhunës dhe forcimi i mbrojtjes së fëmijëve.
3. Krijimi i sistemeve dhe shërbimeve miqësore për fëmijët dhe adoleshentët.
4. Promovimi i të drejtave të fëmijëve në hapësirën digjitale.

Masat dhe aktivitetet kanë karakter ndërsektorial, duke adresuar parandalimin, mbrojtjen, ofrimin e shërbimeve afatgjata e miqësore, si dhe

promovimin e të drejtave të fëmijëve në raport me normat dhe praktikat sociale. Raporti është përgatitur me kontributin e 17 institucioneve (nga të cilat 13 institucione shtetërore, 4 institucione të pavarura), si edhe 51 njësi të vetëqeverisjes vendore (NJVV).

Gjatë periudhës së raportimit, Shqipëria ka shënuar progres të dukshëm në fushën e të drejtave të fëmijëve, veçanërisht në aspektin legjislativ dhe politik, përmes reformave ligjore e institucionale që e kanë afruar më tej vendin me standardet ndërkombëtare.

Mbledhja dhe përdorimi i të dhënave/statistikave për fëmijët përbën një element thelbësor në hartimin dhe monitorimin e politikave publike. Në vitin 2021, ASHDMF prezantoi një platformë digjitale që mundëson publikimin e të dhënave të mbledhura nga institucionet përkatëse, duke i paraqitur ato në formën e 61 treguesve specifikë për realizimin e të drejtave të fëmijëve. Një risi e rëndësishme është se Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026, e ka përfshirë për herë të parë portretizimin e statistikave për fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë si një komponent kryesor të statistikave sociale.

Proçesi për ngritjen dhe funksionimin e NJMF-ve dhe PMF-ve është kompleks dhe përfshin një sërë hallkash e aktorësh, bazuar në ligje, udhëzime dhe rregullore të pushtetit qendror

dhe lokal. Duke konsideruar se ngritja e NJMF-ve është hapi i parë, më i rëndësishëm dhe më i domosdoshëm, nga ku fillon edhe implementimi i ligjit apo mbrojtja e fëmijëve, ASHDMF ka ndërmarrë një proces me bashkitë në vend për ti nxitur ato në mënyrë të vazhdueshme për të ndikuar në vendimmarrjen e kryetarëve të bashkive për të vlerësuar ngritjen dhe funksionimin e PMF si një detyrim ligjor, por edhe si domosdoshmëri për mbështetjen e fëmijëve dhe komuniteteve që ata përfaqësojnë. Në fund të këtij procesi, i cili zgjati në kohë dhe ishte sfidues, numërohen 370 PMF.

Mekanizmat e mbrojtjes së fëmijëve përbëjnë një element kyç për garantimin e të drejtave të tyre. Në të gjithë vendin, gjatë periudhës raportuese kanë operuar 370 Punonjës të Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF), të cilët menaxhojnë rastet sipas procedurave të përcaktuara në kuadrin rregullator. Sipas ASHDMF-së¹, përgjatë periudhës 2021-2025 janë menaxhuar 4,447 raste të reja të fëmijëve të identifikuar në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje apo viktimë të dhunës seksuale. Në vijim paraqiten të dhënat e detajuara për rastet e menaxhuara, rastet e reja dhe ato të fëmijëve viktimë të dhunës seksuale. (Shih tabela 1).

Për sa i përket mbrojtjes dhe mbështetjes së fëmijëve nga dhuna seksuale, janë ngritur dy qendra me shërbime emergjente për fëmijët viktimë/të mbijetuar të abuzimit seksual dhe formave të tjera të rënda të dhunës, në bashkitë Fier dhe Shkodër. Qendrat funksionojnë me standarde për ofrimin e shërbimeve të miratuara për këtë target-grup fëmijësh.

Shqipëria ka bërë progres në ofrimin e shërbimeve të specializuara sociale, sa më pranë komunitetit, me fokus fëmijët. Nëpërmjet Fondit Social, instrumentit të mbështetjes financiare për nivelin vendor, deri në vitin 2025, janë krijuar 84 Shërbime të Kujdesit Social (ndër të cilat 32 janë për fëmijë), duke përfutur 59 bashki dhe 8 qarqe, me një financim total prej 1.5 miliardë lekësh, duke mbështetur mbi 62,744 individë. Shuma e mbështetjes financiare nga Fondi Social është rritur me 13% në vitin 2025, krahasuar me vitin 2024, dhe është trefishuar në krahasim me vitin 2019.

Reforma e deinstitutionalizimit është shoqëruar me transformimin e shërbimeve rezidenciale në shërbime të kujdesit alternativ komunitar, ku prioritet kanë patur programet e fuqizimit ekonomik dhe social të familjes së fëmijëve në institucione.



TABELA 1: NUMRI I FËMIJËVE TË IDENTIFIKUAR NË RREZIK DHE/OSE NË NEVOJË PËR MBROJTJE, TË PËRFSHIRË NË MENAXHIM RASTI

Viti	Numri i rasteve të menaxhuara në total	Numri i rasteve të reja	Raste viktimë të dhunës seksuale
2021	2389	1047	73
2022	2496	987	73
2023	2163	1027	50
2024	2451	1386	59
2025*			
Totali 2021-2024	Nuk ka total	4447	

* Shifrat për vitin 2025 publikohen në fillim të vitit 2026

1. Shënim: Sipas të dhënave të ASHDMF-së, rastet e fëmijëve të menaxhuara nuk mbyllen menjëherë, por mbarten dhe monitorohen në vazhdimësi. Për këtë arsye, është e rëndësishme që shifrat e rasteve të menaxhuara ndër viteve janë më të larta, pasi ka mbivendosje të shifrave.

Është punuar për transformimin, në katër bashki Korçë, Vlorë, Durrës dhe Shkodër, të shërbimeve rezidenciale për fëmijë 0-5 vjeç, në katër shërbime të reja komunitare "Shërbime Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen," për të parandaluar vendosjen në përkujdes rezidencial të fëmijëve.

Bonusi i bebes, ka qenë një politikë sociale e suksesshme në raport me demografinë dhe rritjen e lindshmërisë, duke kontribuar edhe në politikën universale për të gjitha familjet. Nga vitit 2019 e deri në fund të vitit 2024 janë përfituar 231,565 bonuse të bebes, ndërsa për periudhën Janar- Qershor 2025, janë përfituar gjithsej 10679 bonuse të bebes.

Programi i ndihmës ekonomike është skema kryesore e mbështetjes sociale në formë cash për familjet e varfra në Shqipëri. Rreth 62,000 fëmijë përfitojnë nga kjo skemë. Gjatë këtyre viteve, për të mbështetur më shumë familje me fëmijë, masat e përfitimit për familjet me tre apo më shumë fëmijë janë dyfishuar, duke përfituar 15,000 familje me 3 apo më shumë fëmijë. Masa e përfitimit për gratë, kryefamiljare (familje me fëmijë) gjithashtu është dyfishuar; prej saj përfituan 5,700 gra. Për fëmijët pa kujdes prindëror, masa e përfitimit është trefishuar, duke përfituar 1,220 fëmijë. Për të mbështetur gratë e papuna, nënat me 3 apo më shumë fëmijë të mitur, shteti mundëson subvencionimin 100% të sigurimeve sociale dhe kontributeve shëndetësore bazuar në pagën minimale. 9,200 gra të papuna kanë përfituar nga kjo politikë.

Një mbështetje të posaçme, qeveria shqiptare jep për fëmijët e atyre prindërve, të cilët kanë sakrifikuar jetën e tyre në krye të detyrës duke ndërmarrë një akt vetëmohimi apo patriotizmi, në përpjekje për mbrojtjen e jetës së individit, të mbrojtjes së pronës publike, si pasojë e kryerjes me përgjegjshmëri të detyrës dhe ushtrimit të profesionit në kushte të jashtëzakonshme. Me vendim të Komisionit Qendror të Statusit "Fëmijë në përkujdesje të Republikës," kanë përfituar statusin 22 fëmijë.

Qeveria e Shqipërisë ka ndërmarrë reformën e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar bazuar në modelin bio-psiko-social, e cila po

zbatohet në të gjithë vendin që nga fillimi i vitit 2023. Zbatimi i skemës së re përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt garantimit të një qasjeje më të drejtë dhe të personalizuar në mbështetjen për personat me aftësi të kufizuara.

Programet shëndetësore për fëmijët kanë qenë një komponent thelbësor i mbrojtjes së të drejtave të tyre gjatë periudhës 2021–2025, duke u fokusuar në parandalim, kujdes bazë dhe shërbime të integruara sociale e shëndetësore të ofruara në qendrat e kujdesit parësor. Këto programe kanë përfshirë kontrollin e shikimit, kujdesin dentar, imunizimin kombëtar dhe shërbimet shëndetësore në shkollë. Nga viti 2022 deri në fund të qershorit 2025, kanë përfituar gjithsej:

- ▶ 314,746 fëmijë nga Programi Kombëtar i Shikimit (265,584 gjatë 2022–2024 dhe 49,162 gjatë janar–qershor 2025);
- ▶ 686,448 fëmijë nga programi i kujdesit dentar për grupmoshën 6–14 vjeç (603,622 gjatë 2022–2024 dhe 82,826 gjatë janar–qershor 2025)².

Në të njëjtën periudhë, të gjithë fëmijët kanë përfituar nga Programi Kombëtar i Vaksimit, i cili përfshin edhe vaksinën HPV për vajzat adoleshente. Vetëm në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, 4,025 vajza kanë marrë vaksinën HPV. Në kuadër të zhvillimit të fëmijërisë së hershme dhe arsimimit të fëmijëve, shteti shqiptar ka vendosur në funksionim një sërë mekanizmesh me fokus parësor përfshirjen e fëmijëve më të marginalizuar. Mes të tjerave, mund të përmenden rezultate si:

- ▶ Është miratuar Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026, si edhe Plani Kombëtar i Veprimit për Fuqizimin e Mekanizmave të Parandalimit të çdo Forme Dhune e Bullizmi për Sigurinë në Institucionet Arsimore Parauniversitare.
- ▶ Në bashkëpunim me UNICEF Shqipëri janë hartuar manuale, module dhe broshura për drejtuesit e shkollave, mësuesit, nxënësit dhe prindërit.

2. Një fëmijë mund të ketë marrë më tepër se një herë shërbim gjatë viteve të raportuara.

- Është ngritur një sistem për identifikimin, parandalimin dhe raportimin e dhunës e bullizmit në shkolla, i shoqëruar me fushata ndërgjegjëse dhe miratimin e akteve ligjore për të mos lejuar punësimin e mësuesve të dënuar për krime ndaj të miturve.
- Numri i oficerëve të sigurisë është rritur nga 150 në 220 në vitin 2022 dhe 222 në vitin 2024, duke përfshirë shkollat 9-vjeçare me mbi 700 nxënës. Oficerët trajnohen dhe certifikohen nga Akademia e Sigurisë.
- Të gjitha shkollat janë të mbuluara me shërbim psikosocial, me 595 kabinete funksionale dhe një raport prej 1 punonjësi për 300–499 nxënës. Vetëm në vitin shkollor 2023–2024 janë zhvilluar 16,891 aktivitete ndërgjegjëse me nxënës, 3,110 me mësues dhe 2,389 me prindër.
- Në vitin shkollor 2024–2025 janë hapur 270 klasa përgatitore me gjithsej 5,563 nxënës. Në total, 85% e fëmijëve që fillojnë klasën e parë kanë ndjekur kopshtin/grupin përgatitor.
- Të gjithë mësuesit e parashkollorëve janë trajnuar (100%) për zbatimin e kurrikulës me kompetenca dhe për metodologjinë e të nxënësve me përqendrim tek fëmijët, përfshirë ata me aftësi të kufizuara.
- Numri i mësuesve ndihmës ka arritur në 2,266, duke mbuluar 5,233 nxënës me aftësi të kufizuara (AK) në arsimin bazë.
- Janë ngritur 291 klasa burimore për nxënësit

me AK dhe janë hartuar programe të posaçme mësimore e teknologjike për arsimin special. Është forcuar mbështetja financiare dhe logjistike: transport falas, tekste falas, si dhe pajisje didaktike e teknologjike.

- Janë ngritur 1,245 rrjete profesionale të mësuesve, të trajnuara për zbatimin e kurrikulës me kompetenca dhe praktika gjithëpërfshirëse. Në vitin 2024, 16,045 mësues kanë marrë trajnim për një modul dhe 7,046 për dy module.
- Në zbatim të planit të veprimit të “Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020–2025” Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) ka kryer disa trajnime dhe fushata sensibilizuese për promovimin e të drejtave të fëmijëve në botën digjitale. AKSK është institucioni i parë, që u angazhua për pilotimin e projektit global të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit dhe partneritetit me UNICEF Shqipëri “Krijimi i një mjedisi digjital të sigurt dhe fuqizues për fëmijët”.

Institucionet kanë raportuar përmes informacionit që kanë dhënë, mbi progresin e realizimit të 17 nga 20 treguesit strategjik¹. Kështu, raportimi në kuadër të treguesve të qëllimeve strategjike, qëndron në nivelin 85%. Prej tyre, rreth 95% janë realizuar plotësisht ose pjesërisht të realizuar.

Të dhënat e grumbulluara nga institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor, japin informacion për 170 aktivitete prej 185 aktiviteteve të parashikuara në AKDF, sipas ndarjes të paraqitur në tabelën 3.



TABELA 2. STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE STRATEGJIKË PËR PERIUDHËN 2021-2025 (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Total tregues (Nr. & %)	Plotësisht i realizuar	Pjesërisht i realizuar	I parealizuar
17	13	3	1
100%	77%	18%	5%

3. Kjo sqarohet në kapitullin e metodologjisë.



**TABELA 3. NIVELI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETEVE PËR PERIUDHËN 2021-2025
(NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)**

Numri i aktiviteve	Numri i aktiviteve të paraportuara	Numri i aktiviteve të raportuara
185	15	170
100%	8%	92%



**TABELA 4. STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE PËR PERIUDHËN 2021-2025
(NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)**


Total tregues (Nr. & %)	Plotësisht i realizuar	Pjesërisht i realizuar	I parealizuar
170	108	46	16
100%	64%	27%	9%

**NIVELI I RAPORTIMIT
TË AKTIVITETEVE**



170


TË RAPORTUARA



15

TË PARAPORTUARA

**STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE
PËR PERIUDHËN 2021-2025**



170 aktivitetet e raportuara nga institucionet qendrore dhe vendore, janë reflektuar sipas kategorive të paraqitura në tabelën 4.

Sa u përket parashikimeve financiare/buxhetore, raporti analizon shpenzimet faktike të periudhës 2021-2025 dhe synon të analizojë lidhjen që ekziston midis parashikimit të shpenzimeve buxhetore të AKDF-së dhe shpenzimeve faktike të kryera nga burimet e ndryshme të financimit. Rekomandimet prioritare:

- ▶ Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës duhet të ushtrojë një rol më aktiv në monitorimin e zbatimit të AKDF-së dhe në advokimin për rritjen e investimeve publike që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e fëmijëve.
- ▶ Në vijim të sugjerimeve të Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës dhe proceseve të "screening"-ut të BE-së, është i domosdoshëm rishikimi i Agjendës së të Drejtave të Fëmijëve përpara përfundimit të afatit aktual.
- ▶ Krijimi i mekanizmave më efektivë të bashkëpunimit ndërmjet arsimit, shëndetësisë, drejtësisë, policisë dhe shërbimeve sociale për të parandaluar dhe adresuar rastet e fëmijëve në rrezik ndaj dhunës dhe abuzimit.
- ▶ Institucionalizimi i mekanizmave, ku fëmijët mund të shprehin mendimet dhe prioritetet e tyre në proceset e politikë-bërjes dhe monitorimit të AKDF-së.
- ▶ Rritja e investimeve financiare në sektorët, që prekin jetën e fëmijëve duhet të mbetet prioritet. Për mbulim të plotë të masave të AKDF-së, kërkohet mobilizimi i burimeve të reja dhe një alokim i qëndrueshëm i fondeve nga buxheti i shtetit dhe partnerët ndërkombëtarë. Krijimi i linjave të dedikuara buxhetore për fëmijët, si në nivel qendror ashtu edhe vendor, është thelbësor.
- ▶ Është i nevojshëm përmirësimi i sistemit të mbledhjes dhe analizës së të dhënave për fëmijët. Institucionet duhet të forcojnë

kapacitetet dhe transparencën për raportimin e të dhënave të disagreguara sipas moshës, gjinisë, etnisë, aftësisë së kufizuar dhe faktorëve të tjerë të ndjeshmërisë, për të mundësuar planifikimin dhe monitorimin më efektiv të politikave. Është e domosdoshme të rritet gama e treguesve për fëmijët si nga burimet administrative edhe ato të bazuara në anketa.

- ▶ Rekomandohet hartimi dhe integrimi i programeve gjithëpërfshirëse për prindërimin pozitiv në të gjitha nivelet e shërbimeve, duke përfshirë trajnimin dhe certifikimin e profesionistëve që punojnë me fëmijë dhe familje në nivel lokal.
- ▶ Është i domosdoshëm rishikimi i Kodit të Familjes dhe Kodit Penal për të reflektuar parimin e interesit më të mirë të fëmijës, për të forcuar mbrojtjen ligjore ndaj fenomeneve si martesë e hershme dhe për të institucionalizuar rolin e njësive të mbrojtjes së fëmijëve brenda sistemit ligjor.
- ▶ Zbatimi i planit për transformimin e shërbimeve rezidenciale duhet të shoqërohet me ngritjen e shërbimeve të reja komunitare në të gjitha bashkitë, në përputhje me standardet e mbrojtjes së fëmijës dhe në bazë të një modeli të unifikuar të mbështetur nga niveli qendror.
- ▶ Është thelbësore vendosja e standardeve dhe zhvillimi i shërbimeve të specializuara për fëmijët e huaj të pashoqëruar dhe të ndarë, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe me nevojat specifike të identifikuar në Shqipëri.
- ▶ Zbatimi i masave për sigurinë e fëmijëve në internet, duke përfshirë edukimin digjital të fëmijëve, prindërve dhe mësuesve, si dhe forcimin e kapaciteteve të institucioneve për të identifikuar dhe adresuar abuzimin online.



HYRJE

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 (AKDF) është hartuar në emër të qeverisë shqiptare nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, duke përfshirë kontributin e ministrive të linjës, njërive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve të pavarura.

Dokumenti është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 659, datë 3.11.2021, dhe përfaqëson angazhimin institucional për krijimin e një mjedisi mbështetës e gjithëpërfshirës për mirëqenien e fëmijëve. Vizioni i AKDF-së është të garantojë akses në shërbime cilësore, të promovojë pjesëmarrjen aktive të fëmijëve, prindërimin pozitiv, eliminimin e çdo forme dhune dhe zhvillimin e sigurt në botën digjitale. AKDF-ja u hartua nën vëmendjen e dokumenteve të mëposhtme:

- Raporti i Monitorimit i Agjendës së Fëmijëve 2021-2022;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Raporti periodik i pestë dhe i gjashtë i Shtetit mbi zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës;
- Raporti kombëtar i paraqitur në përputhje me paragrafin 5 të aneksit të rezolutës 16/21 të Këshillit të të Drejtave të Njeriut, Rishikimi Universal Periodik i Shqipërisë;
- Strategjia e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijës;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030 (SKZHI II);
- Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030.

AKDF-ja përcakton katër qëllime strategjike:

- (i) Qeverisja e mirë në respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijëve;
- (ii) Eliminimi i të gjitha formave të dhunës dhe mbrojtja e fëmijëve;

- (iii) Sistemet dhe shërbimet miqësore për fëmijë dhe adoleshentë;
- (iv) Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale.

Në përputhje me Ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, MSHMS-ja është institucioni përgjegjës për hartimin dhe monitorimin dhe zbatimin e ecurisë së zbatimit të AKDF-së 2021-2026, mbështetur nga ASHDMF-ja. Procesi i monitorimit është përcaktuar si detyrim edhe nga VKM-ja nr. 659, datë 3.11.2021 për miratimin e AKDF-së 2021-2026.

Procesi i monitorimit të AKDF-së u realizua sipas metodologjisë së konfirmuar nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (IPSIS)”, i cili, ndër të tjera, është sistemi kryesor për monitorimin e performancës së arritur kundrejt politikave dhe objektivave të planifikuara në dokumentet strategjike. MSHMS/ASHDMF-ja, me kontributin e Grupit Ndërinstitucional të Punës, ngritur me urdhrin e ministrit të MSHMS-së⁴, dhe mbështetjen teknike të UNICEF-it në Shqipëri, realizuan hartimin e raportit të monitorimit të AKDF-së për vitet 2021-2025.

Bazuar në detyrimin ligjor, raporti i monitorimit, i hartuar nga MSHMS/ASHDMF-ja dhe grupi ndërinstitucional, do të paraqitet pranë Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

4. Urdhri nr. 519, datë 23 shtator 2020, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2025” i Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.



METODOLOGJIA

Raporti i monitorimit të AKDF-së paraqet analizën e rezultateve të arritura dhe shpenzimeve financiare të kryera për periudhën 2021–2025. Raporti paraqet një pasqyrë të progresit të deritanishëm, si edhe priren për zbatimin dhe arritjen e objektivave të vendosura deri në vitin 2025.

Në përgjigje të detyrimit për monitorim dhe raportim të AKDF-së, MSHMS-ja e mbështetur nga UNICEF-i në Shqipëri, ndërmoi hapat e mëposhtëm për të realizuar hartimin e këtij raporti:

- dakordësimi i metodologjisë së hartimit të raportit me Grupin Ndërinstitucional të Punës;
- hartimi i instrumenteve të përshtatura për çdo institucion raportues për masat/aktivitetet, për mbledhjen e informacionit të detajuar për çdo masë dhe çdo tregues rezultati, duke përfshirë edhe të dhëna buxhetore për periudhën 2021-2025. Këto instrumente morën parasysh instrumentet e IPSIS-it;
- rishikimi i raporteve e studime të publikuara të lidhura me fushën;
- konsultimi me fëmijët;
- hartimi i draftit të parë të raportit të monitorimit të AKDF-së;
- konsultimi me ministrinë e linjës dhe institucionet përgjegjëse për draftin fillestar;
- përmbyllja e raportit të monitorimit përmbledhës 2021-2025.

MBLEDHJA E INFORMACIONIT MBI MASAT DHE AKTIVITETET

Për të raportuar mbi zbatimin e masave të parashikuara në AKDF, u hartua një instrument, i cili identifikon të gjitha aktivitetet e planifikuara për vitet 2021-2026. Instrumenti i kërkon secilit

institucion të identifikuar në AKDF të raportojë mbi zbatimin e masave/aktiviteteve, përfshirë informacionin mbi statusin aktual të realizimit/zbatimit të aktivitetit, çfarë është realizuar konkretisht, sfidat dhe problematikat e ndeshura gjatë zbatimit, aktorët e përfshirë në zbatim, si edhe informacion mbi shpenzimet e kryera.

Instrumenti lejon që statusi/ecuria e zbatimit të aktivitetit, të raportohet sipas disa kategorive (*i realizuar, pjesërisht i realizuar dhe i parealizuar*).

Legjenda e vlerësimit të progresit të zbatimit të aktiviteteve

Legjenda

Shpjegimi

Plotësisht i realizuar

Objekti i aktivitetit është realizuar plotësisht, siç përcaktohet në planin e veprimit.

Pjesërisht i realizuar

Objekti i aktivitetit i është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100%.

I parealizuar

Objekti i aktivitetit është realizuar nën shkallën 50%.

SFIDAT NË RAPORTIM:

- ▶ Institucionet qendrore dhe vendore kanë raportuar për zbatimin e masave dhe aktiviteteve në formë të pjesshme, duke krijuar vështirësi në paraqitjen reale të statusit të realizimit ose jo të aktiviteteve. Vështirësi më të mëdha janë identifikuar në raportimin në nivel vendor, ku vetëm 51 nga 66 NJVV kanë raportuar informacion.
- ▶ Një pjesë e institucioneve përgjegjëse raportuese, kanë dhënë informacion jo të plotë për ecurinë e aktiviteteve, duke mos pasqyruar qasjen ndërsektoriale të realizimit të aktiviteteve, apo qenë transparente në vështirësitë e ndeshura në përmbushjen e masave.

MBLEDHJA E INFORMACIONIT MBI TREGUESIT

Një instrument i dedikuar mbledhi informacion mbi realizimin e treguesve. Informacioni mbi realizimin e treguesve u grupua sipas: a) rezultatit të treguesve në nivel qëllimesh strategjike; b) rezultatit të treguesve në nivel të objektivave specifike. Informacioni mbi treguesit e aktiviteteve u përfshi në raportimin e ecurisë së aktiviteteve dhe jo më vete.

Në tërësi AKDF-ja përmban 20 tregues të lidhur me 4 qëllimet strategjike dhe 36 tregues në nivel objektivash specifike. Për të mbledhur informacion mbi progresin e arritur të treguesve, u hartuan instrumente të dedikuara për secilin institucion përgjegjës.

SFIDAT NË RAPORTIM:

Ka tregues për të cilët raportimi nuk është i mundur, pasi institucionet nuk kanë investuar ende në matjen e tyre. Ata janë kategorizuar si të paraportuar. Për shembull, mes treguesve strategjikë, 3 nga 20 prej tyre bëjnë pjesë në këtë kategori, për arsyet më poshtë:

- ▶ Dy prej treguesve kanë si burim anketa të cilat nuk ndodhin në frekuencë vjetore;

kështu, për to, raportimi nuk pritet të ndodhë në këtë fazë raportimi. Këta tregues janë: 1. "Përqindja e fëmijëve (1-14 vjeç), të cilët kanë përjetuar ndëshkim fizik dhe/ose dhunë psikologjike nga prindërit/kujdestarët e tyre"; 2. Shkalla e përfundimit të arsimit (për të tria nivelet) (burimi: INSTAT/MICS). Për të dy treguesit, raportimi do të jetë i mundur me realizimin e MICS-it në vitin 2026.

- ▶ Për një tregues, "Fëmijë 0-17 vjeç në qendra rezidenciale me kapacitet maksimal prej 10 fëmijësh", raportimi nuk është i mundur për shkak të mungesës së metodologjisë së dakordësuar nga institucionet përgjegjëse për matjen e tyre.
- ▶ Për disa tregues, sidomos ato me burim njësitë e vetëqeverisjes vendore, raportimi i plotë ishte i varur nga informacioni i mbledhur nga të gjitha institucionet me detyrim raportimi. Për shkak se vetëm 51 nga 61 NJVV raportuan për këtë raport, u ndeshën vështirësi për pasqyrimin e realizimit të treguesve.

MBLEDHJA E INFORMACIONIT MBI SHPENZIMET FINANCIARE

Për raportimin e shpenzimeve, institucioneve përgjegjëse iu kërkua ky informacion:

- ▶ kostot treguese të planit të veprimit (në total dhe të shprehura në përqindje) për secilin aktivitet, masë, objektiv specifik dhe qëllim;
- ▶ shpenzimet faktike, të kryera nga të gjitha burimet e financimit (buxheti i shtetit dhe institucionet/organizatat partnere);
- ▶ shpenzimet e mbuluara deri në fund të vitit 2025 të krahasuara me kostot treguese (të shprehura në përqindje).
- ▶ Instrumenti i hartuar mundësoi grumbullimin e të dhënave sipas "Udhëzuesit metodologjik për raportet e performancës".

SFIDAT NË RAPORTIM:

- ▶ Institucionet përgjegjëse hasën vështirësi në raportimin e shpenzimeve faktike për masat dhe veprimtaritë, duke mos raportuar shpenzime faktike, as në total dhe as sipas burimeve të financimit. Për të vlerësuar shpenzimet faktike për masat dhe veprimtaritë plotësisht të realizuara dhe/ose pjesërisht të realizuara, u përdor një metodologji e tërthortë. Shpenzimet faktike u llogaritën dhe u raportuan mbështetur në raportimin mbi ecurinë e aktivitetit, rezultatet e arritura dhe përshkrimin e shpenzimeve (formati IPSIS).
- ▶ Ecuria e disa aktiviteteve, është raportuar jo vetëm nga institucioni përgjegjës, por dhe nga institucione partnere. Për të rritur saktësinë e raportimit, duhet që informacioni mbi ecurinë e masave dhe shpenzimet, të konsolidohet dhe të raportohet vetëm nga institucioni përgjegjës. Raportimi i së njëjtës veprimtari nga disa institucione, në disa raste krijon mbivendosje dhe mund të shoqërohet me pasaktësi në raportimin e shpenzimeve faktike.

KONSULTIMI ME FËMIJËT

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Ministrinë e Arsimit dhe Drejtoritë Arsimore në Bashkitë Sarandë, Kukës, Kamëz, Tiranë, Elbasan, dhe Pukë dhe mbështetjen e UNICEF Shqipëri, Save the Children dhe World Vision udhëhoqi procesin e konsultimit të AKDF-së me fëmijët.

Në kuadër të raportimit afatmesëm, në Korrik 2022, 150 vajza dhe djem, të moshës 11-17 vjeç morën pjesë në disa takime konsultuese, duke iu mundësuar të njohin më mirë dokumentin strategjik, por edhe të reflektojnë mbi qëllimet/objektivat kryesore strategjike më konkretisht dhe të japin kontributin e tyre mbi situatën aktuale, zbatueshmërinë e tyre dhe çfarë duhet bërë për realizimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Ky dokument shërbeu si një udhëzues për procesin e konsultimit të planifikuar me fëmijët si pjesë e raportit të monitorimit për zbatueshmërinë e AKDF-së në Shqipëri.

Për konsultimin me fëmijët, u ndoq një metodologji e dedikuar dhe e përshtatur me moshën e fëmijëve dhe që respekton interesat e tyre.



ZËRI I FËMIJËVE

Konsultimi i fëmijëve për zbatimin e masave të AKDF-së, ishte një proces i rëndësishëm, informues, vullnetar dhe pjesëmarrës, i realizuar në 3 qytete në shtrirje gjeografike të ndryshme (Sarandë, Kukës dhe Pukë, Kamëz, Tiranë, dhe Elbasan), lehtësuar nga profesionistë në bashkëpunim me ASHDMF-në dhe Drejtoritë Arsimore.

Më poshtë jepet një paraqitje e mendimeve të fëmijëve në lidhje me zbatimin e masave të çdo qëllimi strategjik të AKDF-së.

QEVERISJA E MIRË NË FUNKSION TË RESPEKTIMIT, MBROJTJES DHE PËRMBUSHJES SË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Fëmijët shprehën se është me rëndësi të jenë të informuar për të drejtat e tyre dhe të gjitha proceset apo vendimet që ndërmerren për të garantuar zbatimin e tyre. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e të drejtave të fëmijëve, duhet të bëjnë më tepër për të ndarë informacion të përshtatshëm dhe miqësor për moshën e tyre.

Fëmijët mendojnë se duhet të krijohen më tepër hapësira miqësore apo mjedise të përshtatshme, ku ata mund të shprehen më lirshëm në lidhje me idetë, të drejtat dhe mundësitë për të raportuar.

Fëmijët kërkojnë që të rriturit të njihen me Ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, dhe me Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, si dhe me institucionet që garantojnë zbatimin e tyre dhe monitorojnë realizimin e të drejtave të fëmijëve, të kërkojnë më tepër llogari dhe ta përcjellin këtë informacion tek fëmijët.



“Fushatat sensibilizuese, të cilat mund të zhvillohen nga vetë fëmijët/nxënësit në bashkëpunim me mësuesit dhe psikologën, në mënyrë që të arrihet një informim dhe ndërgjegjësim më i madh për sa i përket të drejtave tona...”

“Duhet që të kemi motivim dhe kurajë që të arrijmë qëllimet tona, aktivitetet e krijuara nga bashkia duhet të zgjerohen më tepër, që të ketë një pjesëmarrje më të lartë.”

Fëmijët shprehën se të rriturit duhet të bëjnë më shumë përpjekje për të përfshirë fëmijët në procese vendimmarrëse dhe për t'i bërë pjesëmarrës gjatë zbatimit të propozimeve të tyre, edhe pse ka përpjekje për ngritjen e shërbimeve që nxisin pjesëmarrjen dhe angazhimin e fëmijëve dhe të rinjve.



“Për sa i përket situatës aktuale në qytetin tonë në Pukë, disa gjëra janë realizuar, për shembull qendra rinore ku të gjithë kemi të drejtë të marrim pjesë, si dhe arsimimi pa dallim feje, krahine, besimi, gjuhe apo race; liria e shprehjes së mendimit pa cenuar të drejtat e të tjerëve”.

Fëmijët shprehën se shpesh, ata nuk e dinë që gëzojnë të drejtën e pjesëmarrjes dhe të dhënies së mendimeve dhe opinioneve në familje, shkollë apo komunitet.



“Disa gjëra që nuk janë realizuar, është se nuk na kanë përfshirë në disa aktivitete që ka organizuar bashkia, dhe nuk zbatohet e drejta e vendimmarrjes tek fëmijët dhe të rinjtë në qytetin tonë.”



“Të drejtat të cilat zbatohen në qytetin tonë, janë: E drejta e lirisë, e drejta e fjalës, e drejta e të pasurit një familje, e drejta e emrit. Të drejtat të cilat nuk zbatohen në qytetin tonë, janë: E drejta për të mos u diskriminuar, e drejta për të mos u trafikuar, e drejta për të mos u bullizuar, e drejta e një institucioni të posaçëm për fëmijët me aftësi të kufizuara. Për sa i përket kësaj të fundit, lidhet edhe me të drejtën për të mos u diskriminuar, pasi shumë fëmijë ose nxënës me aftësi të kufizuara ndihen të veçuar nga pjesa tjetër, pasi nuk kanë një institucion të veçantë që të kenë kujdes të plotë dhe të dedikuar.”

ELIMINIMI I TË GJITHA FORMAVE TË DHUNËS DHE MBROJTJA E FËMIJËVE

Prania e formave të ndryshme të dhunës raportohet nga fëmijët, nga një pjesë e mirë e tyre si një fenomen që është i pranishëm dhe për të cilin duhet të flitet më tepër dhe të bëhen më shumë përpjekje për ta pakësuar atë.



“Në shkollë ka raste që ndeshemi me forma të ndryshme të dhunës, si: dhuna verbale, psikologjike dhe fizike. Në shumicën e rasteve, dhuna verbale ndodh më shumë midis nxënësve, por ka raste që ushtrohet edhe nga mësuesit ndaj nxënësve”

Në rastet kur mësuesi ushtron dhunë ndaj nxënësit, duhet të bëjmë një njoftim të menjëhershëm tek drejtuesit e shkollës në mënyrë që të merren masa.”

“Dhuna në familje ushqehet nga presioni që prindërit ushqejnë tek fëmijët. Ajo vjen edhe si pasojë e pakënaqësive që prindërit kanë në jetën e tyre të përditshme, të cilat i tregojnë tek fëmijët e tyre.”

“Kur fëmijët lundrojnë në internet, ata ekspozohen ndaj shumë rreziqeve ku disa prej tyre ndikojnë në gjendjen e tyre morale dhe psikologjike.”

Fëmijët mendojnë se familja, shkolla, komuniteti ku jetojnë, njësia për mbrojtjen e fëmijëve dhe institucione të tjera, duhet të flasin më tepër për dhunën dhe adresojnë më mirë atë nëpërmjet veprimeve konkrete.



“Pjesa më e madhe e fëmijëve do të dëshironin ndryshime të shumta në ambientet e tyre shkollore për sa i përket bullizimit, dhunës fizike, diskriminimit, racizmit dhe pabarazisë. Në qoftë se do të kishte ndryshime me hapa të mëdhenj në këto drejtime, fëmijët do të kishin një jetë më paqësore sociale dhe do të ndiheshin më të sigurt në ambientet shkollore.”

“Dhuna në familje në ditët e sotme, është mjaft e përhapur si dukuri; Në qoftë se prindërit do të ndryshonin marrëdhëniet e tyre kundrejt fëmijëve të tyre, por gjithashtu ndaj gjithë fëmijëve të tjerë dhe nëse sillen më paqësisht dhe tregohen më të butë me fëmijët e tyre, atëherë fëmijët do të ndiheshin të sigurt dhe do të ruanin kujtime shumë të bukura nga fëmijëria e tyre.”

“Dhuna në botën digjitale, është një ndër format më të përhapura të dhunës, duke marrë parasysh zhvillimin e vullshëm të teknologjisë dhe efektin që kanë rrjetet sociale tek çdo fëmijë dhe i ri. Nëse prindërit do të kishin dhe do të tregonin më tepër kujdes me fëmijët e tyre dhe do t’u shpjegonin më tepër për botën e internetit, fëmijët do të ishin më kujdesshëm.”

“Bashkia dhe shkolla duhet të marrin masa konkrete për rastet e dhunës të cilësdo formë të jetë ajo”

Fëmijët raportojnë për dinamika shqetësuese marrëdhëniesh mes vetë fëmijëve, të cilat jo gjithmonë identifikohen apo trajtohen nga trupa mësimore.



“Ne do të donim vende të përshtatshme për fëmijët dhe të dimë ku të drejtohem kur ndihemi të dhunuar.”



“Asnje fëmijë nuk duhet të bullizohet, sidomos ata me aftësi ndryshe.”

Fëmijët shprehën se duhet ndarë më tepër informacion në lidhje me raportimin e formave të ndryshme të dhunës, dhe rolit të gjithsecilit për mbrojtjen e fëmijëve.



“Të kemi një psikolog funksional në shkollë, që të informohemi mbi tema të ndryshme dhe ku të kemi mundësi të shprehemi.”

“Ne vetë mund të kontribuojmë në zbatimin e të drejtave të fëmijëve, duke marrë pjesë në emisione të ndryshme.”

“Edhe organizatat e ndryshme që merren me të drejtat e fëmijëve, kanë një rol të rëndësishëm në parandalimin e shantazheve, kërcënimeve apo bullizimit online apo çdo forme dhune tjetër”

SISTEMET DHE SHËRBIMET MIQËSORE PËR FËMIJËT DHE ADOLESHENTËT

Fëmijët treguan gjatë takimeve konsultuese, se kanë nevojë për kushte më të mira të mësimdhënies, me mësues më profesionistë që mbështesin gjithëpërfshirjen dhe mundësi më të mira për fëmijët me aftësi të kufizuar.



“Në shkollat tona, ne hasim disa probleme, si për shembull vështirësia për të zhvilluar mësimin në klasa kolektive dhe mungesa e laboratorëve, kabineteve informatike dhe fushave sportive.

Këto probleme ndoshta nuk janë të tilla për shkollat e qytetit, por për të fshatrave po, dhe ne mendojmë se është e nevojshme, që shkollat e fshatrave ashtu si ato të qyteteve, të kenë të njëjtën infrastrukturë arsimore dhe investime.”



“Si zgjidhje e problemeve të lartpërmendura, ne mendojmë që duhet të bëhet shkrirja e klasave kolektive, ulja e numrit të nxënësve nëpër klasa, investim në ambientet shkollore, mësues specialistë për orën e Edukimit Fizik, si dhe pajisjen e shkollave me palestra dhe mjete sportive. Besoj se të gjitha shkollat që nuk i kanë këto gjëra, duan t’i kenë dhe duhet t’i kenë.”

“Ne nuk kemi profesionistë që të na këshillojnë për karrierën tonë.”

Fëmijët shprehën se kanë nevojë që në shkollë të zhvillohen aktivitete që mbështesin edukimin e tyre, përtej orarit mësimor me shumëllojshmëri aktiviteteve.



“Shkolla ka mungesë aktiviteteve që mund të bëhen pas orarit mësimor.”

“Për shumë nxënës, do të ishte shumë ndihmuese nëse në shkollë pas mësimit, të zhvillohej program passhkollor për detyrat e shtëpisë apo projekte, ku nxënësit mund të ndihmojnë njëri-tjetrin, por të ketë dhe mësues për të na mbështetur, pasi jo të gjithë fëmijët mund të ndihmohen për detyrat nga prindërit, por edhe vetë mund të kenë vështirësi”. (Pukë) Hapja e një qendre shëndetësore nëpër shkolla për të ofruar një shërbim multifunksional.

“Duhet të ketë programe më të mira për fëmijët me aftësi ndryshe të të gjitha moshave.”

Fëmijët theksojnë problemet e dhunës në shkolla. Ata shprehën se shkollat duhet të bëjnë më shumë për të bërë të disponueshëm informacionin lidhur me mbrojtjen e fëmijëve.



“Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere më shpesh nga psikologu dhe punonjësi social, lidhur me informimin e fëmijëve për internetin e sigurt dhe, fushata informimi

dhe dhënia e mesazheve sensibilizuese lidhur me dhunën që mund të përjetojnë fëmijët.”

“Të zhvillohen biseda informuese nga shkolla me prindërit për çështje të përdorimit të rrjeteve sociale, për kontrollin prindëror, për kufirin e moshës dhe për të nxitur bisedimin midis prindërve dhe fëmijëve për çështje që të dyja palët i konsiderojnë si të rëndësishme.”

“Psikologët dhe punonjësit socialë, mund të bëjnë më shumë orë dhe aktivitete informimi mbi dhunën dhe bullizimin.”
“Trajnimi i punonjësve të policisë”

Fëmijët përshkruajnë varfërinë si arsyen kryesore të përjashtimit, mungesës së aksesueshmërisë dhe diskriminimit në shkollë. Ata theksojnë ndikimin e varfërisë që i detyron fëmijët të punojnë dhe, në këtë mënyrë, të largohen nga shkolla, si dhe rrezikun për t'i çuar ata në krim apo sjellje të rrezikshme.



“Mundësitë për përfshirje në aktivitete të ndryshme nuk janë gjithmonë të njëjta si për një fëmijë që jeton në qytet dhe si për një tjetër që jeton në fshat, sepse mua për shembull, më duhet të marr furgonin dhe ta paguaj vetë që të vij nga shtëpia tek qendra kulturore dhe është diçka që më pengon të zhvilloj një X talent që mund të kem”.

PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NË BOTËN DIGJITALE

Fëmijët raportuan se zhvillimi drejt digjitalizimit ka vlera pozitive si: marrja e informacionit, komunikimi me të afërmit, krijimi i projekteve të ndryshme dhe argëtim, por kanë nevojë të informohen dhe të ndërgjegjësohen për pasojat dhe rreziqet e përdorimit të internetit të pasigurt, siç janë: ekspozimi ndaj fotove dhe videove të papërshtatshme, vjedhja e identitetit,

kërcënime dhe shantazhe, lojëra të ndryshme të rrezikshme, dhe mosmarrja e masave të nevojshme nga institucionet përkatëse për të rritur sigurinë e fëmijëve në internet.

Fëmijët raportuan disa vështirësi në zbatimin e të drejtës së tyre për zhvillim në botën digjitale:



“Mungesa e programeve të specializuara kompjuterike për fëmijët në shkollë dhe secili prej nesh duhet me patjetër të ketë një kompjuter apo laptop personal në shtëpi, që të punojë një detyrë të caktuar pasi shkolla nuk na e mundëson këtë gjë.”

“Mungesa e mësuesve të specializuar për lëndën e TIK.”

“Më shumë laboratorë të inforatikës nëpër shkolla.”

“Shumë shpesh po hasim rastet e bullizimit online, ose cyber-bullying ku fëmijët ngacmohen, shahen, tallen nga persona të ndryshëm në rrjetet sociale, por askush nuk na informon apo këshillon si të mbrohemi”.

“Prindërit duhet të jenë më të informuar, më të kujdesshëm dhe t'u shpjegojnë fëmijëve të tyre mbi rreziqet e botës digjitale, por nga ana tjetër, edhe fëmijët duhet të tregohen më të hapur me prindërit për t'i treguar rastet kur nuk ndihen të sigurt në internet ose rastet kur përjetojnë bullizim online.”

“Krijimi i hapësirave sportive dhe hapësirave të duhura ku ne mund të shfaqim talentet apo aftësitë tona dhe të organizohen konkurse për këto tema”.

Fëmijët shprehën se duhet të bëhen fushata informuese mbi faqet e palejueshme dhe ato që nuk janë të sigurta për fëmijët, si dhe duhet të zhvillojnë disa aktivitete ndërgjegjësuere lidhur me internetin e sigurt.

5

PROGRESI I AKTIVITETEVE

Qëllimi I.

Qeverisja e mirë në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve.

AKDF-ja ka si synim përmirësimin e qeverisjes në funksion të promovimit, respektimit dhe sigurimit të të drejtave të fëmijëve, përmirësimin e monitorimit të situatës së të drejtave të fëmijëve, si edhe ngritjen e mekanizmave pjesëmarrës të fëmijëve në vendimmarrjen e institucioneve qendrore dhe vendore.

Institucionet kanë raportuar të gjithë treguesit që lidhen me objektivat specifike të këtij qëllimi strategjik, dhe realizimi i tyre është i plotë.

Informacion është raportuar për 12 nga 19 aktivitetet që janë pjesë e qëllimit strategjik, prej të cilave vetëm 67% janë realizuar plotësisht.



TABELA 5. NIVELI I RAPORTIMIT TË TREGUESVE TË REZULTATIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Numri i treguesve	Të paraportuara	Të raportuara
4	0	4
100%	0%	100%



TABELA 6. STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE TË REZULTATIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Total tregues (Nr. & %)	Plotësisht i realizuar	Pjesërisht i realizuar	I parealizuar
4	4	0	0
100%	100%	0%	0%



TABELA 7. STATUSI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETEVE (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Nr. i masave	Nr. i aktiviteteve gjithsej	Nr. i aktiviteteve të raportuara	Përqindja e aktiviteteve të raportuara
4	19	12	63%




TABELA 8. STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË RAPORTUARA (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Statusi	Numri i statusit të aktiviteve	Përqindja e statusit të aktiviteve
Plotësisht i realizuar	5	42%
Pjesërisht i realizuar	7	58%
I parealizuar	0	

Gjatë periudhës 2021–2025 është realizuar në total 100% e shpenzimeve të planifikuara, me një shpërndarje që mbulon si aktivitetet e realizuara plotësisht ashtu edhe ato të realizuara pjesërisht.

TABELA 9. SHPENZIMET SIPAS STATUSIT TË REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR, VLERË DHE PËRQINDJE)

Statusi	Nr. i aktiviteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti shtetit	Partnerë
Plotësisht i realizuar	5	33,698,833	42.00%	33,698,83	100%	33.00%	67.00%
Pjesërisht i realizuar	7	46,536,483	58.00%	46,536,483	100%	33.00%	67.00%
I parealizuar	0						

Objektivi specifik I.1.

Institucione dhe mekanizma të fuqizuar në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve (4 masa dhe 19 aktivitete)

Treguesit kryesorë në nivel objektivash specifike nën këtë qëllim strategjik, janë:

→ rritja me 100% e buxhetit vjetor të ASHDMF-së në vitin 2023 [*i realizuar*]

→ numri i NJVV-ve (të paktën 2) me mekanizma/forume funksionale të përfshirjes së fëmijëve në vendimmarrje/numri i fëmijëve të përfshirë – [*i realizuar*, Dibër dhe Shkodër]

→ 100% e politikave të planeve qendrore dhe vendore të informuara nga analizat e të dhënave – [*i realizuar* nga të gjitha institucionet]

→ rritja (me 2% në vit) i ankesave dhe i çështjeve të trajtuara nga institucionet e pavarura të të drejtave të njeriut mbi të drejtat e fëmijëve – [*i realizuar*]

Në vijim, raportimi është organizuar sipas informacionit të mbledhur korrespondues me aktivitetet e listuara në këtë objektiv.

Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në forcimin e qeverisjes së mirë për të siguruar mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijëve, duke vendosur çështjet e fëmijëve në thelb të politikave dhe mekanizmave ndërsektorialë. Në nivel qendror, janë intensifikuar përpjekjet për të forcuar strukturat përgjegjëse për hartimin dhe koordinimin e strategjive ndërsektoriale me ndikim tek fëmijët. Në këtë kuadër, Si rezultat është mundësuar integrimi i agjendës së fëmijëve në politikat kombëtare, duke përfshirë integrimin e çështjeve të fëmijëve në punën e Grupeve të Menaxhimit të Politikave të Integruara dhe Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (KKDMF). Gjithashtu, nëpërmjet ngritjes së forumeve koordinuese me donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë, janë

përforcuar partneritetet për zbatimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve.

Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, gjatë viteve 2023-2024, ka zhvilluar dy takimet e tij të radhës ku qëllimi dhe tematikat kryesore të diskutimit kanë patur në fokus:

1. Prezantimin e Raportit të Monitorimit për zbatimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026, për vitet 2021-2022.
2. Prezantimin e situatës të të drejtave të fëmijëve, arritjet dhe sfidat në zbatim të çështjeve që prekin jetën e fëmijëve, mbrojtjes së të drejtave të tyre.
3. Prezantimin dhe miratimin e planit të masave në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga Komiteti i Konventës së të Drejtave të Fëmijëve (CRC).
4. Prezantimin e modelit të “Garancisë për fëmijët”, si një nga masat prioritare të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030.

Në takimin e Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, i cili u zhvillua në datën 26 nëntor 2025, u diskutua mbi:

1. Prezantimi i Projektligjit “Për Kujdesin Alternativ në Familje në Republikën e Shqipërisë”
2. Prezantimi i “Planit Kombëtar për Garancinë Evropiane të Fëmijëve”
3. Prezantimi i “Planit Kombëtar për Transformimin e Përkujdesit Shoqëror Rezidencial për Fëmijët, drejt Shërbimeve Alternative për Fëmijën dhe Familjen 2025-2026”

ASHDMF-ja është institucion në varësi të MSHMS-së, e cila bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës. UNICEF Shqipëri ka ndihmuar në fuqizimin e kapaciteteve të ASHDMF-së, përmes trajnimeve

dhe rishikimit të strukturës së brendshme, duke mundësuar koordinim më efikas ndër-institucional. Në përputhje me masat e Agjendës për forcimin e rolit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF), me Urdhrin nr. 23/3, datë 22.10.2024 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, numri i punonjësve të Agjencisë është rritur nga 7 në 9 punonjës, duke shtuar 2 punonjës të rinj në strukturën e institucionit.

Në nivel vendor, janë ngritur dhe funksionalizuar mekanizmat për zbatimin e iniciativës së qyteteve miqësore për fëmijët dhe adoleshentët. UNICEF Shqipëri ka lehtësuar hartimin e Planeve Lokale për Fëmijët dhe ka mundësuar pjesëmarrjen aktive të fëmijëve në konsultime publike. Ngritja e mekanizmave vendorë për nismën “Bashki mike e fëmijëve” është realizuar në Bashkinë Korçë dhe Dibër. Bazuar në të dhënat/statistikat dhe në analizën e situatës së fëmijëve në Bashkinë Korçë është miratuar nga Këshilli Bashkiak Plani vendor për fëmijët 2023-2025, “Korçë – Bashki mike e fëmijëve”. Me të njëjtën metodologji, pas publikimit të statistikave të fëmijëve në Bashkinë Dibër, u hartua Plani Lokal për Fëmijët.

Përmirësimi i mekanizmave të monitorimit dhe raportimit ka qenë një tjetër shtyllë kyçe. Nën koordinimin e Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme (MEPJ) dhe MSHMS-së, Qeveria Shqiptare ka dorëzuar pranë Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës përgjigjet mbi listën e pyetjeve që mbulojnë periudhën kohore 2019-2022 në vijim të raportit të Shtetit dorëzuar në vitin 2019. Në përputhje me Rekomandimet e marra nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (në Gjenevë), dhe me mbështetjen e UNICEF Shqipëri, u përgatit një plan kombëtar veprimi i koordinuar përmes KKDMF-së dhe strukturave të linjës.

Në drejtim të buxhetimit për fëmijët, janë ndërmarrë iniciativa për forcimin e kapaciteteve institucionale për analizën e trendeve të financimit dhe riprioritizimin e shpenzimeve publike në funksion të arritjes së rezultateve për

fëmijët. UNICEF Shqipëri ka bashkëpunuar me Parlamentin dhe Ministrinë e Financave për të nxitur mekanizma të buxhetimit të ndjeshëm ndaj fëmijëve dhe ka ndikuar në miratimin e politikave të reja që garantojnë transparencë dhe llogaridhënie.

Një tjetër arritje e rëndësishme është avancimi i sistemit të statistikave dhe të dhënave në funksion të realizimit të të drejtave të fëmijëve.

Është përditësuar dashboard-i statistikor (statistika-femijet.gov.al), ku ASHDMF luan rol koordinues me institucionet raportuese. Nga ana vizuale platforma i pasqyron të dhënat në mënyrë grafike, si dhe paraqet prirjet ndër vite për çdo tregues. Duke njohur sfidat në raportimin e treguesve të ndryshëm, u miratuan ndryshimet e nevojshme përmes VKM-së nr. 471, datë 6.7.2022⁵, dhe tashmë lista e treguesve është 61 tregues. INSTAT në bashkëpunim me ministrinë e linjës kanë filluar përgatitjen për zbatimin e Anketës me Tregues të Shumëfishtë (MICS 2025-2026). Kjo anketë, rezultatet e të cilës pritet të publikohen në 2026 do të pasurojë menunë e treguesve me fokus fëmijët dhe gratë, dhe shërben si një burim të dhënash për monitorimin e politikave kombëtare.

Për herë të parë, Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026 portretizon statistikën e fëmijëve/adoleshentëve dhe të rinjve si një komponent kryesor i statistikave sociale. Në këtë kuadër INSTAT ka ngritur edhe një platformë për vizualizimin e statistikave zyrtare me fokus fëmijët dhe të rinjtë. Gjithashtu INSTAT ka publikuar të dhënat e Censit 2023, në nivel kombëtar dhe rajonal, midis të cilave përfshihen të dhëna edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara sipas gjinisë, grup moshës statusit dhe llojit të aftësisë së kufizuar.⁶ Është pranë përfundimit analiza e thelluar e Censit 2023 me fokus fëmijët dhe të rinjtë. INSTAT, ka realizuar trajnime me punonjës të bashkive (kryesisht përgjegjës për arsimin parashkollor), lidhur me përmirësimin dhe prodhimin e statistikave që informojnë politikën për arsimin parashkollor dhe ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së kujdesit të fëmijëve.

5. Vendimi nr. 471, datë 6.7.2022, “Për një ndryshim në vendimin nr. 636, datë 26.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e llojeve, të mënyrës së shkëmbimit dhe të përpunimit të informacionit dhe të të dhënave statistikore, të kërkuara nga ASHDMF-ja, pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”.

6. <https://www.instat.gov.al/sq/temat/censet/censet-e-popullsise-dhe-banesave/publikimet-cesnsusi-i-popullsise-dhe-banesave/2023/publikimet-e-censit-te-popullsise-dhe-banesave-2023/>

Pjesëmarrja e fëmijëve është promovuar si pjesë thelbësore e qeverisjes së mirë. Janë ngritur mekanizma për përfshirjen e fëmijëve në nivel qendror dhe vendor, përfshirë edhe mekanizmat për monitorimin e pavarur të Agjendës për të Drejtat e Fëmijëve. Kapacitetet e vetë fëmijëve dhe adoleshentëve janë forcuar përmes programeve si UPSHIFT, Ponder, dhe trajnimeve për sipërmarrje sociale, qytetari aktive, mendim kritik dhe digjital. Gjithashtu, është zgjeruar përdorimi i platformave digjitale si U-report, duke i dhënë zë fëmijëve për të adresuar çështje që i prekin si online ashtu edhe offline, në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Pjesëmarrja e fëmijëve sipas raportimeve të institucioneve, njërive të qeverisjes vendore dhe organizatave, është realizuar në pjesën më të madhe në kuadër të zbatimit të programeve nga organizatat nëpërmjet angazhimit të qeverisë së nxënësve, grupeve rinore dhe grupit të fëmijëve dhe parlamentin rinor⁷.

Një shembull konkret i zbatimit të kësaj mase është Bashkia Elbasan, e cila ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për krijimin e mekanizmave funksionalë të pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset vendimmarrëse. Në kuadër të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve dhe në bashkëpunim me Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve, Bashkia ka zbatuar nismën “Qytete Miqësore për Fëmijët”, që synon të fuqizojë pjesëmarrjen aktive të fëmijëve në zhvillimin e qytetit të tyre, duke i dhënë zë opinionëve dhe ideve të tyre për mirëqenien dhe të drejtat e tyre. Kjo qasje kombinon vendimmarrjen institucionale (nga lart-poshtë) me përfshirjen komunitare dhe të fëmijëve (nga poshtë-lart). Në këtë kuadër, janë realizuar takime me aktorë lokalë për të planifikuar aktivitete që përfshijnë fëmijët në proceset e zhvillimit urban dhe social të qytetit. U zhvillua gjithashtu dhe fushata “Si e dua qytetin tim”, ku fëmijët nga shkollat 9-vjeçare dhe të mesme dhanë idetë e tyre për

një qytet miqësor, përmes pikturave, videove, maketeve dhe eseve. Këto ide u përfshinë në një album zyrtar, i cili iu dorëzua Kryetarit të Bashkisë Elbasan nga vetë fëmijët, me qëllim që të merren parasysh në vendimmarrje për zhvillimin urban, hapësirat publike, sigurinë dhe argëtimin e fëmijëve. Ky model përfaqëson një mekanizëm të strukturuar dhe të dokumentuar të pjesëmarrjes së fëmijëve në nivel vendor, që mund të shërbejë si praktikë e mirë për mekanizmin e monitorimit të pavarur të zbatimit të Agjendës për të Drejtat e Fëmijëve.

Ministria e Mbrojtjes (MM) ka hartuar dy dokumente: 1) Planin Kombëtar të Emergjencave Civile dhe 2) Strategjinë Kombëtare për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë. Ky proces ka përfshirë trajnimin e çështjeve lidhur me efektet e ndryshimeve klimaterike dhe të mjedisit të fëmijët⁸. Gjithashtu, MM-ja është në procesin e integritetit të njohurive në fushën e mbrojtjes civile në programet mësimore në sistemin parauniversitar.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Bashkia Tiranë, kanë hartuar një marrëveshje bashkëpunimi në fushën e edukimit mjedisor, në të cilën bën pjesë edhe edukimi mbi ndikimin që sjellin ndryshimet klimatike në jetën e fëmijëve dhe më gjerë.

Një analizë buxhetore është realizuar për të sjellë më tepër informacion mbi trendet në planifikimin dhe realizimin e buxhetit në tre sektorë: arsim, ndihmë sociale dhe shëndetësi. Gjetjet dhe rekomandimet nga analizat e buxhetit, janë përdorur për të advokuar për rritjen e shpenzimeve sociale në seancat vjetore parlamentare për projektligjin e buxhetit 2022 dhe 2023.

MSHMS-ja ka forcuar sistemin kombëtar të Sistemit Informativ të Menaxhimit të Mbrojtjes Sociale (MIS) për të profilizuar, synuar, mbështetur, aksesuar dhe monitoruar në mënyrë më efektive përfituesit e programit të shërbimeve

7. World Vision ka raportuar se përgjatë periudhës 2021-2022, janë përfshirë 1 381 fëmijë dhe adoleshentë në seance trajnimi dhe rritje kapaciteti për qytetarinë aktive dhe advokaci, duke nxitur mendimin kritik. 70 adoleshentë janë trajnuar në vitin 2022 për aftësim digjital dhe aftësitë e shek. XXI (komunikim, novacion, mendim kritik etj.), si edhe për përdorimin e teknologjisë për qëllime advokacie. CRCA/ECPAT Shqipëri, mbështeti Grupin e Fëmijëve dhe Parlamentin Rinor, që të kontribuojnë në përgatitjen e Raportit Alternativ për të Drejtat e Fëmijës, si dhe ta prezantojnë atë përpara Komitetit DF në Gjenevë.

8. Nisma ARSIS me mbështetjen e UNDP-së në kuadër të programit “Masat reaguese për mbrojtjen sociale pas tërmetit”, ka kontribuar në përgatitjen e Planit të Veprimit për përgjigjen ndaj emergjencave për grupet vulnerabël, duke përfshirë përgjigjen për mbrojtjen e fëmijëve në Bashkinë Krujë, Durrës dhe Shijak (2022).

sociale. Trajnimi rreth MIS-it i rreth 500 të stafëve sociale (NJMF/NJVNR), çoi në rritjen e përdorimit të sistemit në nivel bashkie në regjistrimin, monitorimin dhe raportimin e të dhënave.

Platforma U-Report, një formë novatore për zgjerimin dhe përdorimin e teknologjisë digjitale për të realizuar të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar për të ngritur zërin për çështje që i prekin nga afër *on-line* dhe *off-line*, është konsoliduar dhe vijon aktivitetet për ta promovuar atë si një mjet kryesor për të çuar zërin e të rinjve në nivel vendimmarrës. U-Report⁹ është bërë një mjet kryesor në zhvillimin e politikave, si për strategjinë për të rinjtë, ndotjen e ajrit, thirrjen e veprimit në Samitin e Transformimit të Arsimit etj.

Edhe pse Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 nuk parashikon masa specifike për Avokatin e Popullit (AP), institucioni ka vijuar veprimtarinë në përputhje me mandatin kushtetues dhe ligjor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. AP ka promovuar pjesëmarrjen e fëmijëve dhe ka vlerësuar si të pamjaftueshme masat për jetesë me dinjitet dhe përfshirjen sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Po ashtu, ka theksuar domosdoshmërinë e përsheptimit të deinstitutionalizimit dhe forcimit të shërbimeve në komunitet.

Avokati i Popullit finalizoi Raportin e vlerësimit të ndikimit të të drejtave të fëmijëve mbi masat e reagimit ndaj COVID-19, me mbështetjen e UNICEF-it Shqipëri dhe Rrjetit Evropian të Avokatëve të Popullit për Fëmijët. Gjetjet dhe rekomandimet u lançuan në fund të vitit 2022 dhe për zbatimin e tyre u kërkua angazhimi i të gjithë aktorëve përgjegjës.

Avokati i popullit (Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve) përgjatë vitit 2021-2025 ka trajtuar 697 ankesa/kërkesa, ndër të cilat 276 ankesa/kërkesa të ardhura nga vetë fëmijët dhe 191 ankesa/kërkesa në emër të fëmijëve dhe 166 ankesa/kërkesa të trajtuara me nisma si dhe inspektive, me objekt të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve sipas burimit të ngritjes

së ankesës/kërkesës (nga fëmija, në emër të fëmijës, me nismën e AP-së) dhe statusit të menaxhimit të rastit (në proces / i mbyllur).

Me ndryshimet e vitit 2020 në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹⁰, u zgjeruan shkaqet dhe format e mbrojtura të diskriminimit, u fuqizua mandati i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dhe u theksua detyrimi i autoriteteve publike për të promovuar barazinë. Gjithashtu, u forcua roli i organizatave të shoqërisë civile për të paraqitur ankesa dhe padi në mbrojtje të interesave kolektive dhe të drejtat e individëve. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka trajtuar 57 ankesa me subjekte fëmijët në fushën e arsimit dhe 10 ankesa në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Pra në total 67 ankesa me subjekte fëmijët. Nga këto, 42 ankesa janë regjistruar gjatë vitit 2024 dhe 11 ankesa janë mbartur nga viti 2023.

Gjatë viteve 2021-2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi organizoi dhe mori pjesë në një sërë aktivitetesh informuese dhe ndërgjegjësuere në shkolla në të gjithë vendin, duke trajtuar tema si të drejtat e fëmijëve, diskriminimi, segregimi, bullizmi, gjuha e urrejtjes dhe shëndeti mendor. Këto aktivitete synuan të forcojnë ndërgjegjësimin, të promovojnë barazinë dhe të forcojnë bashkëpunimin mes institucioneve, prindërve, mësuesve dhe nxënësve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe fëmijëve.

Gjatë muajit prill 2022, Grupi i Deputetëve “Miq të fëmijëve”, zhvilloi seancën dëgjimore me të rinjtë e shkollës së mesme “Raqi Qirinxhi”, Korçë, të cilët prezantuan përpara Krytares së Kuvendit, deputetëve e pjesëmarrësve, petitionin e tyre, i cili kishte si objekt forcimin e kontrollit parlamentar dhe marrjen e masave me natyrë legjislative (nëse është nevoja) për të rritur përpjekjet për parandalimin e krimeve seksuale ndaj të miturve në vendin tonë. Në vijim të këtij takimi, Grupi i Deputetëve “Miq të fëmijëve”, në bashkëpunim me Komitetin e Helsinkit, zhvilloi në datën 28.9.2022 seancën dëgjimore me temë: “Të rinjtë aktivë adresojnë zërin e tyre në Kuvend” me përfaqësues të gjimnazeve të tjera në

9. Me mbështetjen e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve/UNICEF Shqipëri u angazhuan 360 të rinj në mënyrë aktive në hartimin e sondazheve dhe diskutimet e komenteve pas sondazheve, 10 000 të rinj u arritën përmes aktiviteteve të ndryshme informuese dhe promovuese të organizuara nga U-reporters.

10. Ligji 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.221/04.02.2010 për mbrojtjen nga diskriminimi”

Shqipëri. Në datën 4.7.2022 Grupi i Deputetëve “Miq të Fëmijëve,” zhvilluan seancën dëgjimore për fëmijët e huaj të pashoqëruar më qëllim trajnimin e vështirësive të përgjigjes ndaj nevojave të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me UNICEF Shqipëri dhe UNHCR.

Në kuadër të mirërritjes dhe miredukimit të fëmijëve, gjatë vitit 2022, ka zhvilluar edhe një

program për aktivitete jashtëshkollore, të cilat do të zbatohen në 200 shkolla nëpër të gjithë vendin, duke filluar nga janari 2023. Ky është një program, i cili synon të ofrojë kurse jashtëshkollore në 5 disiplina të ndryshme për fëmijët dhe të rinjtë në disipinat: arte, zeje, agrikulturë, mjedis, sport, dhe teknologji informacioni. Kjo do të sjellë edhe zbatimin dhe zhvillimin e njohurive të fëmijëve dhe në fushën e turizmit.



TABELA 10. STATUSI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETEVE (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Nr. i masave	Nr. i aktiviteteve gjithsej	Nr. i aktiviteteve të raportuara	Përqindja e aktiviteteve të raportuara
4	19	12	63%



TABELA 11. STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Statusi	Numri i statusit të aktiviteteve	Përqindja e statusit të aktiviteteve
Plotësisht i realizuar	5	42%
Pjesërisht i realizuar	7	58%
I parealizuar	0	






TABELA 12. SHPENZIMET SIPAS STATUSIT TË REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR, VLERË DHE PËRQINDJE)

Statusi	Nr. i aktiviteteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti shtetit	Partnerë
Plotësisht i realizuar	5	33,698,833	42.00%	33,698,83	100%	33.00%	67.00%
Pjesërisht i realizuar	7	46,536,483	58.00%	46,536,483	100%	33.00%	67.00%
I parealizuar	0						

SHPENZIMET FINANCIARE

Shpenzimet e planifikuara për aktivitetet e këtij objekti janë llogaritur mbi bazën e kostove treguese dhe të burimeve të identifikuar në planin e veprimit. Sipas të dhënave, për periudhën 2021–2025 buxheti i planifikuar është realizuar plotësisht, duke u shpërndarë ndërmjet aktiviteteve të plotësisht të realizuara dhe atyre pjesërisht të realizuara. Në total janë shpenzuar 100% e fondeve të planifikuara, pa

mbetur aktivitete të parealizuara apo hendek financiar. Sa i përket burimeve të financimit, 33% e shpenzimeve janë mbuluar nga buxheti i institucioneve përgjegjëse, ndërsa 67% janë financuar nga organizatat dhe institucionet partnere.

Qëllimi II.

Eliminimi i të gjitha formave të dhunës dhe mbrojtja e fëmijëve

Qëllimi II ka adresuar eliminimin e të gjitha formave të dhunës dhe mbrojtjes së fëmijëve, duke përfshirë rritjen e fëmijëve në një mjedis mbështetës me praktika pozitive të prindërimit, që i mbron nga dhuna dhe abuzimi. Ky qëllim ka në vëmendje funksionimin e një sistemi të dobishëm dhe gjithëpërfshirës për mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet përmirësimit të kuadrit normativ, buxhetor dhe raportues për mbrojtjen e fëmijës dhe fuqizimit të kapaciteteve të mekanizmave dhe shërbimeve për trajnimin e dhunës ndaj fëmijëve. Ky qëllim ka prioritetuar ngritjen dhe përmirësimin e mekanizmave dhe

shërbimeve të veçanta dhe të integruara për trajnimin e formave më të rënda të dhunës, përfshirë abuzimin seksual, abuzimin dhe shfrytëzimin *on-line*.

Institucionet kanë raportuar për 91% të treguesve që lidhen me objektivat specifike të këtij qëllimi strategjik, dhe realizimi i 80% prej tyre është mundësuar plotësisht. Informacion është raportuar për 49 nga 51 aktivitetet që janë pjesë e qëllimit strategjik, prej të cilave vetëm 55% janë realizuar plotësisht.



TABELA 13. NIVELI I RAPORTIMIT TË TREGUESVE TË REZULTATIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Numri i treguesve	Të paraportuara	Të raportuara
11	1	10
100%	9%	91%



TABELA 14. STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE TË REZULTATIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Total tregues (Nr. & %)	Plotësisht i realizuar	Pjesërisht i realizuar	I parealizuar
10	8	2	0
100%	80%	20%	0%



TABELA 15. STATUSI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETEVE (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Nr. i masave	Nr. i aktiviteteve gjithsej	Nr. i aktiviteteve të raportuara	Përqindja e aktiviteteve të raportuara
4	51	49	96%



TABELA 16. STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Statusi	Numri i statusit të aktiviteve	Përqindja e statusit të aktiviteve
Plotësisht i realizuar	27	55%
Pjesërisht i realizuar	12	24%
I parealizuar	10	21%




TABELA 17. SHPENZIMET SIPAS STATUSIT TË REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR, VLERË DHE PËRQINDJE)

Statusi	Nr. i aktiviteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti shtetit	Partnerë
Plotësisht i realizuar	27	7,801,314	55.00%	177,801,314	100.00%	46.92%	53.08%
Pjesërisht i realizuar	12	77,586,028	24.00%	77,586,028	100.00%	46.92%	53.08%
I parealizuar	10	67,887,775	21.00%	67,887,775			

Objektivi specifik II.1.

Fëmijët rriten në një mjedis mbështetës, me praktika pozitive të prindërimit, që i mbrojnë nga dhuna dhe abuzimi.

Treguesi në nivel objektivi strategjik:



Njohuritë, qëndrimet dhe praktikat pozitive të prindërve/kujdestarëve në kuadër të parandalimit dhe trajnimit të dhunës [i realizuar]

Me mbështetjen e UNICEF-it Shqipëri, është realizuar vala e parë e anketës për matjen e njohurive dhe qëndrimeve të publikut ndaj dhunës ndaj fëmijëve. Rezultatet janë publikuar në vitin 2023, duke vendosur gjithashtu bazat për metodologjinë krahasuese që do të përdoret në anketën e planifikuar për vitin 2026.¹¹ Ky studim ofron një bazë të rëndësishme krahasimore për të matur ndryshimet që do të vlerësohen sërish në vitin 2026. Ai konfirmon ekzistencën e normave sociale jopozitive, të cilat ende e konsiderojnë dhunën ndaj fëmijëve si çështje private dhe nuk e nxisin raportimin.

Për të adresuar këto norma, UNICEF Shqipëri ka mbështetur hartimin e fushatave ndërgjegjëse kombëtare dhe lokale, të cilat synojnë të informojnë publikun për format e dhunës, përfshirë trafikimin, dhunën seksuale, bulizmin, si dhe të drejtat e viktimave të trafikimit dhe shfrytëzimit. Në këtë kuadër, janë zhvilluar fushata si "E Vërteta N'Drit" në partneritet me influencues dhe Ministrinë e Brendshme, duke përdorur qasje bashkëkohore për edukimin e komunitetit.

E kthyer tashmë në një traditë, përgjatë tetorit të cilësuar si "muaji i luftës kundër trafikimit të personave", Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me institucionet shtetërore dhe organizatat partnere, ka organizuar çdo vit në 12 qarqet e vendit aktivitete sensibilizuese dhe

ndërgjegjëse për parandalimin e trafikimit të personave, përfshirë fëmijët. Bazuar në kalendarin kombëtar të antitrafikut, veprimtaritë përgjatë këtij muaji u përqendruan kryesisht në ekspozita me punime të nxënësve të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare; forume diskutimi në nivel lokal për problematikat e trafikimit; aktivitete sensibilizuese për trafikimin e fëmijëve me përfaqësues lokalë, studentë dhe nxënës të shkollave të mesme; programe televizive në televizione kombëtare dhe lokale; marshime sensibilizuese në kryeqytet dhe në qendrat e qarqeve; shpërndarje e materialeve ndërgjegjëse, kuti dhe tenda informuese, etj. Me qëllim promovimin e Linjës Kombëtare 116006 gjatë Muajit Antitrafik, përpos anoncimit të saj në aktivitete, një minivan me logon e Linjës 116006 "përshkoi/udhëtoi" në bashkitë kryesore të 12 qarqeve, duke shkuar edhe pranë shkollave, në sheshe, në vende të dukshme, etj. Në drejtim të promovimit të Linjës po ndërtohet një strategji komunikimi, e targetuar për rrjetet sociale, me sloganin: JO TRAFIKIMIT: TELEFONO NDRYSHIMIN! e cila do të njohë publikun me rëndësinë e saj, të ketë besim në anonimitetin dhe ta shohë si një mjet efektiv për të luftuar trafikimin.

Përgjatë vitit 2021-2025, moduli i edukimit për prindërimin pozitiv, është hartuar për profesionistët pranë qendrave të shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen në dy bashkitë-pilot në kuadër të procesit të transformimit të institucioneve të përkujdesit shoqëror në shërbime komunitare dhe për të mbështetur procesin e ribashkimit të fëmijës me familjen në dy bashki, në atë të Korçës dhe të Vlorës, nën monitorimin e Shërbimit Social Shtetëror. Gjithashtu ka patur përpjekje për të

11. <https://www.unicef.org/albania/reports/reporting-violence-against-children-albania>

mbledhur dhe organizuar modulet ekzistuese të organizatave bazuar në përvojat e tyre për hartimin e moduleve të prindërimit dhe për të krijuar një paketë të unifikuar njohurish për prindërimin pozitiv. Shoqata Nisma ARSIS, me mbështetjen e UNICEF Shqipëri, ka hartuar programin e prindërimit “Jam këtu për ty”, me qëllimin final reduktimin e rrezikut të abuzimit dhe ndarjes së fëmijëve nga familja shkaktuar nga emergjencat në Shqipëri. Qëllimi i këtij programi, është të ndihmojë familjet në përballimin e sfidave të jetës së përditshme dhe ngjarjeve të pazakonta dhe të papritura, duke reduktuar impaktin që të gjitha këto mund të kenë në shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës dhe familjes. Janë përgatitur disa materiale mbështetëse në formën e broshurave, me qëllim edukimin dhe ndërgjegjësimin mbi të gjitha format e dhunës, abuzimit, trafikimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve. Gjithashtu, “Konventa e të Drejtave të Fëmijëve” është publikuar në një format të përshtatshëm për fëmijë, me gjuhë miqësore, shoqëruar me ilustrime të personazheve të filmave vizatimorë. Në gjuhën angleze janë përgatitur broshura për informimin e shtetasve afganë të akomoduar në Shqipëri mbi sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, formave të dhunës dhe mënyrës së raportimit dhe të referimit.

Në linjë me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore, është promovuar ndarja e përgjegjësiwe prindërore mes nënave dhe baballarëve, dhe edukimi i fëmijëve pa stereotipe gjinore. Kjo është reflektuar edhe në qasjen Reggio Emilia për arsimin parashkollor të mbështetur nga UNICEF, që inkurajon përfshirjen e baballarëve në edukim dhe krijimin e ambientit gjithëpërfshirës që refuzon dhunën dhe diskriminimin.

Ndërkohë, platforma digjitale Bebo është përdorur për të përçuar informacione të standardizuara për prindërimin pozitiv dhe zhvillimin e fëmijës, duke angazhuar mbi 20,000 prindër, përfshirë 3,400 baballarë. Kjo platformë përçon mesazhe mbi mbrojtjen e fëmijëve, zhvillimin e hershëm dhe barazinë gjinore, dhe është promovuar nëpërmjet shërbimeve publike në të paktën katër qarqe.

Gjatë vitit 2021–2022 janë bërë pjesë e trajnimeve mbi prindërimin pozitiv nga Terre des Hommes 922 persona. WVA-ja ka zbatuar projektin “Në labirint”, i cili targeton ndërgjegjësimin e popullatës së gjerë, sidomos të prindërve, për çështjen e dhunës ndaj fëmijëve. Gjatë vitit 2021 e kanë vizituar “Labirintin” rreth 4836 individë gjithsej, ndërsa në vitin 2022 këtë instalacion e kanë vizituar 1487 individë.

Në 27 njësitë administrative në Bashkinë Tiranë, në disa nga qendrat komunitare, janë ngritur dhe funksionojnë klubet e prindërimit (mbi disiplinën pozitive, mbi përgjegjësitë e përbashkëta dhe të barabarta të nënave dhe baballarëve kundrejt fëmijëve, për rritjen e fëmijëve të lirë nga stereotipat gjinorë dhe edukimin e tyre mbi vlerat e barazisë gjinore të përshtatshme për të gjitha grup-moshat). Moduli i trajnimit të prindërve në bazë të zonave në të cilat operojnë, është zhvilluar nga Fshatrat SOS, Nisma ARSIS, Save the Children dhe WVA-ja.

Për më tepër, janë ndërmarrë iniciativa për krijimin e një klime pozitive në shkolla, përmes një Plani Kombëtar i Veprimit për parandalimin e dhunës dhe rritjen e sigurisë në shkolla, i cili synon reduktimin e dhunës, bulizmit dhe sjelljeve ekstremiste. Plani i hartuar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, përfshin një qasje të gjithanshme që lidh edukimin me sistemin e referimit dhe ndërhyrjet mbrojtëse.

Në mjedisin shkollor dhe jashtë tij, programet si UPSHIFT dhe Ponder kanë pajisur mijëra të rinj me aftësi për mendim kritik, inovacion social dhe qytetari aktive, duke krijuar një brez të ri më të ndërgjegjshëm dhe të angazhuar në promovimin e vlerave të barazisë dhe refuzimin e dhunës.



TABELA 18. STATUSI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETEVE (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Nr. i masave	Nr. i aktiviteteve gjithsej	Nr. i aktiviteteve të raportuara	Përqindja e aktiviteteve të raportuara
1	6	6	100%



TABELA 19. STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Statusi	Numri i statusit të aktiviteteve	Përqindja e statusit të aktiviteteve
Plotësisht i realizuar	2	33%
Pjesërisht i realizuar	3	50%
I perealizuar	1	17%






TABELA 20. SHPENZIMET SIPAS STATUSIT TË REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR, VLERË DHE PËRQINDJE)

Statusi	Nr. i aktiviteteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti shtetit	Partnerë
Plotësisht i realizuar	2	14,787,556	33.00%	14,787,556	100%	49.96%	50.04%
Pjesërisht i realizuar	3	22,405,387	50.00%	22,405,388	100%	49.96%	50.04%
I porealizuar	1	7,617,831	17.00%	7,617,832			

SHPENZIMET FINANCIARE

Objektivi strategjik II përfshin tri objektiva specifike. Objektivi specifik II.1 ka vetëm një masë me gjashtë aktivitete, nga të cilat dy janë të buxhetuara në plane të tjera. Sipas planit të veprimit, rezultojnë që buxheti i planifikuar për katër aktivitete të tjera të objektivit specifik, duhet të mbulonte 100% të kostove treguese për periudhën 2021-2025.

Nga të dhënat e raportuara rezultojnë se: 2 aktivitete janë realizuar plotësisht, me shpenzime të planifikuara prej 14,787,556 lekë dhe realizim të plotë (100%). Financimi është ndarë gati në mënyrë të barabartë ndërmjet buxhetit të institucioneve përgjegjëse (49.96%) dhe partnerëve (50.04%). 3 aktivitete janë realizuar pjesërisht, me një buxhet të planifikuar prej 22,405,387 lekë, të cilat gjithashtu rezultojnë të mbuluara 100% nga shpenzimet faktike, me të njëjtën ndarje të burimeve të financimit (49.96%

buxhet dhe 50.04% partnerë). 1 aktivitet nuk është realizuar, me një buxhet të planifikuar prej 7,617,831 lekë. Në total, për periudhën raportuese, janë përdorur 100% e fondeve të planifikuara për aktivitete të realizuara (plotësisht dhe pjesërisht), ndërkohë që mbetet i porealizuar vetëm një aktivitet me 17% të buxhetit të planifikuar. Ky rezultat tregon një nivel të lartë mobilizimi të burimeve financiare dhe një ndarje të balancuar midis fondeve publike dhe atyre të partnerëve, duke eliminuar hendekun financiar të identifikuar në fazën e planifikimit.

Objektivi specifik II.2.

Funksionimi i një sistemi gjithëpërfshirës dhe të dobishëm për mbrojtjen e fëmijëve

Treguesit kryesorë në nivel objektivash të veçanta nën këtë qëllim strategjik, janë:

- ➔ numri i akteve normative të hartuara/rishikuara (të paktën 2 në vit), në konsultim me grupet e interesit dhe fëmijët, dhe në linjë me standardet ndërkombëtare [*pjesërisht i realizuar*]
- ➔ përqindja e NJVV-ve që kanë linjë të veçantë të buxhetit për menaxhimin e rasteve të dhunës së fëmijëve – [*pjesërisht i realizuar*]
- ➔ përqindja e NJVV-ve me struktura të kualifikuara për mbrojtjen e fëmijëve në përputhje me kërkesat e legjislacionit të rishikuar – [*i realizuar*]
- ➔ numri i punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve të punësuar – [*i realizuar*] (nga 241 në 370);
- ➔ numri në rritje (5% çdo vit) i fëmijëve të identifikuar në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje, rastet e të cilave janë menaxhuar gjatë vitit nga NJMF/PMF – [*i realizuar*]
- ➔ numri në rritje (5% çdo vit) i fëmijëve, për të cilët është marrë vendimi për dhënien e masës mbrojtëse nga gjykata – [*i realizuar*]
- ➔ numri i fëmijëve (2% rritje çdo vit) që kanë raportuar një formë dhune, të regjistruar nga institucionet arsimore – [*i realizuar*]
- ➔ numri i fëmijëve viktimë të dhunës, regjistruar nga institucionet shëndetësore [*i raportuar*]

Në kuadër të rishikimit të ligjit “Për kujdesin alternativ” është realizuar analiza ligjore dhe financiare e kuadrit ekzistues rregullativ dhe financiar të kujdestarisë alternative. Kjo analizë shërbeu si bazë për hartimin e draftit të ligjit

dhe për përmirësimin e mëtejshëm të kornizës ligjore dhe institucionale në fushën e mbrojtjes dhe kujdesit të fëmijëve si dhe është ngritur grupi i punës për hartimin e tij.

Është hartuar Drafti Projektligji “Për Kujdesin Alternativ në Familje”, i cili përcakton format e kujdesit alternativ (kujdes nga të afërm, kujdes familjar, kujdestari profesionale, kujdes i specializuar dhe kujdes emergjent); rregullon procedurat ligjore të vendosjes së fëmijës; formalizon profesionin e kujdestarit profesional, me pagesë, sigurime shoqërore e shëndetësore dhe kod etik detyrues; krijon një regjistër elektronik kombëtar për kujdesin alternativ, për të garantuar gjurmueshmëri, koordinim dhe transparencë; kufizon numrin e fëmijëve për çdo familje kujdestare, duke garantuar cilësi e jo thjesht numër; forcon rolin e bashkive si institucione përgjegjëse për organizimin, monitorimin dhe mbështetjen e familjeve kujdestare në territor; jep rol të qartë shoqërisë civile si partnere strategjike në identifikim, ofrim dhe monitorim të kujdesit alternativ; parashikon mekanizma ankimi dhe mbrojtjeje ligjore për fëmijët dhe familjet kujdestare.

Ky projektligj u prezantua edhe në mbledhjen e Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, që u zhvillua në 26 Nëntor 2025.

Përgjatë periudhës së zbatimit AKDF-së:

- ▶ Në vitin 2021 me VKM-në nr. 670, datë 10.11.2021, u miratua Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër trafikimit të personave 2021-2023.
- ▶ Gjithashtu në datën 10.07.2024 me VKM nr.458, është miratuar nga Këshilli i Ministrave Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër trafikimit të personave 2024-

2025, i cili shpreh përkushtimin e qeverisë shqiptare, të institucioneve shtetërore dhe joshtetërore dhe të aktorëve antitrafikim që punojnë në strukturat publike dhe jopublike, për të minimizuar fenomenin e trafikimit të personave. Ky dokument është vazhdim i përpjekjeve dhe objektivave antitrafikim të parashikuara në Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025, sigurisht, të përshtatura me dinamikën e trafikimit, vizionin e ri qeverisës në qasjen ndaj fenomenit të trafikimit për të krijuar një platformë të mirëorientuar synimesh e objektivash strategjike, në përputhje me dokumentet e tjera strategjike kombëtare, si dhe bazuar në rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë.

Në zbatim të Ligjit nr.79/2021 "Për të huajt", është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.858, datë 29.12.2021 "Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr.174, datë 12.09.2022 "Mbi procedurat e trajtimit të shtetasve të huaj me qëndrim të parregullt në Republikën e Shqipërisë", seksioni III, i të cilit i dedikohet trajtimit procedural të kthimit të fëmijës së huaj të pashoqëruar, si dhe Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr.143, datë 13.10.2023 "Për përcaktimin e rregullave të veçanta të kalimit të shtetasve shqiptarë të mitur në kufi".

Deri më tani, nuk janë ndërmarrë ndryshime në ligjin nr. 121/2016 'Për shërbimet e kujdesit shoqëror', për qëllime të harmonizimit me ligjin nr. 18/2017 'Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve', apo me detyrime të tjera që burojnë nga legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar. Rishikimi i ligjit nr. 8153, datë 3.10.1996, "Për statusin e jetimit" nuk është finalizuar ende me një ndryshim ligjor. Megjithatë, është realizuar studimi i kuadrit ekzistues dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka dalë në përfundimin për hartimin e një ligji të ri, të titulluar "Për fëmijët pa kujdes prindëror", i cili do të adresojë në mënyrë më të përshtatshme nevojat aktuale dhe sfidat në mbështetjen e kësaj kategorie fëmijësh. Aktualisht, baza ligjore në fuqi, e përbërë nga Ligji nr. 8153,

datë 3.10.1996 "Për statusin e jetimit", VKM nr. 233, datë 10.04.1998, "Për zbatimin e ligjit 'Për statusin e jetimit'", dhe Udhëzimi nr. 20, datë 14.12.1998, nuk ka pësuar ndryshime, por ka nevojë për rishikim, pasi nuk është më në përputhje me ndryshimet në legjislacionin për shërbimet sociale.

Vetem gjatë vitit 2024, 255 persona kanë përfituar për herë të parë statusin e jetimit, nga të cilët 228 janë fëmijë të lindur jashtë martese. Në kuadër të reformave për digjitalizimin e shërbimeve, SHSSH ka ndjekur procesin e deregulimit për ofrimin e këtij shërbimi online; megjithatë, 60 aplikime janë refuzuar për shkak të problemeve teknike në sistemin AMS/SQDNE, i cili aktualisht nuk gjeneron dokumentin përfundimta, librin e statusit të jetimit.

Ligji i ri "Për mbrojtjen e të dhënave personale" është miratuar në seancë plenare të Kuvendit më datë 19.12.2024, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt përafrimit të legjislacionit shqiptar me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) dhe Direktivën e BE-së për Policinë. Projektligji, i përgatitur nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u dërgua për shqyrtim pranë Komisionit Evropian më datë 31.10.2022 nga Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator. Më pas, më 28.12.2022, Komisioni Evropian përcolli komentet përkatëse, të cilat u vlerësuan në vijimësi nga institucionet përkatëse përgjegjëse. Ky ligj sjell një sërë risish të rëndësishme, me fokus të veçantë tek mbrojtja e të dhënave personale të fëmijëve si subjekte të të dhënave, ndër të cilat veçohen:

- ▶ Zgjerimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave dhe forcimi i mekanizmave të garantimit të tyre, duke i mundësuar qytetarëve kontroll më të madh mbi të dhënat e tyre personale.
- ▶ Përmirësimi i së drejtës për informim, në mënyrë që informacioni i ofruar nga kontrolluesi të jetë i saktë, transparent, i kuptueshëm dhe lehtësisht i aksesueshëm, me theks të veçantë kur ai i drejtohet fëmijëve.

- Forcimi i kriterëve për dhënien dhe vlefshmërinë e pëlqimit të subjekteve të të dhënave, përfshirë trajtimin e specifikave praktike për pëlqimin e dhënë nga fëmijët, si dhe aplikimin e pëlqimit nëpërmjet mjeteve elektronike.

Miratimi i këtij ligji përbën një avancim të rëndësishëm në mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri, duke përforcuar mbrojtjen e grupeve vulnerabël, siç janë fëmijët, dhe duke garantuar një kuadër të harmonizuar me standardet e Bashkimit Evropian.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve ka hartuar dhe po zbaton një metodologji të re për kontrollin e cilësisë së punës së punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve, e miratuar me Udhëzimin nr. 767, datë 28.12.2023 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me titull “Metodologjia e kontrollit të cilësisë së mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor”. Ky udhëzim metodologjik (u hartua me mbështetjen e UNICEF-it përgjatë vitit 2022) përfaqëson një dokument standardizues që unifikon procedurat në përputhje me kërkesat ligjore për referimin dhe menaxhimin e rasteve, rregullon aktivitetin e kontrollit të cilësisë së punës së strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor, si dhe orienton sjelljen profesionale të vetë Agjencisë gjatë procesit të kontrollit. Pas miratimit të metodologjisë ASHDMF ka bërë pilotimin e metodologjisë në 6 bashki në vitin 2023. Në vitin 2024 u realizua pilotimi në 4 njësi administrative në Tiranë dhe janë hartuar 4 raporte monitorimi. Per vitin 2025 janë zhvilluar 6 kontrole monitorimi dhe janë hartuar 5 raporte të kontrollit të cilësisë.

Mekanizmat e mbrojtjes së fëmijëve përbëjnë një element kyç për garantimin e të drejtave të tyre. Në të gjithë vendin, gjatë periudhës raportuese kanë operuar 370 Punonjës të Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF), të cilët menaxhojnë rastet sipas procedurave të përcaktuara në kuadrin rregulator.

Rishikimi i VKM-së nr. 617, datë 7.9.2006, “Për përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, pagesave për personat me aftësi

të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore,” është realizuar me miratimin e VKM nr. 617, datë 20.10.2021, “Për Treguesit Statistikorë të Vlerësimit e Monitorimit të Programeve të Ndhmës Ekonomike, të Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Shërbimeve Shoqërore, si edhe periodicitetin e mbledhjes së tyre.”

Megjithatë, për zbatimin e plotë të kësaj VKM-je është e nevojshme hartimi dhe miratimi i një udhëzimi të ri, pasi mungesa e tij sjell mangësi në raportimin e treguesve statistikorë për shërbimet sociale, përfshirë treguesit specifikë për fëmijët në skemat e NE dhe PAK dhe të shërbimeve shoqërore. Udhëzimi aktual në fuqi, nr. 1945, datë 4.10.2010, ka kaluar në proces rishikimi dhe do të miratohet së shpejti.

Të dhënat e disponueshme për periudhën dhjetor 2024 janë si më poshtë:

- Numri i fëmijëve (0-18 vjeç) të verbër, paratetraplegjikë, me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore: 10,731;
- Numri i fëmijëve (0-18 vjeç) të familjeve në ndihmë ekonomike: 63000
- Numri i fëmijëve në shërbim kujdestarie në skemën e ndihmës ekonomike: 314;
- Numri i fëmijëve jetim në skemën e ndihmës ekonomike: 1,063;
- Numri i fëmijëve të lindur si trinjakë në skemën e ndihmës ekonomike: 156;
- Numri i fëmijëve të lindur si katërnjakë në skemën e ndihmës ekonomike: 4;
- Numri i fëmijëve në 9 institucione publike të përkujdesit social (IPSH) rezidenciale: 172;
- Numri i fëmijëve në 21 qendra rezidenciale jopublike: 256.

AKEP, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, gjatë vitit 2024 ka marrë masa për bllokimin e aksesit në internet të 24 faqeve online me materiale të paligjshme dhe të dëmshme që lidhen me abuzimin seksual të fëmijëve.

Bashkia Tiranë, me mbështetjen e Terre des Hommes, ka filluar në nëntor 2022 të hartojë metodologjinë e kostimit të Planit Individual të Mbrojtjes për Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve për menaxhimin e rastit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Në vitin 2022, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) në Bashkinë Berat ka përfituar buxhet specifik nga pushteti vendor, duke shënuar një praktikë të mirë të alokimit të fondeve për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Gjatë viteve 2023–2025, në buxhetin e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale të bashkisë është parashikuar një zë i veçantë për mbështetjen e familjeve në nevojë, që shërben gjithashtu si mekanizëm indirekt për mbrojtjen e fëmijëve në rrezik. Gjithashtu, në kuadër të Planit të Përbashkët të Masave “Për parandalimin dhe zbutjen e fenomenit të individëve në situatë rruge”, hartuar nga Bashkia Berat dhe Drejtoria Vendore e Policisë, është ngritur një strukturë ndërinstitucionale veprimi në terren, që ka identifikuar 12 fëmijë në situatë rruge. Të gjitha rastet janë trajtuar sipas protokolleve për menaxhimin e rasteve, duke përfshirë vlerësimin, referimin dhe marrjen në mbrojtje nga strukturat përkatëse.

Përmirësimi i modulit të menaxhimit të rastit (NJMF), pjesë e sistemit të regjistrimit elektronik të shërbimeve sociale, është realizuar në mënyrë graduale, rast pas rasti, sa herë që është identifikuar një problematikë nga administratori i Regjistrimit Elektronik të Shërbimeve Sociale në SHSSH. Reforma e shërbimeve sociale lidhet ngushtësisht me funksionimin e këtij sistemi të menaxhimit të informacionit, i cili siguron transparencë dhe siguri të të dhënave, si dhe mbështet punën e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit (NJVV) në nivel vendor, të cilat janë përgjegjëse për identifikimin e nevojave, hartimin e planeve sociale të kostuara dhe kontraktimin e ofruesve të shërbimeve sociale. Gjatë periudhës 2020–2024 është shënuar progres i vlerësueshëm në trajnimin e përdoruesve të sistemit, përmirësimin e infrastrukturës dhe kontraktimin e mirëmbajtjes së sistemit, me mbështetjen e UNICEF-it. Për të përmirësuar funksionimin e mekanizmit të menaxhimit të rasteve, është mbështetur përmirësimi i modulit të menaxhimit

elektronik të rastit, pjesë e sistemit kombëtar të informacionit social, duke përfshirë trajnimin e strukturave vendore (NJMF, NJVV, KRAT) në të paktën pesë bashki me module të aprovuara nga QKEV-ja.

MSHMS-ja, në kuadër të angazhimit të vazhduar dhe përmbushjes së të gjitha proceduarve në zbatim të ligjit nr. 163/2014, “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka ngritur Urdhrin e Punonjësve Social me datë 18.12.2021. Mbështetja e Urdhrit të Punonjësve Social, çoi në regjistrimin dhe licensimin e 720 punonjësve dhe 943 persona janë të anëtarësuar. Një paketë instrumentesh u zhvillua për të pasuruar njohuritë, për të ndërtuar ndërgjegjësimin gjinor dhe aftësitë e punonjësve socialë për të punuar me të rinjtë në situata të vështira.

Funksionalizimi i sistemit të edukimit dhe akreditimit për punonjës të shërbimeve sociale është në proces, bazuar në miratimin e VKM nr. 637, datë 7.10.2021, “Për ngritjen dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore dhe Sociale”. Është ngritur gjithashtu Bordi i Edukimit në Vazhdim për profesionistët e shërbimeve sociale dhe ka filluar procesi i akreditimit të kurrikulave të ndryshme për trajnimin e tyre.

Përgjatë vitit 2021-2025, punonjës nga sektorë të ndryshëm janë trajnuar dhe janë përmirësuar kapacitetet duke ndikuar në përmirësimin e mekanizmit të identifikimit, raportimit dhe referimit të dhunës dhe mbështetjes së fëmijëve në nevojë për mbrojtje. 80 punonjës policie janë trajnuar për teknikat shkencore të intervistimit të të miturve në kontakt me policinë, si dhe janë zhvilluar takime me Drejtorinë Vendore të Policisë për Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, me mbështetjen e UNICEF Shqipëri. Në kuadër të aktivitetit II.2.2.ç, janë realizuar trajnime të ndryshme për ngritjen e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në NJVV, në kuadër të procesit të deinstitutionalizimit, në bashkëpunim me Nisma ARSIS. Këto trajnime janë zhvilluar mbi bazën e kurrikulave të akredituara dhe të aprovuara nga QKEV-ja, duke mbështetur forcimin e qasjes ndërsektoriale në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Ministria e Brendshme, në përgjigje të rekomandimeve të TIP Report për hetime proaktive dhe dënime të trafikantëve, si dhe me qëllim intensifikimin e bashkëpunimit me organet e drejtësisë në shtator-tetor 2024, me mbështetjen teknike të OSBE-së organizoi 6 takime/trajnime interaktive mes strukturave të policisë dhe prokurorisë, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorisë së Përgjithshme, Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Në këto takime u diskutua rreth analizave të përbashkëta dhe evidentimit të problematikave të thelluara që lidhen me ndjekjen penale të veprave penale të trafikimit, rritjes së bashkëpunimit mes strukturave ligj zbatuese, trajtimit të praktikave më të mira dhe pozitive, si dhe problematikave të evidentuara gjatë analizimit të rasteve të referuar në Autoritetin Përgjegjës.

Gjatë periudhës 14-17 maj dhe 12-14 tetor 2022, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, Policinë, Gjykatat, Prokurorinë dhe Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, ka organizuar trajnimin me tematikë "Hetimi, ndjekja penale dhe gjykimi i rasteve të trafikimit të personave përmes një qasjeje të përqendruar te viktima". Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin përfaqësues të policisë antitrafik, prokurorë, gjyqtarë, Akademia e Sigurisë, Shkolla e Magjistraturës, avokatë të viktimave të trafikimit dhe përfaqësues të mbrojtjes së fëmijëve.

Policia e Shtetit ka raportuar se janë zhvilluar trajnime dhe aktivitete me pjesëmarrjen e 260 specialistëve të Policisë së Shtetit nga të gjitha drejtoritë vendore, të fokusuara në forcimin e kapaciteteve për hetimin proaktiv të rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore. Temat përfshinë: sigurimin e provave, përdorimin e teknikave të veçanta të hetimit, hetimin financiar dhe ndjekjen penale efektive të autorëve. Trajnimet janë realizuar në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë si OSBE, UNODC dhe CIVIPOL. Gjithashtu, janë organizuar trajnime të përbashkëta me Departamentin e Kufirit dhe Migracionit, me pjesëmarrjen e 45 specialistëve nga Shqipëria dhe 45 nga Kosova dhe Maqedonia

e Veriut, në kuadër të projektit me GIZ dhe CIVIPOL. Fokus i trajnimeve ishte identifikimi dhe hetimi i viktimave të trafikimit dhe trafikimit të mundshëm të personave në pikat kufitare, me theks të veçantë tek fëmijët e pashoqëruar dhe grupet e cënueshme.

Gjatë periudhës 2023-2024 sipas raportimit të Ministrisë së Drejtësisë, janë ndërmarrë një sërë iniciativash për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve të sektorëve të ndryshëm, përfshirë policinë, sistemin penitenciar dhe median, në funksion të mbrojtjes së fëmijëve. Në vitin 2023, 118 punonjës policie u trajnuan mbi drejtësinë penale për të mitur, drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin në shkollë. Janë forcuar strukturat për mbrojtjen e të miturve në çdo Drejtori Vendore të Policisë, përmes pozicionit të ri "Specialist për dhunën në familje dhe mbrojtjen e të miturve". Kodi i ri i transmetimit i AMA-s (2023) ka përfshirë një seksion të dedikuar për mbrojtjen e imazhit të fëmijëve në mediat audiovizive. Gjithashtu, janë zhvilluar 12 tryeza konsultuese me operatorët mediatikë dhe programe edukuese për fëmijët në media kombëtare dhe lokale. Në 2024, janë hartuar manuale dhe kurrikula të reja nga Policia e Shtetit dhe Drejtoria e Burgjeve, në bashkëpunim me UNICEF dhe Caritas, për përmirësimin e ndërveprimit me fëmijët në konflikt me ligjin dhe forcimin e rolit të familjes në procesin e riintegritimit.

Është hartuar Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026, në të cilën janë parashikuar masa dhe veprimtari të cilat synojnë parandalimin dhe adresimin e çdo lloji dhune dhe abuzimi në shkollë. Ndërmjet shtatë kompetencave kyçe, dy prej tyre "Kompetenca personale" dhe "Kompetenca qytetare" orientohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe më specifike drejt edukimit për parandalimin e dhunës nëpërmjet ndryshimit të sjelljes dhe qëndrimeve në shkollë dhe në komunitet si dhe në barazinë gjinore. Nisur nga fusha e saj e studimit natyrshëm mendohet se lënda e Qytetarisë trajton çështje që lidhen me të drejtat e fëmijëve, konfliktet dhe zgjidhjen e tyre, pjesëmarrjen e fëmijëve dhe solidaritetin, antidiskriminimin, barazinë gjinore, etj.

Përgjatë vitit 2025, në kuadër të programit

të bashkëpunimit mes Ministrisë së Arsimit, Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar dhe UNICEF "Parandalimi i dhunës në shkollë" janë hartuar një set materialesh (manual, module, broshura) të miratuara nga Ministria e Arsimit për drejtuesit e shkollave, mësuesit, nxënësit dhe prindërit. Miratimi i "Plani Kombëtar i Veprimit për Fuqizimin e Mekanizmave të Parandalimit të çdo Forme Dhune e Bullizmi për Sigurinë në Institucionet Arsimore Parauniversitare".

Institucionet arsimore parauniversitare, kanë ngritur sistemin e identifikimit, të parandalimit dhe të raportimit të dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit në shkolla. Punonjësit e shërbimit psiko-social në institucionet arsimore, ndërmarrin fushata të ndryshme informimi dhe ndërgjegjësimi për parandalimin e dukurisë së dhunës në shkollë dhe jashtë shkolle, në të gjitha format e saj. Mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje, është ngritur në 61 bashkitë e vendit krijohet pranë çdo bashkie me njësinë e mbrojtjes së fëmijës dhe ka për qëllim parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në marrëdhëniet familjare. Bazuar në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, Njësitë e Vetqeverisjes Vendore hartojnë plane vendore për barazinë gjinore, ku kanë parashikuar gjithashtu takime ndërgjegjësuëse dhe informuese me gratë dhe vajzat, si edhe me institucionet e arsimit parauniversitar, ku target kryesor janë nxënësit e shkollave.

Të drejtat e fëmijëve janë përfshirë në kurrikulën shkollore, në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës. Janë zhvilluar sesione informuese për fëmijët, prindërit dhe mësuesit mbi rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave dhe mënyrat e reagimit ndaj shkeljeve. Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve janë organizuar aktivitete sensibilizuese si ese, piktura, këngë dhe shfaqje teatrale. Në mjediset shkollore janë vendosur materiale informuese si postera dhe broshura, ndërsa funksionojnë struktura mbështetëse si Komisioni i Etikës, Komisioni i Disiplinës, SHPS, Oficeri i Sigurisë dhe përfaqësues të Policisë në komunitet, në bashkëpunim me NJMF dhe pushtetin vendor. Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP),

në bashkëpunim me bashkitë, kanë punuar për përmirësimin e kushteve fizike të godinave arsimore dhe garantimin e sigurisë.

Shtimi i numrit të oficerëve të sigurisë në shkolla, është rregulluar me bazë ligjore sipas VKM-së nr. 553, datë 29.7.2022, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 600, datë 9.10.2018, "Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë", i ndryshuar. Është rregulluar baza ligjore për shtimin e oficerëve të sigurisë.VKM-së nr. 600, datë 09.10.2018 "Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë", i ndryshuar. Numri i oficerëve të sigurisë në fund të vitit 2024 ka arritur 222. Oficerët e sigurisë janë punësuar edhe në shkollat 9-vjeçare që kanë të paktën 700 nxënës. Oficerët e Sigurisë trajnohen dhe çertifikohen nga Akademia e Sigurisë, si institucioni përgjegjës për arsimin e lartë policor që ka për qëllim formimin, specializimin, kualifikimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, si dhe ofrimin e trajnimeve dhe specializimeve për institucionet e tjera në fushën e sigurisë dhe rendit publik. Këta oficerë sigurie janë trajnuar nga ASKAP. Oficerët e Sigurisë janë të pranishëm në shkolla çdo ditë nga ora 07:00 deri në 14:00, duke mbështetur nxënësit gjatë gjithë ditës mësimore dhe jashtë saj.

Te gjitha shkollat e vendit janë të mbuluara me shërbim psiko-social, ku një psikolog mbulon 300-499 nxënës dhe 100% e tyre janë trajnuar. Në vitin 2022, për të mbështetur protokollet e punës së punonjësve psiko-socialë, me qëllim rritjen e cilësisë së këtij shërbimi për të gjithë nxënësit, janë hartuar dhe miratuar: "Standardet e përgjithshme profesionale të shërbimit psiko-social shkolle", "Parimet për etikën profesionale të shërbimit psiko-social shkolle" dhe "Udhëzuesi për praktikën e punës së shërbimit psiko-social shkolle". Në funksion të punonjësve të shërbimit psikosocial për trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme apo vlerësimin e tyre janë funksionale 595 kabinete. Në fillim të çdo viti shkolle punonjësit e shërbimit psiko-social në bashkëpunim me drejtuesit e IAP-ve, nisur dhe nga vlerësimi i nevojave të kryera

në shkollë, planifikojnë dhe hartojnë planin vjetor të funksionimit të shërbimit, në cdo institucion arsimor. Në bashkëpunim me të gjithë aktorët në shkollë janë realizuar veprimtari në kuadër të strategjive dhe nevojave të komunitetit shkollor, takime ndërgjegjësuere mbi tema të ndryshme psiko- sociale dhe edukative në funksion të rritjes së nivelit të ndërgjegjësimit dhe edukimit tek fëmijët dhe adoleshëntë. Për vitin shkollor 2023-2024 janë zhvilluar 16891 aktivitete ndërgjegjësuere me nxënës, 3110 aktivitete ndërgjegjësuere me mësues dhe 2389 aktivitete ndërgjegjësuere me prindër, ndërkohë që raporti për periudhën e parë të funksionimit të SHPS mbi aktivitetet e realizuara

Për të parandaluar dhunën, është miratuar edhe udhëzimi nr. 23, datë 1.12.2021, "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 12, datë 10.6.2021, "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e Portalit "Mësues për Shqipërinë", i ndryshuar, ku citohet: "Nuk mund të aplikojnë për konkurrim për të punuar si mësues, pavarësisht faktit të rehabilitimit, të gjithë personat që janë dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale kundërt të miturve; ata që janë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale që lidhet me institucionet arsimore".

Vijon zhvillimi i kapaciteteve të mësuesve, drejtuesve të shkollave, punonjësve social/psikologëve shkollorë, autorëve të teksteve mbi çështjet gjinore etj. Për parandalimin e dhunës në shkolla, me një fokus të veçantë në ndryshimin e qëndrimeve dhe sjelljes së stafit arsimor, prindërve dhe nxënësve është zhvilluar një metodologji e re për trajnimin e mësuesve (Ndërhyrjet e Sjelljes Pozitive në Shkollë) që u ofron mësuesve qasje të reja të menaxhimit të klasës; Mësuesit janë trajnuar për metodologjinë e ndërhyrjeve pozitive të sjelljes me synim parandalimin e dhunës në shkollë; Çdo shkollë ka të përcaktuar një mësues koordinator bazuar në strategjinë ndërsektoriale kundër ekstremizmit të dhunshëm. Numri i mësuesve të koordinatorëve të rrjetit të ekstremizmit në institucionet arsimore është 1137 dhe gjithashtu

janë dhe 52 koordinatorë në çdo ZVAP. Janë trajnuar anëtarët e Komisioneve të Disiplinës dhe Komisioneve të Etikës dhe Sjelljes në të gjithë vendin.

Bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" dhe në VKM nr. 465, datë 3.7.2019 "Për masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet", pika 7 dhe 8, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) ka për detyrë të shqyrtojë raportimet për faqe ose materiale me përmbajtje të dëmshme apo të paligjshme për fëmijët në internet dhe t'i referojë ato pranë strukturave vendore për mbrojtjen e fëmijës, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjatë dy viteve të fundit (2023 – shtator 2024), janë administruar rreth 130 raportime, kryesisht nga fëmijë, prindër dhe punonjës të mbrojtjes së fëmijës, lidhur me keqpërdorimin e të dhënave dhe identitetit të fëmijëve në rrjetet sociale (si hapja e profileve të rreme, publikimi i materialeve denigruese apo bullizuese). Raportimet janë marrë kryesisht përmes linjës telefonike ALO 116-111 dhe lidhen me platforma të përdorura nga fëmijët si TikTok, Instagram, Snapchat, Facebook dhe WhatsApp. Të gjitha rastet janë përcjellë pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), i cili, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, ndjek procedurat për identifikimin e viktimave dhe autorëve, si dhe për mbylljen e faqeve me përmbajtje të tillë. Në rastet kur identiteti i viktimës është i njohur, ASHDMF e referon rastin pranë punonjësve të mbrojtjes së fëmijës për menaxhim në terren dhe marrjen në mbrojtje të fëmijës. Gjatë të njëjtës periudhë, janë menaxhuar nga strukturat vendore për mbrojtjen e fëmijës gjithsej 27 raste dhune në mjedisin dixhital, të cilat përfshijnë shantazhe, kërcënime, publikime të materialeve me përmbajtje intime, bullizëm online dhe krijimin e profileve të rreme në rrjetet sociale.

Per vitin 2025 janë rreth 109 raportime, kryesisht nga fëmijë, prindër dhe punonjës të mbrojtjes së fëmijës, lidhur me keqpërdorimin e të dhënave dhe identitetit të fëmijëve në rrjetet sociale (si hapja e profileve të rreme, publikimi i materialeve denigruese apo bullizuese). Raportimet janë marrë kryesisht përmes linjës

telefonike ALO 116-111 dhe lidhen me platforma të përdorura nga fëmijët si TikTok, Instagram, Snapchat, Facebook dhe WhatsApp. Të gjitha rastet janë përcjellë pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK).

Fuqizimi i shërbimeve të linjave të ndihmës, si ALO 116 111, “Nuk je vetëm” dhe aplikacioni “Raporto dhe shpëto”, ka qenë një komponent thelbësor në garantimin e aksesit të fëmijëve në ndihmë psikosociale dhe raportim të sigurt. Linja Kombëtare e Këshillimit “ALO 116-111,” e mbështetur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, është një shërbim ku fëmijët, marrin ose/edhe referohen aty ku nevojat e tyre mund të adresohen më tej. Gjatë periudhës për vitin 2024, ishin 301 raste të referuara në institucionin e linjës dhe 967 këshilla u ofruan fëmijëve. Nga janari deri në qershor 2025, ishin 203 raste të referuara në institucionin e linjës dhe 311 këshilla u ofruan fëmijëve.

Nën koordinimin e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe mbështetjen e UNICEF-it dhe Terre des Hommes, shërbimi i emergjencës *ad-hoc* për pritjen dhe akomodimin afatshkurtër të rasteve të fëmijëve të riatdhesuar nga zonat e konfliktit, është ofruar nga një ekip punonjësish të ndryshëm për grupe të ndryshme fëmijësh, me pak eksperiencë profesionale për trajtimin e fëmijëve dhe nënave të tyre nga zonat e konfliktit, role dhe përgjegjësi të paqarta institucionale, si dhe paqartësi legjislative. 37 përfitues (28 fëmijë dhe 9 gra) janë mbështetur me plotësimin e nevojave bazike dhe psiko-sociale përgjatë procesit të rehabilitimit. Përgjatë vitit 2022 janë hartuar Procedurat Standarde të Veprimit për rehabilitimin e të kthyerve nga zonat e konfliktit.

Gjatë viteve 2023–2024, ASHDMF ka mbështetur PMF-të në vlerësimin e situatës familjare dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve shqiptarë të riatdhesuar, duke administruar 81 kërkesa për riatdhesim dhe duke lehtësuar procesin për 13 raste të përfunduara. Në tetor 2023, u organizua një tryezë teknike me 15 bashki, në kuadër të një projekti të ICMPD mbi riintegrimin e fëmijëve të pashoqëruar. Sa i takon fëmijëve të huaj të pashoqëruar, 108 raste janë trajtuar gjatë kësaj periudhe (29 në 2023 dhe 79 në 2024). Fëmijët

janë marrë në mbrojtje nga PMF-të pas referimit nga policia dhe strukturat e migracionit. Pas qëndrimit emergjent, shumica janë rikthyer në vendin e origjinës me dëshirën e tyre. Janë ofruar shërbime bazë dhe mbështetje psikologjike gjatë qëndrimit në qendra. ASHDMF ka zhvilluar trajnime dhe aktivitete ndërinstitucionale në bashkëpunim me IOM dhe organizata të tjera, në bashkitë Sarandë, Konispol, Gjirokastrë, Devoll dhe Korçë, për forcimin e kapaciteteve në trajtimin e rasteve të fëmijëve të pashoqëruar. Për vitin 2025, ASHDMF ka mbështetur PMF-të në vlerësimin e situatës familjare dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve shqiptarë të riatdhesuar, duke administruar 215 kërkesa për riatdhesim. Për 4 raste fëmijësh është realizuar riatdhesimi dhe pritja e tyre. Në shtator 2025, u organizuan workshope bashkë Korce dhe Gjirokastrë për diskutimin mbi problematikat e fëmijëve të huaj të pashoqëruar dhe nevojës për rishikimin e VKM 111, për fëmijët e pashoqëruar. Sa i takon fëmijëve të huaj të pashoqëruar, 42 raste janë trajtuar gjatë vitit 2025.

Nisma ARSIS, me mbështetjen e UNICEF-it, gjatë periudhës 2021-2025, ka ofruar Shërbimin e Strehimit Emergjent të Sigurt pranë qendrës “Shtëpia me Ngjyra” në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë për të gjithë fëmijët, shqiptarë apo të huaj, të identifikuar në nevojë të menjëhershme për mbrojtje nga Strukturat për Mbrojtjen e Fëmijëve. Në tërësi, mbështetja është ofruar për 420 fëmijë, nga të cilët, 90 të kategorizuar si të mitur të huaj të pashoqëruar. Kohëzgjatja e qëndrimit të të miturve në shërbimin e emergjencës varion nga disa orë deri në 2.5 muaj. Gjatë periudhës së qëndrimit në qendrën e emergjencës për fëmijët është ofruar paketa e plotë e shërbimit, përfshirë akomodim, veshmbathje, higjienë, ushqim, kujdes shëndetësor, mbështetje psiko-emocionale.



TABELA 21. STATUSI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETEVE (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Nr. i masave	Nr. i aktiviteteve gjithsej	Nr. i aktiviteteve të raportuara	Përqindja e aktiviteteve të raportuara
2	35	34	97%



TABELA 22. STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Statusi	Numri i statusit të aktiviteteve	Përqindja e statusit të aktiviteteve
Plotësisht i realizuar	18	53%
Pjesërisht i realizuar	7	21%
I porealizuar	9	26%






TABELA 23. SHPENZIMET SIPAS STATUSIT TË REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR, VLERË DHE PËRQINDJE)

Statusi	Nr. i aktiviteteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti shtetit	Partnerë
Plotësisht i realizuar	18	107,806,342	53.00%	107,806,342	100.00%	51.67%	48.33%
Pjesërisht i realizuar	7	42,715,720	21.00%	42,715,720	100.00%	51.67%	48.33%
I porealizuar	9	52,886,130	26.00%	52,886,130	100.00%		

SHPENZIMET FINANCIARE

Objekti i specifik II.2 përfshin dy masa me gjithsej 35 aktivitete: 16 në masën e parë dhe 19 në masën e dytë. Nga këto, 10 aktivitete janë planifikuar me kosto zero, pasi janë të mbuluara në plane të tjera veprimi. Sipas të dhënave të planit të veprimit, për periudhën 2021–2026 buxheti i planifikuar synonte të mbulonte rreth 82.7% të kostove treguese, ndërsa pjesa tjetër konsiderohej hendek financiar. Rezultatet sipas statusit të realizimit tregojnë se: 18 aktivitete janë realizuar plotësisht, me një buxhet të planifikuar prej 107,806,342 lekë. Shpenzimet janë realizuar në masën 100%, ku 51.67% e fondeve kanë ardhur nga buxheti i shtetit dhe 48.33% nga partnerët. 7 aktivitete janë

realizuar pjesërisht, me një buxhet të planifikuar prej 42,715,720 lekë. Edhe këto janë realizuar financiarisht 100%, me të njëjtën ndarje të burimeve: 51.67% buxheti i shtetit dhe 48.33% partnerët. 9 aktivitete nuk janë realizuar, me një buxhet të planifikuar prej 52,886,130 lekë. Në total, për periudhën raportuese janë shpenzuar 100% e fondeve të planifikuara për aktivitetet e realizuara (plotësisht dhe pjesërisht), ndërkohë që rreth 26% e buxhetit të planifikuar i përket aktiviteteve të porealizuara.

Objektivi specifik II.3.

Mekanizma dhe shërbime të specializuara dhe të integruara për trajnimin e formave të rënda të dhunës, përfshirë abuzimin seksual dhe abuzimin dhe shfrytëzimin on-line

Treguesit kryesorë në nivel objektivash të veçanta nën këtë qëllim strategjik, janë:



numri i shërbimeve të specializuara të ngritura dhe funksionale për fëmijët, viktima të dhunës dhe abuzimit seksual - [*i realizuar* (Shkodër dhe Fier)]



numri i rasteve të abuzimit seksual të fëmijët dhe shfrytëzimin on-line, të hetuara nga autoritetet përgjegjëse (30 raste çdo vit) - [*i realizuar*]

Në zbatim të Konventës së Lanzarotës dhe Ligjit nr. 18/2017, është miratuar Udhëzimi i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 564, datë 5.10.2022, "Për miratimin e standardeve për qendrat e trajtimit të fëmijëve viktima apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës". Ky udhëzim përcakton parimet e funksionimit, strukturën ndërsektoriale dhe standardet për ofrimin e shërbimeve të integruara, të koordinuara dhe të menjëhershme për fëmijët viktima. Ky udhëzim përcakton parimet e funksionimit, strukturën ndërsektoriale dhe standardet për ofrimin e shërbimeve të integruara, të koordinuara dhe të menjëhershme për fëmijët viktima.

Në bashkëpunim me UNICEF, janë ngritur dhe janë funksionale dy qendra të modelit "me një ndalesë" në Bashkitë Fier dhe Shkodër, që ofrojnë shërbime të specializuara për fëmijët viktima të abuzimit seksual. Këto qendra ofrojnë shërbime të integruara për fëmijët viktima të dhunës seksuale dhe abuzimit të rëndë, përfshirë asistencë ligjore, mbështetje psikologjike dhe mjekësore, si dhe ndjekje të koordinuar të rasteve nga grupet ndërsektoriale. Në vijim, është investuar për ngritjen e kapaciteteve të

qendrave me një ndalesë, duke ofruar trajnime që kanë pasur në fokus ndarjen e përvojave në punën me fëmijët dhe të rinjtë e traumatizuar nga qendra për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve në Zagreb, Kroaci. Gjatë periudhës nëntor 2022 deri më sot, janë trajtuar gjithsej 69 raste:

- ▶ Qendra në Fier ka trajtuar 50 fëmijë (31 vajza dhe 19 djem) dhe 24 prindër jo abuzues;
- ▶ Qendra në Shkodër ka trajtuar 19 fëmijë (12 vajza dhe 7 djem) dhe 9 prindër jo abuzues.
- ▶ Këto qendra përfaqësojnë një model të mirëfilltë të ndërhyrjes së koordinuar ndër-institucionale për mbrojtjen dhe rehabilitimin e fëmijëve viktima.

Janë miratuar standardet për funksionimin e qendrave me një ndalesë për trajtimin e fëmijëve viktima të dhunës seksuale dhe formave të tjera të rënda të dhunës, si dhe janë zhvilluar modele të reja për ofrimin e shërbimeve rehabilituese të specializuara, me qëllim që ndërhyrjet të jenë të qëndrueshme, të integruara dhe të shtrihen në mënyrë të gjerë në nivel kombëtar.

Më datë 29 prill 2024, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale organizoi workshop-in me temë: "Ndarja e përvojave në mbështetje të të mbijetuarave/mbijetuarve të dhunës seksuale në Shqipëri". Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga tre qendra të menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale, së bashku me mekanizmat përkatës të referimit. Ërkeshop-i shërbeu si një platformë për të prezantuar dy modele shërbimesh rehabilituese, për të ndarë praktikat më të mira dhe për të identifikuar sfidat kryesore në ofrimin e mbështetjes për të miturit viktima të dhunës seksuale. Ky aktivitet përbën

një hap konkret drejt hartimit të propozimeve për shërbime të specializuara rehabilituese për këtë kategori fëmijësh në nevojë.

Aktualisht është në proces draftimi marrëveshja ndërinstytucionale e bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), Prokurorisë dhe Policisë së Shtetit. Në draft marrëveshje është përfshirë dhe ASHDMF, sipas një kërkesë për përfshirjen e ASHDMF në këtë marrëveshje. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional për të rritur nivelin e sigurisë kibernetike në vend dhe për të përmirësuar reagimin ndaj krimeve online që prekin fëmijët dhe të rinjtë. Marrëveshja synon krijimin e një grupi të specializuar me përfaqësues nga policia, prokuroria dhe ofruesit e shërbimeve të internetit, i cili do të ofrojë ekspertizë, mbështetje teknike dhe operacionale për hetimin e përmbajtjeve të paligjshme në internet që përbëjnë kërcënim për sigurinë publike dhe mbrojtjen e fëmijëve. Pritet miratimi zyrtar i dokumentit.

Gjatë majit 2024, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me UNICEF, zhvilloi trajnime 3-ditore mbi "Teknikat shkencore të intervistimit me të mitur" në Lezhë, Vlorë dhe Tiranë, me pjesëmarrjen e 150 punonjësve policie. Po ashtu, u organizua një trajnim 1-ditor për 17 shefa komisaratesh në Tiranë. Në bashkëpunim me UNICEF dhe QPKMR, janë trajnuar 14 punonjës policie për përdorimin e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale me të Mitur. Brenda strukturave të Policisë së Shtetit funksionojnë njësi të specializuara për hetimin e pornografisë me të mitur: në nivel qendror (1 shef sektori dhe 2 specialistë), në Tiranë (1 shef seksioni dhe 1 specialist), dhe në drejtoritë vendore (nga 2 specialistë për hetimet e krimeve kompjuterike). Gjatë vitit 2024 janë realizuar gjithashtu 6 aktivitete trajnimi dhe ëorkshop-e mbi krimet online kundër fëmijëve, me pjesëmarrjen e 10 punonjësve policie nga strukturat hetimore.

Në fund të vitit 2024, në kuadër të ndryshimeve strukturore, në Drejtorinë për Hetimin e Krimit

Kibernetik u krijua Sektori i Analizës dhe Monitorimit 24/7, me 3 ekspertë të specializuar, të cilët merren me analizimin e provave digjitale në lidhje me krimet online kundër fëmijëve. Deri më tani, ekzaminimi i provave dixhitale është realizuar nga Sektori i Ekzaminimeve Kompjuterike në Laboratorin e Policisë Shkencore. Policia e Shtetit bashkëpunon ngushtë me NCMEC (Qendra Kombëtare për Fëmijët e Zhdukur dhe të Shfrytëzuar) dhe ka akses në programin ICACOPS, përmes të cilit shkëmbehen të dhëna për rastet e shfrytëzimit seksual dhe pornografisë me të mitur në internet, si dhe identifikohen adresat IP të autorëve të dyshuar. Gjithashtu, po zhvillohet një bashkëpunim me organizatën OUR Rescue nga SHBA, e cila do të kontribuojë me pajisje dhe softëare të specializuar për identifikimin e autorëve të veprave penale në mjedisin dixhital, duke forcuar më tej kapacitetin hetimor të Policisë së Shtetit.

Është realizuar bashkërendim i vazhdueshëm me Agjencinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike (AKSK) për trajtimin në kohë reale të rasteve që lidhen me abuzimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve në internet. Falë këtij bashkëpunimi dhe ndërveprimit me Autoritetin për Komunikimet Elektronike dhe Postare (AKEP), është mundur mbyllja e disa faqeve dhe platformave online që ofronin përmbajtje të paligjshme.

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK)¹², ka administruar raportimet e dërguara nga ASHMDf-ja gjatë vitit 2021 dhe 2022, me qëllim bashkërendimin e punës dhe trajtimin në kohë reale të raportimeve të bëra në lidhje me abuzimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve në internet. Sipas raportimeve të kryera në portal, në vitin 2021 numërohen rreth 72 raportime, ndërsa në vitin 2022, 25 raportime. Gjithashtu, në datat 6 - 8 dhjetor 2021, AKSK-u ka organizuar Cyber Camp, me synim rritjen e nivelit të sigurisë së fëmijëve në mjedisin *on-line* dhe ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve të fushës, përfshirë ata të sistemit të drejtësisë. Në datat 19-21 Prill 2022, workshop-in novator "Regional Cyber Camp Albania" me rreth 100 të

12. Në AKDF gjendet me emërtimin e parë Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), në këtë raport me emërtimin e ndryshuar Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK)

rinj dhe 50 profesionistë nga Shqipëria, Kosova, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi. Në muajin shkurt të çdo viti, organizohen aktivitete sensibilizuese në kuadër të "Ditës së Internetit të Sigurt". Në këtë kuadër, në vitin 2022 u organizua një aktivitet sensibilizues me nxënës nga shkolla 9-vjeçare dhe të mesme, prindër dhe mësues, të ftuar tek Qendra COD në Kryeministri.

Në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes ASHDMF dhe Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), gjatë periudhës shkurt–dhjetor 2024 janë realizuar 34 aktivitete ndërgjegjëse dhe informuese në nivel kombëtar në shkolla 9-vjeçare dhe të mesme në Tiranë, Durrës, Kukës, Shkodër, Fier, Berat, dhe bashki të tjera, duke ndërgjegjësuar 1,277 fëmijë dhe 244 profesionistë (mësues, punonjës psikosocialë, prindër). Aktivitetet kanë synuar informimin mbi raportimin e rasteve të bullizmit, ngacmimeve dhe shantazheve online, si dhe edukimin mbi praktika bashkëkohore për lundrim të sigurt në internet. Po ashtu, janë zhvilluar 5 workshope për profesionistë dhe prindër në Tiranë, Kukës, Durrës dhe Cërrik, me 243 pjesëmarrës. Në vitin 2023, ASHDMF dhe AKSK organizuan takime me 76 profesionistë të drejtësisë në bashkitë Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Krujë, mbi ndëshkueshmërinë e abuzimeve online. Gjithashtu, janë realizuar trajnime me PMF në Dibër, Klos, Tiranë dhe Lushnjë mbi modulën "Higjiena Kibernetike dhe Mbrojtja e Fëmijëve në Internet", me 55 pjesëmarrës.

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2025, në bashkëpunim me ASHDMF dhe WVA, si dhe nga vetë AKSK, u realizuan gjithsej 38 aktivitete, nga të cilat: 2 trajnime për trajner ku pjesë ishin PMF-të dhe Senatorët e gjimnazeve, të cilët kanë vijuar me aktivitete ndërgjegjëse mbi njohuritë e mara nga trajnimi, workshop, webinar dhe 1 tryezë e rrumbullakët me pjesëmarrjen e disa institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve në hapësirën online, si dhe 33 takime ndërgjegjëse me fëmijë dhe profesionistë në shkolla 9-vjeçare dhe gjimnaze të qytetit të Tiranës. Numri total i personave të ndërgjegjësuar në këto aktivitete të zhvilluara është 1327 fëmijë dhe të rinj dhe u plotësuan 1192 pyetësorë.

Në fokus të këtyre aktiviteteve ishte mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve online përmes këshillave të vazhdueshme, se si të mund të përdorin hapësirën digjitale në mënyrë të sigurtë duke menduar para se të veprojnë në dhënien e informacionit të panjohurve, pasi ata padashur mund të jenë të ekspozuar ndaj kërcënimeve online, gjuhës së dhunshme apo mund të jenë viktimë e bullizimit online apo ngacmimeve seksuale. U informuan se nëse do të ishin pjesë e ndonjë rasti të cituar me lart të raportojnë në faqen e aksk.gov.al tek butoni kuq RAPORTO.

Gjatë vitit 2025- kane ardhur 225 raportime, të cilat janë trajtuar rast pas rasti në bashkëpunim me Policinë e Shtetit.

Në kuadër të ndërgjegjësimit për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve online, është realizuar dhe një spot televiziv, i cili është transmetuar në 3 televizione përgjatë 10- ditëve në muajin nëntor. Ministria e Brendshme, në kuadër të punës ndërinstitucionale për njoftimin dhe heqjen e materialeve të paligjshme dhe të dëmshme të abuzimit seksual dhe shfrytëzimit të fëmijëve *on-line*, në kuadër të zbatimit të Vendimit me nr. 494, datë 30.12.2020, është miratuar Strategjia për Hetimin e Krimeve Kompjuterike dhe po ndjek procesin në vijim për mbrojtjen e fëmijëve *on-line*.

Gjithashtu, është avancuar puna për përmirësimin e kapaciteteve të Laboratorit Shkencor të Policisë, për analizimin e të dhënave digjitale të lidhura me krimet online ndaj fëmijëve (masë II.3.1.ë), si dhe për ngritjen e kurseve të specializuara në Shkollën e Magjistraturës dhe Akademinë e Sigurisë për prokurorë, gjykatës e oficerë të rinj, për të thelluar ekspertizën në fushën e krimeve seksuale dhe kibernetike kundrejt fëmijëve.



TABELA 24. STATUSI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETEVE (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Nr. i masave	Nr. i aktiviteteve gjithsej	Nr. i aktiviteteve të raportuara	Përqindja e aktiviteteve të raportuara
1	10	9	90%



TABELA 25. STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Statusi	Numri i statusit të aktiviteteve	Përqindja e statusit të aktiviteteve
Plotësisht i realizuar	7	78%
Pjesërisht i realizuar	2	22%
I porealizuar	0	0%






TABELA 26. SHPENZIMET SIPAS STATUSIT TË REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR, VLERË DHE PËRQINDJE)

Statusi	Nr. i aktiviteteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti shtetit	Partnerë
Plotësisht i realizuar	7	58,543,796	78.00%	58,543,796	100.00%	32.28%	67.72%
Pjesërisht i realizuar	2	16,512,353	22.00%	16,512,353	100.00%	32.28%	67.72%
I porealizuar							

SHPENZIMET FINANCIARE

Objektivi specifik II.3 përbëhet nga një masë me gjithsej 10 aktivitete, prej të cilave 2 aktivitete janë të buxhetuara në plane të tjera. Për periudhën raportuese 2021–2026, shpenzimet e planifikuara kanë synuar të mbulojnë tërësisht kostot treguese të përcaktuara në planin e veprimit. Nga të dhënat e raportuara rezulton se: 7 aktivitete janë realizuar, me një buxhet të planifikuar prej 58,543,796 lekë ose 78% të totalit. Shpenzimet faktike janë realizuar plotësisht (100%) dhe janë financuar në masën 32.28% nga buxheti i shtetit dhe 67.72% nga partnerët. 2 aktivitete janë realizuar, me një buxhet të planifikuar prej 16,512,353 lekë ose 22% të totalit, gjithashtu me realizim të plotë (100%). Edhe në këtë rast,

ndarja e burimeve të financimit është 32.28% buxheti dhe 67.72% partnerët. Nuk rezultojnë aktivitete të porealizuara. Në përfundim, për periudhën 2021–2025 është shpenzuar 100% e fondeve të planifikuara, duke mbuluar në mënyrë të plotë kostot e parashikuara për aktivitetet e këtij objektivi specifik. Financimi ka qenë i kombinuar, por mbështetja kryesore ka ardhur nga organizatat dhe institucionet partnere, të cilat kanë mbuluar rreth 2/3 e shpenzimeve faktike.

Qëllimi III.

Sistemet dhe shërbimet miqësore për fëmijë dhe adoleshentë

Qëllimi i tretë ka në fokus sistemet dhe shërbimet miqësore për fëmijë dhe adoleshentë dhe përfshin nxitjen e proceseve e sistemeve miqësore me fëmijët, si: në arsim, shëndetësi, shërbime shoqërore dhe drejtësi. Në këtë aspekt, është synuar më së shumti evidentimi i masave kryesore të strategjive sektoriale për të arritur vlerësimin e progresit të të drejtave të fëmijëve në këto fusha.

Institucionet kanë raportuar për 100% të treguesve që lidhen me objektivat specifike të këtij qëllimi strategjik, dhe 88% e tyre janë realizuar plotësisht.

Informacion është raportuar për 96 nga 103 aktivitetet që janë pjesë e qëllimit strategjik, prej të cilave vetëm 64% janë realizuar plotësisht.



TABELA 27. NIVELI I RAPORTIMIT TË TREGUESVE TË REZULTATIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Numri i treguesve	Të paraportuara	Të raportuara
17	0	17
100%	0%	100%



TABELA 28. STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE TË REZULTATIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Total tregues (Nr. & %)	Plotësisht i realizuar	Pjesërisht i realizuar	I parealizuar
17	15	2	0
100%	88%	12%	0%



TABELA 29. STATUSI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETEVE (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Nr. i masave	Nr. i aktiviteteve gjithsej	Nr. i aktiviteteve të raportuara	Përqindja e aktiviteteve të raportuara
9	103	96	93%



TABELA 30. STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Statusi	Numri i statusit të aktiviteve	Përqindja e statusit të aktiviteve
Plotësisht i realizuar	66	69%
Pjesërisht i realizuar	25	26%
I përealizuar	5	5%




TABELA 31. SHPENZIMET SIPAS STATUSIT TË REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR, VLERË DHE PËRQINDJE)

Statusi	Nr. i aktiviteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti shtetit	Partnerë
Plotësisht i realizuar	66	811,290,613	69.00%	811,290,613	100.00%	62.78%	37.22%
Pjesërisht i realizuar	25	305,703,709	26.00%	305,703,709	100.00%	62.78%	37.22%
I përealizuar	5	58,789,175	5.00%	58,789,175			

Objektivi specifik III.1.

Mundësi të barabarta për zhvillimin e aftësive dhe të mësuarit: nga fëmijëria e hershme, në adoleshencë

Treguesit kryesorë në nivel objektivash të veçanta nën këtë qëllim strategjik, janë:

- ➔ përqindja e fëmijëve që janë regjistruar në klasën e parë në krahasim me numrin e përgjithshëm të fëmijëve 6 vjeç - [*i realizuar*]
- ➔ përqindja e braktisjes shkollore - [*pjesërisht i realizuar*]
- ➔ numri i fëmijëve që përfitojnë nga mekanizmi i mbështetjes financiare (bursave) për kategoritë e fëmijëve në nevojë (VKM nr. 854)¹³ - [*i realizuar*]

Nën drejtimin e Ministrisë së Arsimit (MA) dhe me mbështetjen e UNICEF-it, politikat për edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme (EKFH) në Shqipëri u përafrauan me standardet e BE-së si dhe u zhvillua një plan veprimi për reformimin e EKFH për fëmijët e moshës 0–6 vjeç¹⁴. Drejtuar nga ASCAP, një grup pune është duke finalizuar Guidën mbi Standardet e Ofrimit të Shërbimit në Çerdhe, bazuar në modelin Francez, ndërsa janë miratuar¹⁵ “Korniza e vlerësimit të cilësisë së kopshtit” dhe “Udhëzuesit metodologjik për realizimin e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të kopshtit”. Po përgatitet e gjithë procedura e pilotimit me fëmijët e moshës 5-6 vjeç në klasat përgatitore.

Përgjatë viteve ‘23-’24 ka vijuar ngritja e kapaciteteve të mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve të arsimit parashkollorit ku 100%

e tyre janë trajnuar për zbatimin e kurrikulës me kompetenca dhe për metodologjinë e të nxënësve me përqendrim fëmijët, përfshirë ata me aftësi të kufizuara (AK).

Ndërgjegjësimi i prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor vazhdon të bëhet nëpërmjet veprimtarive të mirë planifikuara në nivel të zyrave vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) dhe institucioneve parashkollore, si dhe të shkollave të arsimit bazë pranë të cilave janë atashuar klasat përgatitore, në bashkëpunim edhe me qeverisjen vendore. Aktivitetet kanë ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimit të prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor, megjithëse vazhdon të mbetet sfida planifikimi i saktë i numrit të prindërve të fëmijëve me AK për t’u përfshirë në aktivitete ndërgjegjëse.

Paralelisht, në kuadër të ndërgjegjësimit të komunitetit dhe promovimit të një qasjeje të kujdesshme ndaj fëmijëve të moshës parashkollore janë ndërmarrë iniciativa të shumta për të forcuar prindërimin pozitiv¹⁶. Në bashkëpunim me organizatat partnere me ekspertizë të sprovuar në këtë fushë, si UNICEF, OSBE, WV, Tdh dhe Save the Children, janë hartuar module edukimi për prindërimin pozitiv në shërbim të profesionistëve lokalë si dhe po synohet drejt realizimit të një pakete të përbashkët trajnimit për unifikimin e praktikave.

Gjatë vitit shkollor 2024-2025 janë hapur 270

13. VKM-ja e cituar i Këshillit të Ministrave si vendimi nr. 666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar.

14. Raporti vjetor UNICEF, 2024

15. Bazuar në urdhrin nr.199, datë 7.05.2024

16. Gjate 2023-2024 janë trajnuar 190 prinder ne kuader te iniciatives se zbatuar ne bashkepunim me WVA

klasa përgatitore dhe numri i nxënësve të regjistruar pranë tyre është 5563. ZVA-të bashkëpunojnë çdo vit me njësitë vendore për të identifikuar fëmijët në moshë shkollore dhe për të ndërhyrë në rastet me rrezik, përmes takimeve sensibilizuese me grupet e interesit.

Mbështetja financiare/bonus i çerdhes dhe kopeshtit për familje me të ardhura të ulëta, për të mundësuar frekuentimin e tyre, është raportuar vetëm nga bashkia Korce, ku përgjatë vitit 2024 janë mbështetur financiarisht me bonusin e çerdhes/kopshtit¹⁷ 35 fëmijë. Nderkohë që vetëm dy bashki, ajo e Kamzës dhe e Fierit, kanë raportuar për përjashtimin e nxënësve Rome e Egjiptianë 3-6 vjeç nga tarifatat financiare dhe pagesat për ushqim. Në këto bashki fëmijët e komunitetit, të regjistruar në kopështe dhe cerdhe e përfitojnë falas shërbimin dhe nuk paguajnë tarifë mujore.

Tanimë të gjitha shkollat përdorin sistemin SMIP¹⁸. MA ka miratuar dhe shpërndarë rregulloren për përdorimin dhe funksionimin e plotë të sistemit, e cila ka finalizuar të gjitha rolet e institucioneve si MA, ASCAP, QSHA dhe DPAP për funksionimin korrekt të tij si dhe ka përfunduar trajnimi i të gjithë personelit. Aktualisht në koordinim me AKSHI po bëhet popullimi i SMIP me të gjitha videot e përgatitura nga RTSH Shkolla në kohën e pandemisë, në mënyrë që të mundësohet përdorimi i SMIP edhe si një sistem e-learning. Aktualisht janë rreth 1245 rrjete profesionale, të cilat janë trajnuar në mënyrë të vazhdueshme nga specialistët e ASCAP-it, për udhëzuesin e funksionimit të rrjeteve, për planifikimin e punës vjetore të rrjeteve, për mënyrën e raportimit, si dhe për tema përmbajtësore si: zbatimi i kurrikulës me kompetenca, zbatimi i kurrikulës në të gjitha klasat etj. Gjithashtu gjatë periudhës korrik-dhjetor 2024 janë ngritur kapacitetet e 300 mësuesve ndihmës dhe mësuesve të klasave,

me të cilët bashkëpunojnë, mbi praktikat gjithpërfshirëse në klasë dhe në shkollë.

Programi kombëtar i zhvillimit profesional të mësuesve ka filluar të zbatohet në Mars 2024 nga 7 Institucione të Arsimit të Lartë si: Universiteti i Tiranës, Korçës, Durrësit, Elbasanit, Vlorës, Shkodrës, Gjirokastrës. Deri në muajin dhjetor 2024 janë trajnuar gjithsej 16.045 mësues për një modul dhe 7.046 mësues për dy module të lidhura me përmirësimin e cilësisë së procesit të mësimdhënie - nxënies me fokus zbatimin e njohurive në situata të jetës reale si dhe përdorimin e metodave efektive të mësimdhënie - nxënie gjatë orës mësimore.

Që prej vitit 2023, në institucionet e arsimit të detyrueshëm është ngritur dhe bërë funksional sistemi për parandalimin dhe reagimin ndaj mosregjistrimit në shkollë dhe braktisjes së nxënësve në arsimin fillor. Në vitin 2024, me mbështetjen e UNICEF dhe ASCAP, ky sistem u shtri edhe në 84 shkolla të arsimit të mesëm të lartë dhe 14 shkolla të formimit profesional në rang vendi. Manuali përkatës, i miratuar nga ASCAP, udhëzon hapat dhe procedurat që duhen ndjekur, dhe mbi 970 punonjës të shkollave janë trajnuar për ta zbatuar¹⁹. Një nga veçoritë e këtij sistemi është edhe përfshirja e teknikave për zhvillimin e aftësive socio-emocionale tek nxënësit, si pjesë e qasjes parandaluese. Deri tani, janë mbështetur 17,261 nxënës ku 400 adoleshentë (260 djem dhe 140 vajza) kanë përfituar nga plane individuale për parandalimin e braktisjes. Në disa bashki janë ndërmarrë masa të strukturuar për bashkëpunim mes shkollave, njësive vendore dhe komuniteteve, për të identifikuar raste të fëmijëve në rrezik braktisjeje të cilët me pas janë mbështetur edhe përmes përfshirjes në skemat e bursave sipas VKM nr. 666. Gjithashtu, është krijuar një strukturë e re e grupeve të terrenit përmes një programi të

17. Të dhënat për mbështetjen financiare/bonus i çerdhes/kopeshtit, bazohet vetëm në informacionin e dhënë nga 51 bashki, bazuar në instrumentin e raportimit për AKDF-në 2021-2026

18. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar është baza dixhitale e të dhënave e cila kombinon të dhënat administrative me rezultatet e të nxënësve. Sistemi krijon regjistrin elektronik të notave, të mungesave dhe të aktivizimit të nxënësve në klasë, ndërsa prindërit njihen me ecurinë e fëmijëve nëpërmjet një aplikacioni në celular.

19. Raporti vjetor '24, UNICEF Albania

mbështetur nga UNDP²⁰, e cila operon në nivel lokal për identifikimin dhe referimin e rasteve në kohë reale, duke e bërë ndërhyrjen më efektive dhe gjithëpërfshirëse.

Përsa i përket përpjekjeve për të adresuar gjithëpërfshirjen e nxënësve me AK në sistemin arsimor, aktualisht pjesë e sistemit parauniversitar janë 2266 mësues ndihmës, në mbështetje të 5233 nxënës me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të zakonshme të vlerësuar nga komisionet multidisiplinare pranë ZVAP. Krahasuar me vitin 2022, raporti është ulur nga 3 nxënës AK me 1 mësues, në rreth 2.5 nxënës AK me 1 mësues ndihmës. Në cdo ZVAP janë ngritur rrjetet profesionale të mësuesve ndihmës si dhe janë përfshirë në mënyrë periodike në seminare dhe trajnime të organizuara nga ASCAP, si dhe OJF të ndryshme në bashkëpunim me MAS me qëllim mbështetjen profesionale të fëmijëve me AK. Në zbatim të Urdhërit të brendshëm, Nr. 42 Datë 15.01.2024 “Të ngrihen kapacitetet e mësuesve ndihmës për mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta” janë rritur kapacitetet me 66 rrjete të mësuesëve ndihmës, të cilat kane monitoruar dhe trajnuar rreth 300 mësues ndihmës çdo vit në të gjithë vendin.

Planifikimi i buxheteve për sigurimin e materialeve didaktike sipas kërkesave të veçanta të kategorive të ndryshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar, është realizuar dhe përfshin përfitimin nga fëmijët me AK: transport falas; trajtim falas në institucionet e arsimit special; tekste falas, sipas VKM-ve përkatëse të përvitshme²¹.

Ndërkohë po punohet për paisjen e shkollave me

mjetet dhe programet e duhura teknologjike. Në kuadër të projektit “EU for inclusive teaching”, investimet u fokusuan në mjedisin mësimor të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë duke i pajisur me letër Braille dhe filloi me sukses procesi për prodhimin e rreth 17 librave audio DAISY 3. Për integrimin e nxënësve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore parauniversitare janë hapur 291 klasa burimore të pajisura me mjete didaktive, me qëllim zhvillimin e potencialeve dhe rritjen akademike të nxënësve, ndërkohë që ende nuk janë të pajisur me mjetet dhe programet teknologjike.

Gjatë ‘23-’24 është finalizuar procesi i kthimit të shkollave speciale, përkatësisht “Luigj Gurakuqi”, “Instituti i Nxënësve që Nuk Dëgjojnë” dhe “Instituti i Nxënësve që Nuk Shikojnë “Ramazan Kabashi” në Qendra Burimore, në zbatim të tre urdhërave të MAS nxjerrë në vitin 2024²². Mësuesit e shkollave speciale janë të trajnuar 100%.

Shërbimi Psiko-Social (SHPS) në bashkëpunim me institucionet arsimore ka realizuar takime me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara (AK), me qëllim vlerësimin dhe mbështetjen e ecurisë së tyre në shkollë. Njekohesisht për të mbështetur prindërit, janë organizuar seanca informuese dhe trajnime mbi aftësitë e kufizuara, të drejtat e fëmijëve dhe burimet ndihmëse, duke u fokusuar në një qasje që thekson aftësitë dhe potencialet e fëmijës. Gjithashtu, janë ngritur grupe mbështetëse për prindërit dhe ofruar këshillim psikologjik, me synim fuqizimin emocional dhe ndërtimin e një marrëdhënieje pozitive e përfshirëse me fëmijën, si dhe krijimin e një mjedisi shkollor gjithëpërfshirës që mirëpret çdo fëmijë me aftësi të kufizuara.

Ndërkohë, vlen për t’u përmendur se gjatë ‘23-

20. Raporti vjetor ‘23, ‘24 i programit LNB (Leave no one behind) zbatuar nga 5 agjensi UN

21. Bazuar në Urdhërin e brendshëm Nr.22, datë 15.01.2024 “Të hartohet një paketë me mjete didaktike dhe programe teknologjike për 8 shkollat e arsimit special” dhe urdhrin të brendshëm, Nr. 17, datë, 15.01.2024 “Të hartohen programet mësimore për arsimin e mesëm të orientuar “TEKNOLOGJI DHE TIK”, për nxënësit që nuk dëgjojnë klasa XII”, janë hartuar dhe miratuar programet për shkollën e mesme të orientuar “Teknologji dhe TIK” për nxënësit që nuk degjojnë, klasa 10, 11 dhe 12

22. Urdhri nr.448, datë 26.08.2024, “Për miratimin e riorganizimit të institucionit të arsimit special “Luigj Gurakuqi” në Qendër Burimore, emërtesës, strukturës dhe organikës”; Urdhri nr. 449, datë 26.08.2024, “Për miratimin e riorganizimit të Institutit të Nxënësve që Nuk Dëgjojnë, në Qendër Burimore, emërtesës, strukturës dhe organikës”; Urdhri nr.450 datë 26.08.2024, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e riorganizimit të Institutit të Nxënësve që Nuk Shikojnë “Ramazan Kabashi”

'24 është rritur bashkepunimi nderinstitucional për referimin dhe mbështetjen me shërbime arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara" i ndërmjet SHSSH-së dhe DAR-ve, për mbështetjen me shërbime të arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Insitucionet arsimore (IA) janë angazhuar në hartimin e planeve në gjithëpërfshirjen e fëmijëve nga grupet në nevojë, duke përfshirë edhe ato Rome/Egjiptiane, në arsimin formal dhe atë joformal. Shkollat janë angazhuar në mënyrë specifike për të eliminuar pengesa që ndikojnë në regjistrimin e nxënësve të komuniteteve të marginalizuara Rome/Rgjiptiane (si p.sh. ndërhyrjet dhe asistencë e drejtpërdrejtë në procesin e regjistrimit elektronik në SMIP, që si rregull është përgjegjësi e vetë prindit/kujdestarit ligjor). Në disa ZVAP-e ofrohet shërbimi i koordinatorit me komunitetet Rome dhe Egjiptiane për të mundësuar kontaktin e shkollave me familjet në rastet me tendencë braktisjeje të arsimit të detyruar. Realizohen në mënyrë sistematike ng IA, hapat e përcaktuar në manualin e parandalimit të braktisjes shkollore (MPBSH) duke filluar me identifikimin e nxënësve me tendencë, vlerësimi i situatës së tyre, ngritja e planit individual të punës, monitorimi etj, si dhe zbatohen teknika individuale për mbështetjen shkollore, promovimin e rasteve të suksesshme, angazhimin në veprimtari shkollore, inkurajimin etj. Mbështetje financiare për nxënësit Romë, Egjiptianë dhe grupet vulnerabël është realizuar plotësisht, me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 119, datë 01.03.2023, "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit" dhe rishikimi i VKM-së nr. 666, datë 10.10. 2019, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike", e ndryshuar. VKM-ja bën të mundur mbështetjen me bursë të disa kategorive sociale, si nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë, nxënësit e pakicave rome dhe egjiptiane dhe nxënësit me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton, për të frekuentuar rregullisht arsimin.

Në zbatim të VKM nr. 511, datë 28.07.2022, shkollat që frekuentohen nga nxënës Rome dhe Egjiptiane po hartojnë e zbatojnë programe të vecanta passhkollore. Nisma "Bëjmë detyrat e shtëpisë", për vitin shkollor 2023-2024 ka përfshirë 189 shkolla në të gjithë vendin (nga 138 shkolla deri me '22), rreth 8665 nxënës (nga 7,647 më '22) të shpërndarë në 451 klasa. Ky projekt u mundëson fëmijëve, përfshirë edhe atyre Rome/Egjiptiane dhe nga shtresa të marginalizuara të bëjnë detyrat e shtëpisë me shokët e tyre dhe nën kujdesin e mësuesve, në mjediset e shkollave, duke krijuar lehtësira për prindërit e fëmijëve si dhe një barazi dhe socializim për të gjithë. Deri në shtator 2024, mbështetur në "Standardet për Shkollën Qendër Komunitare" dhe kriterëve të përzgjedhjes, janë 541 shkolla që funksionojnë si SHQK dhe që zhvillojnë veprimtari të ndryshme duke funksionuar sipas klubeve jashtë shkollore pas procesit mësimor. Ndërkohë, është raportuar nga bashkitë se 3,968 prindër Rom dhe Egjiptianë, të cilët nuk kanë aftësi shkrim-leximi, kanë marrë pjesë në kurset e shkrim-leximit dhe aftësive bazë. Të gjithë ata janë prindër që i përkasin pakicës Rome; janë femra dhe vijnë nga zonat urbane.

Platforma Akademia.al, u krijua me mbështetjen e UNICEF-it. Kjo platformë është e kompletuar me materiale sipas kurrikulës me kompetenca. Për përdorimin e saj në mësimin online janë trajnuar rreth 1200 mësues të TIK-ut. Gjithashtu janë krijuar platforma të tjera online që kanë si qëllim përdorimin e përmbajtjeve digjitale në kuadër të kurrikulës me kompetenca. ASCAP ka përgatitur dhe publikuar dokumentin "Për metodologjinë e mësimin online të kombinuar". Gjatë '23-'24, janë trajnuar 570 drejtues rrjetesh për përdorimin e TIK në procesin mësimor, 200 drejtues të shkollave të pajisura me smartlabe, 400 mësues të arsimit fillor për përdorimin e smartlabeve, si dhe 200 mësues të TIK në po këto shkolla; ndërkohë, është hartuar edhe një manual shoqëruar me video-tutoriale për të lehtësuar aksesin dhe përdorimin e portalit dhe të dhënave të tij.

Në vijim të zbatimit të sistemit *on-line* AKELIUS për grupet që janë të vështira për t'u arritur (migrues / refugjatë) janë trajnuar 300 mësues, gjithashtu janë hartuar dy udhëzues, të cilët

mund të aksesohen në faqen e ASCAP-it. Deri më sot sistemi është përdorur nga 1567 nxënës refugjatë, ku përqindjen më të madhe të përdorueseve e zënë meshkujt (861).

Nismat për zhvillimin e kapaciteteve të Parlamentit dhe Qeverisë së Nxënësve janë realizuar plotësisht, duke përfshirë zgjedhjen e legjislaturës së tretë të Parlamentit të Nxënësve të Shqipërisë (PNSH), formimin e Bordit drejtues dhe ristrukturimin e 8 komisioneve funksionale me përbërje nga deputetët e rinj. Anëtarët e parlamentit janë trajnuar tërësisht mbi detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, ndërsa kanë organizuar një sërë aktiviteteve sipas kalendarit të ditëve të shënuara, duke forcuar pjesëmarrjen e tyre në proceset vendimmarrëse brenda shkollës.

Funksionon rrjeti i shkollave demokratike dhe gjithëpërfshirëse si dhe rrjeti i mësuesve "Teacher-Net" me rreth 250 anëtarë. Janë zhvilluar aktivitete me mësues, nxënës dhe prindër mbi tema si edukimi qytetar, qytetaria digjitale, siguria në internet, edukimi mediatic, ndryshimet klimatike dhe lufta kundër bullizmit. Është hartuar dhe publikuar një udhëzues për mësuesit, ndërsa janë trajnuar 720 drejtues të rrjeteve profesionale për kompetencën e qytetarisë demokratike. Mësues nga DRAP-et Durrës dhe Lezhë janë përfshirë në këto rrjete dhe trajnimet përkatëse. Edukimi për qytetarinë demokratike ka një rol të rëndësishëm në sistemin arsimor, si pjesë e kurrikulës, por edhe nëpërmjet projekteve si ai i zhvilluar me Këshillin e Evropës dhe SIDA "Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri".

Vetëm një numër i kufizuar bashkish kanë ngritur shërbime të dedikuara argëtuese dhe kulturore. Në mjaft prej tyre këtë rol e kryejnë qendra rinore apo qendra multifunksionale. Bashkitë Kavajë, Sarandë, Mat, Vlorë, Korce, Berat dhe së fundmi Bashkia Shijak i kanë funksionale këto qendra, të cilat, mbështetur edhe nga organizata lokale apo ndërkombëtare janë përpjekur të gjallërojnë jetën kulturore/argëtuese për grupmoshat e reja²³.

MAS ka hartuar planin kombëtar për rimëkëmbjen dhe qëndrueshmërinë e sistemit arsimor ndaj emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore dhe ASCAP ka hartuar module trajnimi për mësuesit lidhur me emergjencat civile dhe fatkeqësitë natyrore. Janë zhvilluar seanca informuese nëpër drejtoritë arsimore rajonale mbi udhëzuesin "Edukimi për menaxhimin e emergjencave dhe sigurinë në shkollë", i cili synon t'u vijë në ndihmë shkollave 9-vjeçare për planifikimin e veprimtarive për menaxhimin e situatave emergjente, zhvillimin e aftësive për jetën dhe të një kulture të qëndrueshme të sigurisë në shkollë. Secili institucion arsimor parauniversitar ka hartuar një plan masash vjetore për menaxhimin e rrezikut nga katastrofat.

Ka patur zhvillime intensive dhe signifkative në drejtim të orjentimit të karrierës për sistemin e arsimit parauniversitar përgjatë '23-'24. Janë hartuar dhe publikuar një sërë udhëzuesish që përbejnë modelin e udhëzuesit të karrierës, përkatësisht: "Udhëzuesi për orientimin për karrierën në klasat 6-9", i miratuar me nr.246/1, date 13.1.2023 dhe i publikuar; "Udhëzues për mësuesin koordinator të këshillimit të karrierës në AML" i hartuar dhe publikuar; "Udhëzues për mësuesin koordinator të këshillimit të karrierës në AMU" i hartuar dhe publikuar". Paralelisht janë trajnuar të gjithë mësuesit koordinatorë të këshillimit të karrierës në AML

23. Dhjetra aktivitete lokale, artistike dhe koncerte janë realizuar në kuadër të prograit ReLOaD të UNDP në Kamëz, Kukës, Lushnjë dhe Patos me fëmijë dhe të rinj gjatë 2021-2024



TABELA 32. STATUSI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETEVE (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Nr. i masave	Nr. i aktiviteteve gjithsej	Nr. i aktiviteteve të raportuara	Përqindja e aktiviteteve të raportuara
5	43	43	100%



TABELA 33. STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Statusi	Numri i statusit të aktiviteteve	Përqindja e statusit të aktiviteteve
Plotësisht i realizuar	32	74%
Pjesërisht i realizuar	8	19%
I parealizuar	3	7%






TABELA 34. SHPENZIMET SIPAS STATUSIT TË REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR, VLERË DHE PËRQINDJE)

Statusi	Nr. i aktiviteteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti shtetit	Partnerë
Plotësisht i realizuar	32	182,743,610	74.00%	182,743,610	100.00%	40.87%	59.13%
Pjesërisht i realizuar	8	46,920,654	19.00%	46,920,654	100.00%	40.87%	59.13%
I parealizuar	3	17,286,557	7.00%	17,286,557	100.00%		

SHPENZIMET FINANCIARE

Objektivi specifik III.1 përbëhet nga pesë masa me gjithsej 43 aktivitete, prej të cilave 12 janë të buxhetuara në plane të tjera. Për periudhën 2021–2026, shpenzimet e planifikuara për këtë objektiv synonin të mbulonin 93.0% të kostove treguese. Sipas të dhënave të raportuara: 32 aktivitete janë realizuar plotësisht, me një buxhet të planifikuar prej 182,743,610 lekë (74% e totalit). Shpenzimet faktike janë realizuar plotësisht (100%), ku 40.87% janë financuar nga buxheti i shtetit dhe 59.13% nga partnerët. 8 aktivitete janë realizuar pjesërisht, me një buxhet të planifikuar prej 46,920,654 lekë (19% e totalit).

Edhe këto aktivitete kanë pasur realizim të plotë të shpenzimeve (100%), me të njëjtën ndarje të burimeve (40.87% buxhet, 59.13% partnerë). 3 aktivitete nuk janë realizuar, me një buxhet të planifikuar prej 17,286,557 lekë (7% e totalit). Në përfundim, për periudhën 2021–2025 janë shpenzuar 100% e fondeve të planifikuara për aktivitetet e realizuara (plotësisht dhe pjesërisht), ndërkohë që vetëm 7% e buxhetit i përket aktiviteteve të parealizuara.

Objektivi specifik III.2.

Sistem i integruar i mbrojtjes sociale, i ndjeshëm ndaj nevojave të fëmijëve dhe familjeve

Treguesit kryesorë në nivel objektivash të veçanta nën këtë qëllim strategjik, janë:

- ➔ numri i fëmijëve që jetojnë në familje që përfitojnë ndihmë ekonomike (trend zbritës) [*i realizuar*]
- ➔ numri i fëmijëve që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar (trend rritës) [*pjesërisht i realizuar*]
- ➔ numri i bashkive që kanë ngritur strukturat NARU sipas përcaktimeve ligjore [*pjesërisht i realizuar* : 29 bashki]
- ➔ numri i shërbimeve të ngritura me fondin social për fëmijët [*i realizuar*]
- ➔ numri i qendrave të shndërruara në shërbime komunitare për fëmijën dhe familjen [*i realizuar*]
- ➔ numri i fëmijëve në shërbim kujdestarie [*pjesërisht i realizuar*]

INSTAT ka publikuar rregullisht raportet e Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës në Shqipëri për vitet 2017, 2018, 2019, 2022, 2023 dhe 2024.²⁴

Sot në Shqipëri ofrohen shërbime shoqërore për të gjithë grupet vulnerabël në 446 qendra përkujdesi²⁵ ose rreth 30% më shumë sesa në vitin 2021. Këto qendra sigurojnë shërbime të përkujdesit shoqëror për 68,724 përfitues, individë në nevojë; nga këto, përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, janë kryesisht fëmijët deri 16 vjeç (47%).

Në vitin 2025, 13% e numrit të përgjithshëm të Shërbimeve të Kujdesit të Specializuar (SCS) janë shërbime rezidenciale dhe 87% shërbime

të bazuara në komunitet; 71% e institucioneve funksionojnë në nivel lokal. Personat me aftësi të kufizuara përbëjnë grupin kryesor të përfituesve në të gjitha rajonet, me 28% të tyre që mund të marrin shërbime në nivel kombëtar. Qendrat publike ofrojnë rreth 61% të totalit të shërbimeve sociale, ndërsa ato jopublike 39%.

Modeli bio-psiko-social i sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar po aplikohet në të gjithë vendin. Procesi i vlerësimit bazuar në këtë model realizohet përmes përdorimit të Regjistrat Kombëtar Elektronik të Aftësisë së Kufizuar, i cili mundëson transparencë dhe efektivitet në këtë skemë.

Për rreth 62000 fëmijët nga familjet e skemës së ndihmës ekonomike, ofrohet subvencion për nxitjen e arsimimit dhe vaksinimit, kompensim të energjisë elektrike, shërbime shëndetësore falas si në parësor dhe dytësor, përjashtime nga tarifat në të gjitha fazat e ndjekjes së edukimit dhe përfitime bursash e lehtësira në disa procese.

Janë marrë masa për rritjen e transfertave në para, veçanërisht për familjet me kryefamiljare femra dhe ato me tre e më shumë fëmijë, për të cilat shuma është dyfishuar. Nga kjo shumë e shtuar, kanë përfituar rreth 62 mijë fëmijë. Ndihma financiare për fëmijët pa kujdes prindëror u trefishua. Politika e bonusit të bebes, duke filluar nga viti 2019, mbështet drejtpërdrejt fëmijët dhe familjen, duke garantuar shpërblimin (bonusin) për çdo të porsalindur (40 000 lekë për fëmijën e parë, 80 000 lekë për fëmijën e dytë dhe 120 000 lekë për fëmijën e tretë). Mbi 42,000 nëna të reja (42767) kanë përfituar nga bonusi i bebes. Nga vitit 2019 e deri me sot janë përfituar 231,565 bonuse të bebes., përfshirë ndërsa për periudhën Janar- Qershor 2025 janë përfituar gjithsej 10679 bonuse të bebes.

24. <https://www.instat.gov.al/sq/temat/kushtet-sociale/anketa-e-te-ardhurave-dhe-nivelit-te-jeteses-aanj/#tab1>

25. Përfshirë edhe shërbimet sociale të mbështetura nga Mekanismi i Fondit Social për 2025-ën.

Nga 2023-i po zbatohet një politikë e re për mbështetjen e grave të papuna me tre e më shumë fëmijë nga subvencionimi i shtetit për pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Për të mbështetur gratë e papuna, nënat me 3 apo më shumë fëmijë të mitur, shteti mundëson subvencionimin 100% të sigurimeve sociale dhe kontributeve shëndetësore bazuar në pagën minimale. 9,200 gra të papuna kanë përfituar nga kjo politikë.

Mbështetje e familjeve (me paketa të kompozuar për familjet me shumë fëmijë, përfituese të skemës së ndihmës ekonomike) është ofruar nga organizatat jofitimprurëse në kuadër të programeve mbështetëse në rajone të ndryshme ose nga biznese lokale. Gjatë vitit '23-'24 World Vision-i ka mbështetur me paketa ushqimore dhe artikuj higjieno-sanitarë 2,458 familje, ndërsa gjatë vitit 2024, numri i fëmijëve të mbështetur, ishte 28,873²⁶. Terre des Hommes, gjatë 2023-it, ka mbështetur 136²⁷ familje përmes strategjive për fuqizimin ekonomik. Gjatë viteve 2021-2025 janë mbështetur nga Nisma ARSIS me shërbime direkte duke përfshirë paketa ushqimore dhe artikuj higjieno-sanitare rreth 3500 fëmijë. Gjatë viteve 2021-2022, CRCA/ECPAT Shqipëri me mbështetjen e UNDP-së dhe Fondit Social, si dhe me dhurime nga kompanitë ONE Communication, SPAR etj., kanë mbështetur me paketa veshjesh, ushqimesh dhe çanta e mjete mësimore falas rreth 1000 fëmijë në Shqipëri, thuajse gjysmën e tyre në Qarkun Korçë.

Është miratuar VKM 224/2024 për metodologjinë e re të llogaritjes dhe shpërndarjes së fondeve nga fondi social, si dhe VKM 613/2024, mbi disa ndryshime në VKM 111/2018 mbi ngritjen dhe funksionimin e FS vendor, ku tashmë bashkitë duhet të ngrenë fonde sociale në planet vendore "Përkujdesi social". Ka përparim të ndjeshëm në numrin e bashkive që kanë përfituar nga Fondi Social 19 në vitin 2021 (; 51 në vitin 2024; dhe 59 në 2025), duke financuar shërbime për 3,932 dhjetëra mijëra përfitues. Të 61 bashkitë e vendit, deri në fund të vitit 2024 janë pajisur me plane sociale të buxhetuara dhe miratuara, si një kusht

i domosdoshëm për të aplikuar për mbështetje financiare nga mekanizmi i Fondit Social.

Në kuadër të Fondit Social janë krijuar 24 shërbime të specializuara për fëmijët, përfshirë 9 shërbime lëvizëse për fëmijët me aftësi të kufizuara, 8 qendra ditore, 4 shërbime për fuqizimin e familjes biologjike dhe 4 qendra multifunktionale, si dhe një linjë kombëtare këshillimi. Nga këto shërbime kanë përfituar mbi 3,sh800 fëmijë në situata të ndryshme, duke përfshirë fëmijë me aftësi të kufizuara dhe fëmijë në rrezik për braktisje. Gjatë vitit 2024, falë një rritjeje prej 7% të buxhetit (324 milionë lekë), janë mbështetur 73 shërbime në nivel bashkiak dhe rajonal, duke përfshirë 51 bashki dhe përfituar mbi 32,800 individë në nevojë. Ndërhyrjet përfshinë edhe përmirësime në kuadrin rregullator, për të inkurajuar bashkëpunimin ndërbashkiak dhe integrimin e fondit social në buxhetimin afatmesëm vendor. Në vitin 2025, fondi është rritur me 14.2%, duke arritur 369 milionë lekë, duke mundësuar financimin e 84 shërbimeve në 59 bashki dhe përfitimin e mbi 62,700 individëve, një rritje prej gati 12,000 përfituesish krahasuar me vitin e mëparshëm. Kjo mbështetje vijon të jetë thelbësore për forcimin e shërbimeve sociale vendore dhe rritjen e aksesit për grupet më vulnerabël.

Në funksion të ngritjes së kapaciteteve të NJVV-ve dhe strukturave vendore për përfitimin nga Fondi Social, është realizuar një proces i vazhdueshëm trajnimi dhe asistence teknike nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, SHSSH dhe partnerët ndërkombëtarë. Në kuadër të programit EU4SI TA, është hartuar një metodologji për optimizimin e shërbimeve sociale dhe udhëzuesi për prokurimin e tyre, ndërsa të gjitha strukturat vendore në 61 bashki janë trajnuar për zbatimin e këtyre procedurave, duke synuar rritjen e efektivitetit në përdorimin e fondeve të alokuara nga buxheti qendror.

Gjatë viteve '23-'24 një pjesë e mirë e bashkive kanë ndërmarrë hapa konkretë për ngritjen e kapaciteteve të strukturave të NJVV-së dhe bashkëpunimin me punonjësit e NARU-së, me synimin për të informuar dhe mbështetur familjet

26. Raporti vjetor 2023 dhe 2024, World Vision Albania

27. Raporti vjetor 2023, Terre des Hommes Albania

përfituese të ndihmës ekonomike për akses në masat dhe shërbimet sociale. Në disa prej tyre, të gjithë administratorët socialë janë trajnuar për këtë funksion si dhe janë zhvilluar aktivitete informuese të drejtpërdrejta me familjet në ndihmë ekonomike, duke i orientuar drejt shërbimeve sociale shtesë. Megjithatë majft bashki kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm, zbatimi i këtij aktiviteti nuk është i njëtrajtshëm dhe kërkon përforsim përmes trajnimeve sistematike dhe formalizimit të bashkëpunimit ndërmjet administratorëve dhe NARU në nivel vendor. Në kuadër të Programit LNB2 ka ofruar trajnime dhe mentorime për administratën vendore në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale, për 420 profesionistë, si dhe ka ndihmuar me konsolidimin e metodologjive për vizitat në shtëpi.

Është miratuar VKM 768/2021, ndryshuar me VKM 292/2024 për prokurimin e shërbimeve sociale, si dhe është hartuar Udhëzuesi i zbatimit të këtij vendimi. Ndryshimet në VKM 292/2024 kanë standardizuar dhe lehtësuar procedurat për prokurimin e shërbimeve sociale nga bashkitë. Këto akte rregullojnë mënyrën se si fondet publike përdoren për të kontraktuar ofrues të shërbimeve sociale, duke rritur transparencën dhe efikasitetin. Udhëzuesi i zbatimit ndihmon njësitë vendore të zbatojnë vendimin në mënyrë të qartë dhe të njëtrajtshme

Është miratuar Korniza e standardeve bazë të shërbimeve sociale me Udhëzim Ministri 281/2024, si dhe janë rishikuar standardet e shërbimit rezidencial të përkujdesit social për fëmijë të grupmoshës 0-5 vjeç, miratuar me Udhëzim Ministri 169/2024, si janë rishikuar standardet për shërbimin rezidencial të përkujdesit për fëmijë të grupmoshës 6-16 vjeç, të miratuara me Udhëzim Ministri 631/2022. Krahasuar me standardet e mëparshme, këto rishikime dhe miratime përfaqësojnë një hap përpara në drejtim të profesionalizimit dhe cilësisë së shërbimeve sociale për fëmijët në Shqipëri.

Është parashikuar një rishikim i politikës së bonusit të bebes, ku përveç mbështetjes financiare të menjëhershme të jepet dhe një pagesë mujore për mirërritjen e fëmijës e ndarë sipas moshës së fëmijës. Është në proces të planifikimit në fazën e parë të përgatitjes së projekt-buxhetit afatmesëm 2026-2028.

Ndërkohë mbështetja për bonusin e bebes ka vazhduar për të gjithë të sapolindurit dhe familjet e tyre, përmes një shpërblimi financiar, pa dallim statusi social apo ekonomik, si dhe në kuadër të nxitjes për rritjen e lindshmërisë.

Është miratuar Korniza e standardeve bazë të shërbimeve sociale me Udhëzim Ministri 281/2024, si dhe janë rishikuar standardet e shërbimit rezidencial të përkujdesit social për fëmijë të grupmoshës 0-5 vjeç, miratuar me Udhëzim Ministri 169/2024, si janë rishikuar standardet për shërbimin rezidencial të përkujdesit për fëmijë të grupmoshës 6-16 vjeç, të miratuara me Udhëzim Ministri 631/2022.

Ka filluar procesi i deinstitutionalizimit të fëmijëve në qendrat rezidenciale të zhvillimit, me ngritjen e shërbimeve të kujdesit alternativ i specializuar për fëmijët me aftësi të kufizuara:

- 18 shërbime lëvizëse për personat me aftësi të kufizuara, ku marrin shërbime 665 fëmijë me aftësi të kufizuara, nga të cilët 188 fëmijë me çrregullime të spektrit të autizmit, në bashkitë Librazhd, Lezhë, Rogozhinë, Elbasan, Maliq, Vau i Dejës, Dropull, Dibër, Has, Gjirokastrë, Patos, Tiranë, Selenicë, Dimal, Libohovë, Finiq, Shijak, Kuçovë të cilat ofrojnë shërbimin lëvizës të specializuar në banesë. Ky është shërbim i integruar, duke mbështetur fëmijën për akses në shkollë, edukim dhe shërbime shëndetësore sa herë që fëmija ka nevojë. Shërbimi mbulon trajtimin psiko-social të fëmijës dhe familjarëve.

Janë funksionale 7 Qendra Ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara, të cilat kanë ofruar shërbime për gjithsej 983 përfutues në bashkitë Lushnjë, Kavajë, Gramsh, Bulqizë, Kamëz dhe Patos. Paralelisht, është realizuar edhe procesi i vlerësimit gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuara në qendrat e zhvillimit, në funksion të planifikimit dhe ofrimit të shërbimeve të përshtatura sipas nevojave individuale.

Në drejtim të deinstitutionalizimit, mekanizmi i referimit dhe bashkëpunimit vazhdon të funksionojë bazuar në Udhëzuesin e Manaxhimit të Rasteve të fëmijëve, që nga identifikimi, këshillimi, informimi, hartimi i planit të ndërhyrjes dhe ndjekja e rastit gjatë marrjes së shërbimit. Udhëzuesi është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me UNICEF. Në Shkodër, Tiranë dhe Durrës, u shtuan përpjekjet për të

parandaluar ndarjen e fëmijëve nga familjet dhe për të mbështetur ribashkimin familjar, me stafin social që ofroi mbështetje të dedikuar për 83 fëmijë në rrezik dhe familjet e tyre, përmes vizitave në shtëpi, kurseve për prindërimin dhe këshillimit psikologjik. Gjithashtu, 160 profesionistë në pesë bashki morën trajnim mbi reformën e deinstitutionalizimit dhe shërbimet mbështetëse për fëmijët.

Janë transformuar dy qendrat e përkujdesit shoqëror për fëmijë 0-5 vjeç në shërbime mbështetëse për fëmijët dhe familje (SHMFF) në bashkitë Korçë dhe Vlorë. Ky proces ka përdorur një metodologji të replikueshme, zhvilluar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me UNICEF dhe miratuar nga komiteti drejtues i deinstitutionalizimit. Po vijon procesi me bashkitë Durrës dhe Shkodër. Në kuadër të transformimit të dy qendrave rezidenciale të lartëpërmendura është pilotuar edhe shërbimi i specializuar i kujdestarisë alternative. Një model përlllogaritjeje të kostos për shërbimet e kujdestarisë u finalizua në vitin 2024 me qëllim mbështetjen e qëndrueshmërisë.

Është hartuar dhe pilotuar formati i Regjistrit të familjeve Kujdestare në bashkitë Tiranë, Shkodër, Vlorë dhe Korçë. 139 prindër të rinj u trajnuan mbi ribashkimin e fëmijëve me familjen dhe modelet e kujdesit të bazuar në familje. Hapat e ardhshëm përfshijnë: hartimin dhe miratimin e Ligjit për Kujdesin Alternativ, në përputhje me standardet ndërkombëtare; krijimin dhe promovimin e programeve të kujdestarisë me mbështetje financiare dhe profesionale; dhe zgjerimin e shërbimeve të specializuara të bazuara në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke siguruar aksesueshmëri.

Në kuadër të nismës për ngritjen e burimeve njerëzore, në bashkëpunim me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, u realizua me sukses trajnimi i 132 profesionistëve vendas që punojnë drejtpërdrejt me fëmijët, të rinjtë dhe familjet në nevojë (institucionet e kujdesit publik, qendrat komunitare dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijëve.) Trajnimi u fokusua në tema kritike si riintegrimi i fëmijëve në familjet biologjike, qasja e menaxhimit të rasteve dhe metodologjia për përgatitjen e të rinjve për të lënë kujdesin. Ky ndërtim i kapaciteteve u zhvillua në Shkodër dhe Tiranë, duke fuqizuar profesionistët me aftësitë

dhe njohuritë për të mbështetur më mirë popullatat vulnerabël. Gjatë viteve 2022-2023 janë trajnuar edhe profesionistë të ndryshëm me programe prindërimi të evidentuar dhe staf i institucioneve të kujdesit publik në Vlorë dhe Korçë me temë riintegrimi.

Një pjesë e mirë e njësive të vetëqeverisjes vendore kanë ndërmarrë hapa konkretë për ngritjen e kapaciteteve të NJMF dhe NJVNR-ve. Disa bashki si Tirana, Durrësi, Elbasani, Korça, Cërriku, Kuçova, Librazhdi, Kamza dhe Kruja raportojnë për trajnime të drejtpërdrejta në lidhje me procesin e identifikimit të hershëm të fëmijëve dhe familjeve në risk, zhvillimin e planeve individuale të mbrojtjes dhe fuqizimit të familjes, si dhe përf forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional përmes mekanizmave si Grupet Teknike Ndërsektoriale (GTN). Në këto bashki, janë evidentuar praktika të strukturuar të menaxhimit të rasteve dhe ndërtimit të ndërhyrjeve të koordinuara në nivel komunitar. Shembuj konkretë të përdorimit të qasjes gatekeeping përfshijnë rastin e Bashkisë Tiranë, ku përmes 423 mbledhjeve të GTN gjatë vitit 2024, janë marrë vendime për ofrimin e masave mbrojtëse dhe zhvillimin e planeve të fuqizimit të familjes përpara çdo institucionalizimi të fëmijës. Bashkia Elbasan ka zhvilluar sesione mentorimi me punonjës të NJVNR, shërbimeve sociale, policisë, sistemit shëndetësor dhe nxënës, në kuadër të projektit RISE Her, që prekin edhe aspektet e planeve të veprimit dhe gatekeeping.

Megjithatë, shumë bashki të tjera raportojnë aktivitete më të përgjithshme informuese ose ndërgjegjësuere, pa specifikuar qartë trajnime për stafet e NJMF/NJVNR në lidhje me identifikimin e hershëm dhe mekanizmat e gatekeeping.

Më 10 shtator 2024, u zhvillua takimi i Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve. Qëllimi i këtij takimi ishte paraqitja dhe miratimi i planit të masave për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Komiteti i Konventës për të Drejtat e Fëmijës, si dhe prezantimi i modelit “Garancia për Fëmijët”, si një nga masat prioritare të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030. Kjo strategji, e miratuar me VKM nr. 152, datë 13.03.2024, ka parashikuar gjithashtu në objektivat strategjik rishikimin e përgjigjes ndaj krizave e skemave financiare dhe përfitimeve për individët.



TABELA 35. STATUSI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETEVE (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Nr. i masave	Nr. i aktiviteteve gjithsej	Nr. i aktiviteteve të raportuara	Përqindja e aktiviteteve të raportuara
2	26	25	96%



TABELA 36. STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Statusi	Numri i statusit të aktiviteteve	Përqindja e statusit të aktiviteteve
Plotësisht i realizuar	15	60%
Pjesërisht i realizuar	8	32%
I porealizuar	2	8%






TABELA 37. SHPENZIMET SIPAS STATUSIT TË REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR, VLERË DHE PËRQINDJE)

Statusi	Nr. i aktiviteteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti shtetit	Partnerë
Plotësisht i realizuar	15	401,030,688	60.00%	401,030,688	100.00%	71.00%	29.00%
Pjesërisht i realizuar	8	213,883,033	32.00%	213,883,033	100.00%	71.00%	29.00%
I porealizuar	2	53,470,758	8.00%	53,470,758	100.00%		

SHPENZIMET FINANCIARE

Objekti i specifik III.2 përbëhet nga dy masa me gjithsej 26 aktivitete, prej të cilave 4 janë të buxhetuara në plane të tjera. Sipas planit të veprimit, për periudhën 2021–2026 shpenzimet e planifikuara duhej të mbulonin 69.8% të kostove treguese, ndërsa pjesa tjetër (rreth një e treta) ishte identifikuar si hendek financiar. Nga të dhënat e raportuara: 15 aktivitete janë realizuar plotësisht, me një buxhet të planifikuar prej 401,030,688 lekë (60% e totalit). Shpenzimet janë realizuar në masën 100%, nga të cilat 71.0% janë mbuluar nga buxheti i shtetit dhe 29.0% nga partnerët. 8 aktivitete janë realizuar pjesërisht, me një buxhet të planifikuar prej 213,883,033 lekë (32% e totalit).

Edhe këto aktivitete kanë pasur realizim të plotë financiar (100%), me të njëjtën ndarje të burimeve të financimit (71.0% buxheti i shtetit, 29.0% partnerë). 2 aktivitete nuk janë realizuar, me një buxhet të planifikuar prej 53,470,758 lekë (8% e totalit). Në total, për periudhën raportuese janë shpenzuar 100% e fondeve të planifikuara për aktivitetet e realizuara (plotësisht dhe pjesërisht), ndërsa një pjesë e vogël e buxhetit (8%) mbetet e lidhur me aktivitetet e porealizuara.

Objektivi specifik III.3.

Përmirësimi i shëndetit të fëmijëve dhe adoleshentëve.

Treguesit kryesorë në nivel objektivash të veçanta nën këtë qëllim strategjik, janë:

→ përqindja e fëmijëve nën 5 vjeç, nën peshë, në ulje - [*i realizuar*]

→ përqindja e fëmijëve nën 5 vjeç me rritje të prapambetur për moshën, në ulje [*i realizuar*]

→ përqindja e fëmijëve që ushqehen ekskluzivisht me qumësht gjiri deri 6 muaj [*pjesërisht i realizuar*]

→ numri i njësive të kujdesit intensiv neonatal që zbatojnë standardet e reja të kujdesit të të porsalindurve - [*i realizuar*]

MSHMS ka hartuar Planin e Veprimit për Shëndetin Riprodhues 2021–2030 si dhe ka miratuar 10 protokolle standarde të trajtimit për kujdesin neonatal dhe zbatimin e despitimit neonatal për identifikimin e hershëm të sëmundjeve gjenetike apo çrregullimeve të tjera tek fëmijët²⁸. 21 mjekë dhe 120 infermierë nga shërbimi i neonatologjisë janë trajnuar për kujdesin neonatal dhe zbatimin e programeve të depistimit.

Në të 362 Qendrat Shëndetësore të vendit, të Kujdesit Shëndetësor parësor, janë trajnuar gjithsej 831 profesionistë mjekësorë mbi Protokollin e Praktikës Klinike për Mbështetjen e Rritjes dhe Zhvillimit të Fëmijëve 0–6 vjeç. Gjithashtu, rreth 3,400 infermierë janë trajnuar për ofrimin e kujdesit shëndetësor në banesë. Po në këto qendra, janë trajnuar edhe 1,436 profesionistë të tjerë mbi monitorimin e praktikave të ushqyerjes për fëmijët 0–2 vjeç

dhe mbi ndjekjen e rritjes për fëmijët 0–5 vjeç. Ndërsa në Kujdesin Shëndetësor Spitalor, në 11 Spitalet Rajonale dhe 24 Spitalet Bashkiake janë trajnuar 49 mjekë dhe 221 infermierë të shërbimit të obstetrikë-gjinekologjisë mbi zbatimin e protokolleve në maternitete dhe kujdesin amtar.

Nga njësitë e promocionit dhe edukimit shëndetësor të 36 Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor janë organizuar 1,359 fushata ndërgjegjësuere apo takime mbi kujdesin gjatë shtatëzanisë në kushtet e shtëpisë. Nga këto takime kanë përfituar në total 4,469 gra shtatëzana. Nërkohë, për periudhën 2023–2024 rezultojnë se nga 36 Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor janë kryer rreth 312 trajnime mbi prindërimin e sigurt gjatë fazës së parë të jetës dhe adoleshencës nga të cilat kanë përfituar rreth 3,391 prindër.

Po gjatë kësaj periudhe, janë trajnuar 545 personel shëndetësor të atashuar në ofrimin e shërbimit në çerdhe dhe arsimin parashkollor si dhe janë kryer 255 trajnime në kuadër të mirërritjes dhe zhvillimit psikomotorr të fëmijës të organizuara në rreth 30 bashki të vendit.

Njësitë e promocionit dhe edukimit shëndetësor pranë Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor kanë kryer një sërë aktivitete dhe fushatash ndërgjegjësimi me fëmijë dhe adoleshtë në shkollat 9-vjeçare dhe gjimnazet e vendit. Më specifikisht janë realizuar mbi 1200 aktivitete mbi tema të lidhura me shëndetin riprodhues, edukimin seksual në fëmijë dhe adoleshentë, abuzimin me drogërat²⁹, ku kanë marrë pjesë rreth 41,272 fëmijë e adoleshentë. Gjithashtu, ISHP në bashkëpunim me NJVKSH kanë organizuar

28. Bazuar në urdhrin nr. 727, datë 30.12.2022

29. Cështjet e parandalimit të abuzimit të substancave, përfshirë drogat dhe alkolin, trajtohen gjërësisht në "Planin e veprimit për parandalimin, trajtimin dhe reduktimin e dëmit nga drogat Shqipëri 2023 – 2026", miratuar në Mars 2024 si dhe në dokumentin e Planit të Veprimit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Dëmeve të Lidhura me Alkolin në Shqipëri 2025 – 2030, i cili është në proces hartimi nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim, ku komponenti i ndërhyrjeve parandaluese primare dhe sekondare tek të rinjtë do të zërrë një vend të veçantë.

një numër të konsiderueshëm aktiviteteve sistematike mbi sjelljet e shëndetshme, përfshi sëmundjet seksualisht të trasmetueshme me fokus grupe të të rinjve nga kategoritë vulnerabël. Shumë prej këtyre aktiviteteve janë realizuar në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve të shërbimit shëndetësor në shkolla të projektit “Shkollat për Shëndetin”. Në rang kombëtar rezultojnë se janë rreth 295 shkolla 9-vjeçare të përfshira në këtë iniciativë me prespektivën për tu shtrirë më tej në qarqet e tjera të vendit me fokus promocionin e shëndetit dhe mirëqenien e nxënësve të shkollave, familjeve të tyre dhe komunitetit shëndetësor mbi “Stilet e shëndetshme të jetesës në Shqipëri”. Njëkohësisht në kuadër të Programit për edukimin shëndetësor, me fokus “Edukimi seksual si aftësi për jetën në një mjedis të sigurt shkollor”, program i ndërmarrë nga ASCAP në bashkëpunim me MA dhe UNFPA, në zbatim dhe të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjimore 2021-2030, janë realizuar veprimtari mbi parandalimin e dhunës seksuale dhe ndihmesën për ndërhyrjen në kohë, duke krijuar një mjedis të sigurt shkollor³⁰.

Është përditësuar manuali i përdorimit dhe trajnimit të personelit që ofron shërbimin e vaksinimit, mbledhjen dhe hedhjen e të dhënave në sistemin e informacionit shëndetësor të vaksinimit, si dhe për periudhën Janar 2023 - Dhjetor 2024 janë trajnuar rreth 1,086 personel mjekësor mjek/infermier të qendrave shëndetësore dhe stafe të NJVKSH-ve të përfshirë në hedhjen e të dhënave në SIV (Sistemi Informativ i Vaksinimit). Nga programi mbarëkombëtar i imunizimit përfitojnë të gjithë fëmijët. Gjatë '23-'24 ky program ka zbatuar gjërësisht edhe vaksinimin e vajzave 13 vjeç e lartë, me vaksinën më të re të skemës,

HPV-në³¹.

MSHMS ka planifikuar që në bashkëpunim me Projektin Solidar të hartojë dokumenta dhe plane operacionale ndaj emergjencave shëndetësore civile, ku në fokus do të jenë fëmijët dhe adoleshentët.

Integrimi i stafeve psiko-sociale në ofrimin e kujdesit shëndetësor parësor dhe spitalor, ka patur një fokus të vecantë gjatë periudhës 2 vjeçare, '23-'24, duke rezultuar në rritjen e numrit të profesionistëve përkatësisht: në 103 Qendrat Socio-Shëndetësore pjesë të Kujdesit Shëndetësor Parësor ofrojnë shërbim 88 psikologë/punonjës social, ndërsa në Shërbimin Spitalor rezultojnë se numri i këtij personelit është në rritje duke shkuar në 21, në 16 spitale rajonale dhe bashkiake të vendit.

Nga ana e MSHMS dhe ISHP në vitin 2023 u krye një analizë e zgjeruar e hartëzimit të shërbimeve për shëndetin mendor të rinjve dhe adoleshentëve. Është përgatitur raporti përkatës për këtë dhe janë përfshirë gjetjet në “Planin e ri kombëtar të shëndetit mendor” të miratuar në vitin 2024. ISHP ka përgatitur materiale informative dhe organizuar trajnime për 60 profesionistët shëndetësorë (mjeke) dhe stafin pedagogjik të shkollave³² pjesë e të cilave kanë qenë temat e lidhura me shëndetin mendor të të rinjve. Pjesë e temave të trajtuara kanë qënë edhe sfidat e shëndetit mendor në rast emergjencash, mbështetur në “Udhëzuesi për ofruesit jo-profesionistë dhe kujdestarët mbi strategjitë për promovimin dhe mbrojtjen e shëndetit mendor dhe reduktimin e vetëdëmtimit dhe rreziqeve të tjera”³³, i cili u përkthye dhe përshtat gjatë vitit 2024.

30. Disa nga produktet e kesaj iniciative jane: Hartimi i programit të trajnimit “Edukimi shëndetësor me fokus edukimin seksual si aftësi për jetën në një mjedis të sigurt shkollor”, 2022-2026; Hartimi i moduleve të trajnimit “Edukimi shëndetësor me fokus edukimin seksual si aftësi për jetën në një mjedis të sigurt shkollor”, 2022-2026; Ndërgjegjësimi dhe përgatitja e kapaciteteve kombëtare dhe lokale për zbatimin në shkollë të paketës trajnuese “Abuzimi seksual”, 2022-2026; Përgatitja e materialeve ndërgjegjësuere me fokus abuzimin seksual si edhe për qasjen on-line; Identifikimi i shkollave që do të shërbejnë si qendra koordinuese për vazhdimësinë e programit “Edukimi seksual si aftësi për jetën” në një mjedis të sigurt shkollor dhe krijimi i këtyre qendrave koordinuese.

31. Virusit papilloma humane (HPV)

32. Aktivitetet e aftësimit për adresimin e problemeve të shëndetit mendor për personelin mesimor është zhvilluar nga stafi psikosocial i shkollave

33. Bazuar në manualin e OBSH-së dhe UNICEF-it Shqipëri, “Helping adolescents thrive toolkit” (“Të ndihmojnë adoleshentët të ecin përpara”) si dhe Udhëzuesi për mësuesit “Teacher’s Guide and Comic Book” (“Udhëzues për mësuesin dhe libër vizatimor”) pjesë e paketës “Helping adolescents thrive toolkit”, të OBSH-së dhe UNICEF-it SHqipëri.

Aksesi në informacion dhe shërbime të shëndetit mendor, vecanërisht të fëmijëve dhe adoleshenteve, ka patur një rritje gjatë 2024-ës. Me stafet psikosociale të shkollave, ato të qendrave socio-shëndetsore dhe të QKSHM-ve është prezantuar burimi shkencor i Alenances Evropiane Kunder Depresionit/EAAD, si "IFight4Wellbeing" i cili ofron informacion të besueshëm për çështjet e lidhura me depresionin, si dhe prezantimi i instrumentit "Ifightdepression" i cili është një mjet online që mund të përdoret për një vlerësimi paraprak, orientim dhe mbështetje në shërbimin online, kryesisht në formatin e vetëdihmës.

Me mbështetjen e HAP³⁴, MSHMS ka hartuar një udhëzues për menaxhimin e çrregullimeve mendore dhe janë trajnuar mbi 600 trajnerë për zbatimin e tij. Gjithashtu, janë përditësuar protokollat për fëmijët 0-6 vjeç për të përfshirë identifikimin e hershëm të autizmit, prapambetjes mendore dhe ADHD-së, si dhe janë organizuar trajnime të shumta për personelin shëndetësor dhe psikosocial në mbarë vendin. Paralelisht, është nisur puna për një program kombëtar për parandalimin e vetëvrasjeve, i cili do të zgjasë deri në vitin 2030. Në bashkëpunim me UNICEF janë përshtatur udhëzues ndërkombëtarë për mësues dhe kujdestarë. Sic është përmendur, studimi HBSC 2022 ka shërbyer si bazë për vlerësimin e gjendjes mendore të të rinjve dhe planifikimin e ndërhyrjeve të mëtejshme si dhe janë prezantuar e vënë në dispozicion mjetet e sipërpërmendura, për të rritur aksesin në informacion dhe shërbime.

Puna e bërë për ushqyerjen e shëndetshme të nxënësve të arsimit parauniversitar ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm për ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen aktive të brezit të ri mbi çështje që kanë të bëjnë me kujdesin dhe mbrojtjen e shëndetit të tyre. Këto tema janë të integruara në lëndë të ndryshme të programit mësimor, parauniversitar. Rregullorja e hartuar ka për qëllim garantimin e shëndetit të fëmijës përmes standardeve të ushqimit si dhe synon të rregullojë në mënyrë të unifikuar standardet e ofrimit të ushqimit në institucionet arsimore

parauniversitare, në të cilën përfshihet lista e ushqimeve të lejuara dhe ushqimeve të ndaluara. Gjatë vitit shkollor 2023-2024, në bashkëpunim me ASCAP, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe organizatat/shoqatat partnere janë realizuar një numër i konsiderueshëm aktiviteteve si psh: zbatimi i paketës kurrikulare "Për një ushqyerje të shëndetshme" për parandalimin e kequshqyerjes dhe edukimin për një ushqyerje të shëndetshme, për grupmoshat 5-16 vjeç; zhvillimi i pyetësorëve, temave ndërgjegjësuere, takimeve sensibilizuese, fokus-grupeve, këshillime individuale dhe në grup me nxënësit dhe mësuesit nga SHPS i shkollës për ushqyerjen e shëndetshme dhe ndalimin e përdorimit të pijeve energjike në mjediset e shkollës; shmangia ndaj ekspozimit të ushqimeve të pashëndetshme në mjediset e shkollës; zhvillimi në muajin tetor 2024 i "Panairit vjeshtor" me kontributin e nxënësve dhe të prindërve të tyre për të reklamuar produktet e vjeshtës, si ushqim i shëndetshëm; ka vijuar nisma "Toka në shkollë" ku janë krijuar miniparcelat pranë shkollës; zbatimi i projektit "Të ushqehemi shëndetshëm" dhe projektit "Shkolla dhe shëndeti" etj.

Programi Kombëtar për Kujdesin e Shikimit për Fëmijët në Shqipëri u miratua nga qeveria në vitin 2022. Ky është programi i parë i këtij lloji në vend, që synon të ofrojë kontrolle periodike të shikimit për të gjithë fëmijët nga lindja deri në moshën 14 vjeç. Ai përfshin depistime falas në shkolla dhe qendra shëndetësore, me qëllim identifikimin dhe trajtimin e hershëm të problemeve të shikimit tek fëmijët. Deri në shkurt 2025, numri i fëmijëve që kanë përfutur nga Programi Kombëtar i shikimit është 265,584.

34. Projekti "Shëndet për të Gjithë" (HAP) është një nismë e financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim



TABELA 38. STATUSI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETEVE (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Nr. i masave	Nr. i aktiviteteve gjithsej	Nr. i aktiviteteve të raportuara	Përqindja e aktiviteteve të raportuara
1	20	19	95%



TABELA 39. STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Statusi	Numri i statusit të aktiviteteve	Përqindja e statusit të aktiviteteve
Plotësisht i realizuar	16	84%
Pjesërisht i realizuar	3	16%
I porealizuar	0	0%






TABELA 37. SHPENZIMET SIPAS STATUSIT TË REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR, VLERË DHE PËRQINDJE)

Statusi	Nr. i aktiviteteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti shtetit	Partnerë
Plotësisht i realizuar	16	185,832,771	84.00%	185,832,771	100.00%	61.50%	38.50%
Pjesërisht i realizuar	3	35,396,718	16.00%	35,396,718	100.00%	61.50%	38.50%
I përealizuar							

SHPENZIMET FINANCIARE

Objektivi specifik III.3 përbëhet nga një masë me gjithsej 20 aktivitete, prej të cilave vetëm 1 aktivitet është buxhetuar në një plan tjetër. Për periudhën 2021–2026, sipas planit të veprimit, shpenzimet e planifikuara synonin të mbulonin 82.2% të kostove treguese. Nga të dhënat e raportuara rezulton se:

16 aktivitete janë realizuar plotësisht, me një buxhet të planifikuar prej 185,832,771 lekë (84% e totalit). Shpenzimet faktike janë realizuar plotësisht (100%), ku 61.5% e fondeve kanë ardhur nga buxheti i shtetit dhe 38.5% nga partnerët. 3 aktivitete janë realizuar pjesërisht, me një buxhet të planifikuar prej 35,396,718 lekë (16% e totalit). Edhe këto aktivitete kanë pasur realizim financiar të plotë (100%), me të njëjtën ndarje të burimeve (61.5% buxheti i shtetit, 38.5% partnerë).

Nuk ka aktivitete të përealizuara apo me mungesë informacioni. Në total, për periudhën 2021–2025 janë shpenzuar 100% e fondeve të planifikuara për aktivitetet e realizuara (plotësisht dhe pjesërisht). Pjesa më e madhe e financimit është mbuluar nga buxheti i shtetit (61.5%), ndërsa partnerët kanë kontribuar me 38.5% të shpenzimeve.

Objektivi specifik III.4.

Drejtësi miqësore për fëmijët.

Treguesit kryesorë në nivel objektivash të veçanta nën këtë qëllim strategjik, janë:

- ➔ numri i fëmijëve që përfitojnë ndihmë ligjore falas - [*i realizuar*]
- ➔ numri i rasteve të trajtuara nga shërbimi i provës - [*pjesërisht i realizuar*]
- ➔ numri i fëmijëve (14–18 vjeç) të pandehur nën hetim të raportuar nga prokuroria - [*pjesërisht i realizuar*]
- ➔ numri i fëmijëve të trajtuar me urdhër mbrojtjeje në gjykatë si viktime të dhunës në familje - [*i realizuar*]

Negociatat e BE-së dhanë mundësinë për të përforcuar komplementaritetin midis *acquis* të BE-së dhe standardeve të OKB-së, veçanërisht për të drejtën e fëmijëve dhe aksesin në drejtësi. Në këtë kuadër, qeveria shqiptare, me mbështetjen e UNICEF-it, hartoi një strategji pesëvjeçare për Drejtësinë për Fëmijët dhe Planin e Veprimit 2022-2026. Objekti është më ambicioz se strategjia e mëparshme, duke shkuar përtej konceptit të drejtësisë penale për fëmijët drejt fushave të tjera të drejtësisë, si familja, civile dhe administrative. Fëmijët viktime të dhunës në sistemin e prokurorisë, asistohen nga koordinatori për subjektet me status të posaçëm. Ata intervistohen nga prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore, gjithmonë në praninë e koordinatorit, i cili ofron mbështetje psikologjike për viktimën dhe kryen një raport vlerësimi nevojash. Koordinatorët janë të trajnuar në çështjet e dhunës në familje, abuzimeve seksuale, çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore dhe të miturve në konflikt me ligjin.

Është hartuar një material informues për njohjen e të miturit me masën alternative të shmangies së parashikuar nga nenet 55 e vijues të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, miratuar me ligjin nr. 37/2017. Këto materiale dhe model-akte,

janë miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm dhe janë bërë pjesë e Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 8, datë 15.11.2021, “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshmitar”, që Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë.

Nuk është realizuar ende ngritja e një grupi pune për hartimin e kriterëve mbi trajnimin, liçencimin dhe kreditimin e profesionistëve në kuadër të zbatimit të kodit të drejtësisë penale për të mitur, megjithatë nën drejtimin e MD janë realizuar mjaft aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të tyre, gjatë viteve ‘23-’24.

Kështu, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve ka zhvilluar 3 trajnime të lidhura me këtë kod dhe informon se numri i specializuar i ndërmjetësve në këtë kuadër është 17. Nderkohë shkolla e magistraturës gjatë ‘23-’24 ka zhvilluar 11 trajnime në fushën e drejtësisë për të mitur me tema të ndryshme si psh mbi zbatimin e masave mjekësore dhe edukuese, mbi çështjet penale, civile, familjare dhe administrative ku fëmija merr pjesë ose vendimmarrja e tyre ndikon tek fëmija. Njëkohësisht, në bashkëpunim me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare, DHKN ka organizuar disa trajnime në kuadër të zbatimit të masave alternative të mundshme për shmangien nga ndjekja penale dhe referimi në programet e drejtësisë restauruese, në të cilën kanë marrë pjesë magjistratë në detyrë dhe profesorë.

Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me Terre des Hommes, kanë organizuar disa trajnime me qëllim fuqizimin e profesionistëve të ligjit në teknikat miqësore të intervistimit të të miturve, viktime të dhunës fizike dhe abuzimit seksual. Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin 62 prokurorë, oficerë dhe koordinorë nga të gjithë prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka marrë pjesë në trajnime të organizuara nga partnerë vendas dhe

ndërmkombëtare, si IPO, UNICEF, OSCE, CFD, etj., në kuadër të forcimit të kapaciteteve të punonjësve të Qendrës dhe në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, ka organizuar trajnime në bashkitë Dibër, Gjirokastrë dhe Malësi të Madhe, në bashkitë të cilat Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës kanë menaxhuar raste fëmijësh në konflikt me ligjin. Trajnimet janë zhvilluar me aktorët vendor të cilët janë pjesë e GTN.

Për vitin 2024, është realizuar një raund i suksesshëm i sesioneve informuese për parandalimin e krimeve tek të miturit dhe të rinjtë, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe Qendrën e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve. Aktivitetet janë zhvilluar në bashkitë Koplik, Dibër, Berat, Kuçovë, Dimal, Gjirokastrë, Përmet, Këlcyrë, Tepelenë, Memaliaj dhe Kamëz. Për këtë aktivitet, janë angazhuar 129 punonjës të vijës së parë, përfshirë përfaqësues nga drejtoritë vendore të policisë, shërbimet sociale, njësitë e mbrojtjes së fëmijëve, shërbimi i provës, prokuroria, autoritetet rajonale arsimore dhe shëndetësore, si dhe shkollat. Qëllimi ka qenë ngritja e kapaciteteve për identifikimin e hershëm të rasteve dhe forcimin e mekanizmave të referimit për një bashkëpunim ndër-institucional më efikas në parandalimin e krimeve tek të rinjtë.

Gjatë viti 2025, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka organizuar sesione informuese/ workshop ne bashkite Tiranë, Fier, Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër, Cërrik dhe Elbasan me profesionstet e vijes së parë NJMF, staf i shërbimit psiko-social në shkolla, mësues, oficerë policie, dhe përfaqësues të organizatave lokale. Me pjesëmarrjen e 64 përfaqësuesve të institucioneve.

Qëllimi i sesioneve informues/ workshop është“ Për identifikimin e hershëm dhe rritjen e bashkëpunimit ndër-institucional për të parandaluar dhunën dhe kriminalitetin tek të rinjtë. Mekanizimi i referimit dhe menaxhimi i rasteve të fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin. Sesionet informuese/ workshopet jane zhvilluar me NJMF dhe aktoret vendor te cilat jane pjese e GTN. NJMF dhe punonjësit e vijës së parë, te

cilat janë informuar ne lidhje me procedurat per menaxhimin e rasteve te femijeve nen moshen e pergjegjesis penale te cilet jane ne konflikt/kontakt me ligjin. Rëndësinë e bashkëpunimit ndër-institucional për parandalimin e dhunës dhe kimit midis fëmijëve dhe të rinjve.

15 drejtori vendore të policisë, kanë krijuar njësi miqësore të intervistimit për fëmijët³⁵, në drejtoritë vendore dhe komisaritet e policisë në zbatim të detyrimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, me qëllim që intervistimi i të miturve, pavarësisht nëse janë të dyshuar, viktimë apo dëshmitarë, të zhvillohet në një mjedis që siguron mbrojtjen e të miturve dhe cilësinë e informacionit të dhënë nga fëmijët. Këto njësi intervistimi, janë ngritur bazuar në Procedurat Standarde për “Njësinë e Intervistimit të të Miturve, standardet teknike dhe procedurat e përdorimit të këtyre mjediseve,” t cilat janë miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 715, datë 5.6.2019. Njësitë janë pajisur me mjete të regjistrimit audio dhe video të intervistës, si dhe sigurojnë kushte miqësore për të miturit në kontakt me policinë. Rregullat për pyetjen e të miturit viktimë ose dëshmitar, janë të përcaktuara në nenin 39 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, “Rregulla të veçanta të pyetjes së të miturit viktimë ose dëshmitar.” Janë organizuar trajnime speciale për policët që punojnë në këto njësi, me fokus në teknikat e hetimit të krimeve me të mitur dhe qasjen gjinore. Ministria e Drejtësisë ka nënshkruar marrëveshje me bashkitë për të krijuar qendra multidisiplinare, ku grupe teknike (psikologë, punonjës socialë, mjekë) ndihmojnë në trajtimin e rasteve.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në bashkëpunim me UNICEF, ka përgatitur Manualin për “Teknikat Shkencore të Intervistimit me të mitur” dhe i ka shpërndarë në rrugë elektronike tek punonjësit e Policisë së Shtetit që ishin pjesë e trajnimeve të kryera, nga të gjitha drejtoritë vendore të policisë në vend. DPPSH në bashkëpunim me Dhomen Kombëtare të Ndërmjetësve ka organizuar 2 trajnime që lidhen me drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin, në të cilat janë trajnuar punonjës policie nga gjithë struktura vendore të policisë. Gjithashtu, Drejtoria

35. 12 Njësi Miqësore të Intervistimit të të Fëmijëve janë realizuar nga UNICEF, në kuadër të zbatimit të programit Suedez dhe 3 njësi miqësore të intervistimit të fëmijëve ngritur nga World Vision në partneritet me Nisma ARSIS

ka hartuar dhe miratuar "Protokollin e Mekanizmit për Referim për Riintegrim në Shoqëri të të Miturve dhe të Rinjve në Konflikt me Ligjin," ku përshkruhen detyrimet dhe përgjegjësitë e institucioneve të përfshira në këtë proces.

Është përmirësuar përdorimi i Sistemit të Integruar të të Dhënave për Drejtësinë për Fëmijët. Rastet e 1898 fëmijëve në proceset e drejtësisë penale janë regjistruar brenda gjashtë muajve të parë të vitit 2022 dhe numri i përdoruesve të rregullt, është rritur me 76%. Këshilli i Lartë Gjyqësor, urdhëroi që të gjitha gjykatat të fusin të dhëna në sistem.

Janë zhvilluar aktivitete edukative për 145 nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, me qëllim fuqizimin e njohurive të tyre juridike dhe rritjen e ndërgjegjësimit për mbajtjen larg të aktiviteteve kriminale. Nderkohe numri i rasteve të trajtuara nga shërbimi i provës është rritur me të paktën 20 raste në vit ku vetëm për vitin 2024 janë trajtuar 121 të mitur që kanë përfituar nga drejtësia alternative. Të miturit që kanë përfituar nga drejtësia alternative sipas Degëve Territoriale për vitin 2024 që janë të renditur në tabelën 41.

Për periudhën janar '23-dhjetor '24, janë trajtuar 268 punonjës të zyrave të gjendjes civile në bashki / njësi administrative mbi indendifikimin, rregjistrimin dhe dhënien e statusit të pashtetësisë për fëmijët.

Në vitin 2024 është realizuar hartimi dhe miratimi i një marrëveshjeje të përbashkët midis Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR) për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin. Kjo marrëveshje synon forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve në konflikt me ligjin, në përputhje me kuadrin ligjor për mbrojtjen e fëmijës, Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 dhe Strategjinë e Drejtësisë për të Miturit 2022–2026.

Nuk ka patur raportim mbi ngritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve procedural për menaxhimin e fëmijëve në konflikt me Ligjin". Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale në Bashkinë e Tiranës përmend se ka caktuar 6 Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijëve të cilët mbështesin rastet e fëmijëve në konflikt me ligjin si përfaqësues procedural.

Gjatë periudhës 2021 – 2025 është ofruar shërbimi psiko-social i Nisma ARSIS përgjatë procesit të intervistimit në komisariatet e policisë Tiranë, Kamëz, Vorë etj. për 2748 fëmijë, ndër të cilët, nga të cilët më tepër se 40% e tyre kanë qenë raste të fëmijëve në nevojë për mbrojtje apo në rrezik dhe janë raportuar pranë njësive të mbrojtjes së fëmijëve. Përdorimi i njësive miqësore për intervistimin e fëmijëve viktime, autorë dhe dëshmitarë të veprave penale nga policia, prokuroria dhe gjykatat sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, mbetet ende një sfidë. Në shumë raste, përdorimi i njësive miqësore të intervistimit, vjen si kërkesë e prokurorisë për rastet e fëmijëve në rrezik të lartë, si për shembull, rastet e fëmijëve viktime të abuzimit seksual. Bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të sistemit të drejtësisë me sistemet e tjera të kujdesit, mbetet një problem. Vetëm një numër i vogël i bashkive kanë zbatuar menaxhimin e rasteve ndërdisiplinore për fëmijët në kontakt me ligjin.

Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut (ELP) 2019-2023, e miratuar me vendimin nr.47/2019 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë tashmë ka rënë nga fuqia. Masat dhe aktivitetet e lidhura me ELP janë adresuar në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, të planit të saj të veprimit dhe pasaportës së treguesve, e miratuar me vendimin nr. 787, datë 18.12.2024, të Këshillit të Ministrave, ku parashikohet kryerja e një vlerësimi të nevojave për trajnim të punonjësve të administratës publike për edukimin ligjor, hartimi dhe rishikimi i moduleve të trajnimit si dhe zhvillimi i trajnimeve të përvitshme për përditësimin e njohurive, të gjitha të nën përgjegjësinë e ASPA, me kontribut të MD. Shpërndarja e materialeve EL për grupet e popullatës në nevojë, me gjuhë të kuptueshme për fëmijët dhe PAK, gjithashtu është shtyrë si nismë, për t'u përshtatur në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, e cila parashikon për vitet në vazhdim informim dhe ndihmë juridike të garantuar nga shteti, shpërndarje e materialeve informative, realizimin e sesioneve informuese në të gjitha bashkitë përfshirë ato për grupet vulnerabël. etj. Dhe së fundmi, nëpërmjet Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022-2026, është garantuar e drejta për pjesëmarrje dhe e drejta për t'u dëgjuar në proces, e drejta për ndihmë ligjore dhe psikologjike për fëmijët me prindër të burgosur.



TABELA 41. TË MITURIT QË KANË PËRFITUAR NGA DREJTËSIA ALTERNATIVE SIPAS DEGËVE TERRITORIALE PËR VITIN 2024

DEGËT TERRITORIALE		LLOJET E DËNIMEVE ALTERNATIVE					GJITHSEJ
		Neni 59 i KP, Pezullimi	Neni 59/a i KP, Qëndrimi në shtëpi	Neni 64 i KP, Lirimi me kusht	Neni 63 i KP, Punë në interes publik	Neni 58 i KP, Gjysmëliria	
1	Dega territoriale e Shërbimit të Provës Tiranë	34	0	0	4	0	38
2	Dega territoriale e Shërbimit të Provës Durrës	8	0	0	0	0	8
3	Dega territoriale e Shërbimit të Provës Fier	8	0	0	0	0	8
4	Dega territoriale e Shërbimit të Provës Shkodër	12	3	0	2	0	17
5	Dega territoriale e Shërbimit të Provës Lezhë	1	0	0	0	0	1
6	Dega territoriale e Shërbimit të Provës Elbasan	3	0	0	4	0	7
7	Dega territoriale e Shërbimit të Provës Korçë	6	0	0	1	0	7
8	Dega territoriale e Shërbimit të Provës Gjirokastrë	0	0	0	0	0	0
9	Dega territoriale e Shërbimit të Provës Mat	1	0	0	4	0	5
10	Dega territoriale e Shërbimit të Provës Vlorë	4	0	0	1	0	5
11	Dega territoriale e Shërbimit të Provës Berat	0	0	0	4	0	4
12	Dega territoriale e Shërbimit të Provës Kukës	2	0	0	3	0	5
13	Dega territoriale e Shërbimit të Provës Pogradec	1	0	0	1	0	2
14	Dega territoriale e Shërbimit të Provës Lushnjë	2	0	0	2	0	4
15	Dega territoriale e Shërbimit të Provës Kurbin	3	0	0	1	0	4
16	Dega territoriale e Shërbimit të Provës Krujë	4	0	0	0	0	4
17	Dega territoriale e Shërbimit të Provës Pukë	0	0	0	0	0	0
18	Dega territoriale e Shërbimit të Provës Sarandë	1	0	0	0	0	1
19	Dega territoriale e Shërbimit të Provës Kavajë	0	0	0	0	0	0
20	Dega territoriale e Shërbimit të Provës Dibër	0	0	0	1	0	1
21	Dega territoriale e Shërbimit të Provës Tropojë	0	0	0	0	0	0
22	Dega territoriale e Shërbimit të Provës Përmet	0	0	0	0	0	0
		90	3	0	20	0	121



TABELA 42. STATUSI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETEVE (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Nr. i masave	Nr. i aktiviteteve gjithsej	Nr. i aktiviteteve të raportuara	Përqindja e aktiviteteve të raportuara
1	14	10	71%



TABELA 43. STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Statusi	Numri i statusit të aktiviteteve	Përqindja e statusit të aktiviteteve
Plotësisht i realizuar	4	40%
Pjesërisht i realizuar	6	60%
I porealizuar	0	0%






TABELA 44. SHPENZIMET SIPAS STATUSIT TË REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR, VLERË DHE PËRQINDJE)

Statusi	Nr. i aktiviteteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti shtetit	Partnerë
Plotësisht i realizuar	4	15,687,487	40.00%	15,687,487	100.00%	71.58%	28.42%
Pjesërisht i realizuar	6	23,531,231	60.00%	23,531,231	100.00%	71.58%	28.42%
I përealizuar							

SHPENZIMET FINANCIARE

Objekti i specifik III.4 përbëhet nga një masë me gjithsej 14 aktivitete, prej të cilave 2 aktivitete janë buxhetuar në një plan tjetër. Sipas planit të veprimit, për periudhën 2021–2026 shpenzimet e planifikuara synonin të mbulonin 83.7% të kostove treguese. Nga të dhënat e raportuara: 4 aktivitete janë realizuar plotësisht, me një buxhet të planifikuar prej 15,687,487 lekë (40% e totalit). Shpenzimet faktike janë realizuar në masën 100%, ku 71.58% e fondeve kanë ardhur nga buxheti i shtetit, ndërsa 28.42% nga partnerët. 6 aktivitete janë realizuar pjesërisht, me një buxhet të planifikuar prej 23,531,231 lekë (60% e totalit).

Edhe këto aktivitete kanë pasur realizim të plotë financiar (100%), me të njëjtën ndarje të burimeve (71.58% buxhet, 28.42% partnerë). Nuk ka aktivitete të përealizuara ose me mungesë informacioni. Në total, për periudhën 2021–2025 janë realizuar 100% e shpenzimeve të planifikuara për aktivitetet e zbatuara (plotësisht dhe pjesërisht). Financimi është mbështetur kryesisht nga buxheti i shtetit (71.58%), ndërsa partnerët kanë kontribuar me rreth 28.42%.

Qëllimi IV.

Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale.

Qëllimi IV fokusohet në promovimin e të drejtave të fëmijëve në botën digjitale, duke përfshirë sigurimin e aksesit dhe angazhimin e fëmijëve në mjedisin digjital, në përputhje të plotë me objektivin 5 të Strategjisë së Këshillit Evropian për të Drejtat e Fëmijëve. Nxënia dhe kreativiteti në mjedisin digjital nëpërmjet zhvillimit të kompetencave digjitale përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), është parë si një qëllim prioritar dhe i rëndësishëm për fëmijët, duke vlerësuar si të rëndësishëm në këtë proces, interesin më të lartë të fëmijës nga të gjitha institucionet që kontribuojnë në

mjedisin digjital.

Institucionet kanë raportuar të gjithë treguesit që lidhen me objektivat specifike, të këtij qëllimi strategjik, dhe realizimi i plotë i tyre, është në shkallën 100%.

Informacion është raportuar për 12 nga 12 aktivitetet që janë pjesë e qëllimit strategjik, prej të cilave 100% janë realizuar plotësisht.



TABELA 45. NIVELI I RAPORTIMIT TË TREGUESVE TË REZULTATIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Numri i treguesve	Të paraportuara	Të raportuara
4	0	4
100%	0%	100%



TABELA 46. STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE TË REZULTATIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Total tregues (Nr. & %)	Plotësisht i realizuar	Pjesërisht i realizuar	I parealizuar
4	4	0	0
100%	100%	0%	0%



TABELA 47. STATUSI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETEVE (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Nr. i masave	Nr. i aktiviteteve gjithsej	Nr. i aktiviteteve të raportuara	Përqindja e aktiviteteve të raportuara
3	12	12	100%



TABELA 48. STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Statusi	Numri i statusit të aktiviteve	Përqindja e statusit të aktiviteve
Plotësisht i realizuar	9	75%
Pjesërisht i realizuar	2	17%
I porealizuar	1	8%




TABELA 49. SHPENZIMET SIPAS STATUSIT TË REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR, VLERË DHE PËRQINDJE)

Statusi	Nr. i aktiviteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti shtetit	Partnerë
Plotësisht i realizuar	9	18,491,192	75.00%	18,491,192	100.00%	35.85%	64.15%
Pjesërisht i realizuar	2	4,191,337	17%	4,191,337	100.00%	35.85%	64.15%
I porealizuar	1	1,972,394	8%	1,972,394	100.00%	35.85%	64.15%

Qëllimi IV.1

Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale.

Treguesit në nivel masash:

→ përqindja e shkollave me infrastrukturën e përshtatshme TIK, përfshirë internetin: [i realizuar]

→ numri i bashkive (2 bashki të reja në vit) që ofrojnë shërbimin e internetit të sigurt për fëmijët dhe familjet në mjedise apo institucione publike: [i realizuar]

→ numri i bizneseve (2 biznese të reja në vit) të angazhuar në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në botën digjitale: [i përcaktuar];

→ numri i ankesave të shqyrtuara nga AMA mbi shkeljen e të drejtave të fëmijëve: [i realizuar]

Në funksion të krijimit dhe përmirësimit të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në institucionet arsimore parauniversitare, është siguruar mbulimi me shërbim interneti për të gjitha shkollat publike, në bazë të kontratës nr. 4881, datë 14.09.2023, të lidhur nga AKSHI. Në 200 shkolla është vendosur gjithashtu shërbimi ëireless, duke lehtësuar aksesin në mësimdhënie dhe mësimnxënie digjitale. Ministria e Arsimit dhe Sportit ka vijuar gjithashtu me pajisjen graduale të shkollave me kabinete informatike, si dhe me përmirësimin e platformave të informimit, përfshirë njoftimin në kohë reale të prindërve mbi rezultatet e nxënësve dhe njohjen e vlerësimeve të arritura jashtë vendit. Këto ndërhyrje synojnë të krijojnë një mjedis arsimor modern dhe gjithëpërfshirës, të përgatitur për sfidat e arsimit digjital.

Deri më tani, janë instaluar 100 SMARTLab-e

në 100 shkolla të arsimit bazë. Janë trajnuar deri tani 110 drejtues rrjetesh profesionale lidhur me planin e rrjetit, aktivitetet që do të kryejnë gjatë këtij viti shkollor, si dhe në përdorimin e platformave *on-line*.

Kompetenca digjitale është integruar si pjesë e standardeve profesionale të mësuesit në arsimin parauniversitar dhe në kornizën e re kurrikulare, në zbatim të urdhrit nr. 610, datë 20.12.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit. Kjo kornizë përcakton integrimin e teknologjisë si parim të përgjithshëm dhe mbështet zhvillimin e kompetencave kyçe në fushën e STEM-it dhe metodologjinë e të nxënësve sipas qasjes STEM. Aktualisht, kurrikula e re e TIK-ut³⁶ për klasat I–III po pilotohet në 352 shkolla, me përfitues rreth 39.925 nxënës, falë mbështetjes nga projekte të ndryshme si ElementIT, Banka Botërore, OSFA dhe partnerë të tjerë. Gjithashtu, programi kombëtar i kodimit Codemonkey është zbatuar gjatë vitit shkollor 2024–2025 në 342 shkolla, në 1.703 klasa të arsimit bazë, si një mjet konkret për zhvillimin e kompetencave digjitale që në moshë të hershme. Projekti ofron një platformë *on-line* (*codemonkey*) për të mbështetur mësimdhënien dhe mësimin e kodimit dhe mendimit kritik dhe logjik për nxënësit e klasave të para në 100 shkolla për vitin shkollor 2022–2023, si dhe trajnimin e mësuesve për kurrikulën e re të TIK-ut. Synimi afatgjatë i këtij projekti, është riformatimi i të gjithë kurrikulës së lëndës së Teknologjisë së Informacionit, duke përfshirë këtu dhe kurrikulën aktuale që ndiqet nga klasa e katërt deri në të nëntën, por edhe në shkollë të mesme.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka udhëhequr një sërë iniciativash për rritjen e kompetencës digjitale tek të rinjtë dhe nxënësit, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Kompetenca digjitale është përfshirë

36. 100 shkolla të financuara nga projekt ElementIT – 20.231 nxënës përfitues (Klasa I, II, III) - 200 shkolla të financuara nga projekti i BB – 15.907 nxënës përfitues (Klasa I, II) - 5 shkolla të zëvendësuara me smart lab – 339 nxënës (Klasa I) - 6 shkolla të financuara nga OSFA – 255 nxënës (Klasa I, II) - 41 shkolla private – 3.193 nxënës (Klasa I, II)

si pjesë e standardeve të mësuesit dhe është promovuar që në klasën e parë përmes lëndës së TIK-ut dhe programeve ndërdisiplinare në të gjitha lëndët. Përmes Programit Kombëtar të Kodimit për të Rinjtë, i lançuar në janar 2023 dhe zbatuar në bashkëpunim me MEKI dhe AKPA, janë diplomuar 1,285 të rinj dhe 636 janë aktualisht në formim në 6 akademi dhe 35 lloje kursesh. Programi ofrohet me mbështetje deri në 100% nga buxheti i shtetit, me synim rritjen e punësueshmërisë dhe aftësive digjitale të të rinjve në mbarë vendin, përfshirë qytete si Korçë, Shkodër dhe Dibër. Në kuadër të projektit “Kodimi në Shkollë”, janë ndërtuar 316 laboratorë Smart në shkolla publike të arsimit parauniversitar, duke përfshirë 66,368 nxënës përfitues në të gjitha klasat. Projekti është shtrirë në nivel kombëtar dhe synon përdorimin e TIK-ut si mjet ndërdisiplinor për zhvillimin e kompetencave të shekullit XXI.

Ministria e Arsimit ka vijuar zbatimin e masave konkrete për ndërgjegjësimin e nxënësve në lidhje me sigurinë në internet dhe përdorimin e përgjegjshëm të teknologjisë. Një ndër prioritetet kryesore ka qenë informimi i fëmijëve për rreziqet e dhunës kibernetike, përfshirë bullizmin online, shantazhin, shpërndarjen e të dhënave personale dhe abuzimin seksual në internet. Në këtë kuadër janë organizuar veprimtari të vazhdueshme me nxënësit e arsimit bazë, përmes takimeve informuese, aktiviteteve krijuese dhe përfshirjes aktive të nxënësve në diskutime mbi mbrojtjen e të drejtave të tyre në mjedisin digjital. Deri tani, rreth 150,000 nxënës janë ndërgjegjësuar përmes këtyre iniciativave. Aktivitetet janë realizuar në forma të ndryshme si ese, vizatime, shfaqje artistike dhe punime krijuese, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe zhvillimin e qëndrimeve të shëndetshme dhe të sigurta në përdorimin e rrjeteve sociale. Paralelisht, është krijuar dhe mbështetur një rrjet profesional prej 1,200 mësuesish të TIK-ut, të cilët trajnohen rregullisht nga ASCAP për përdorimin e platformave online në mënyrë të sigurt dhe të efektshme, si dhe për trajtimin e temave me ndjeshmëri të lartë, si ekstremizmi i dhunshëm apo përmbajtjet e paligjshme në internet. MA ka ndërmarrë edhe masa teknike si aplikimi i filtrave në rrjetet e shkollave publike dhe private, për të parandaluar aksesin në faqe

të papërshtatshme. Mësuesit janë të informuar dhe të angazhuar për raportimin e çdo incidenti të dyshuar në ambientin virtual.

Gjithashtu, funksionon rubrika “Raporto përmbajtje të paligjshme” në faqet zyrtare të MA dhe institucioneve arsimore, e cila është ndërlidhur me portalin kombëtar të sigurisë kibernetike www.cesk.gov.al, duke ofruar një mekanizëm të drejtpërdrejtë për raportimin dhe bllokimin e përmbajtjeve të rrezikshme në internet. Kjo rubrikë është në ndihmë të fëmijëve, prindërve dhe edukatorëve, duke promovuar një kulturë të sigurisë digjitale në shkollë dhe jashtë saj.

Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë (STEM) është një kurrikulë që synon edukimin ndërdisiplinor të nxënësve përmes një qasjeje të zbatuar dhe praktike në këto katër fusha. Në kuadër të kësaj qasjeje, gjatë vitit shkollor 2021–2022, Ministria e Arsimit dhe Sportit, në bashkëpunim me UNICEF dhe Fondacionin “Vodafone Albania”, realizoi trajnimin e mësuesve dhe pajisjen e 24 shkollave 9-vjeçare me 840 tabletë, 48 smart board dhe internet të shpejtë. U krijuan 20 laboratorë STEM, të pajisur me mjete elektronike dhe kite robotike, ku morën pjesë 258 nxënës, përfshirë edhe trajnimin e të paktën 100 vajzave.

Në vazhdim të këtij bashkëpunimi, gjatë periudhës 2021–2024, projekti STEM u zgjerua në 120 shkolla publike në të gjithë vendin, duke përfshirë 1,200 mësues dhe nxënës në trajnime me metodologjinë STEM. Shkollat janë pajisur me pajisje praktike si Arduino dhe kite robotike, duke nxitur të nxënësit aktiv dhe zhvillimin e zgjidhjeve krijuese nga nxënësit. Në ZVAP Elbasan, janë përfshirë 5 shkolla (“Jeronim De Rada”, “Bardhyl Popa”, “Fadil Gurmani”, “Shushicë”, “Sulë Harri”), ku mbi 100 vajza dhe 30 djem të klasave VI–VIII kanë marrë pjesë në trajnim. Shkolla “Fadil Gurmani” u vlerësua me çmimin e parë në STEM për projektin “Kubi ëndërrues dhe ndriçimi i dritave natën”, ndërsa “Sulë Harri” u vlerësua me çmimin e tretë në Ditën Botërore të Shkencës nga Qendra Edu Act Albania. Në nivel kombëtar, janë trajnuar gjithashtu 450 drejtues rrjetesh profesionale, shumica gra, për temat e PISA dhe STEM, duke kontribuar në përhapjen dhe institucionalizimin

e arsimit STEM në shkolla dhe në fuqizimin e vajzave në fushat teknike dhe shkencore.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka realizuar një sërë veprimtarish të vazhdueshme në nivel kombëtar për të rritur ndërgjegjësimin e nxënësve, mësuesve dhe prindërve mbi rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale në mjedisin digjital. Gjatë periudhës 2021–2022, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, është zbatuar fushata “Edukimi digjital, luaj dhe mëso – Happy On-life”, e cila synon të nxisë të menduarit kritik dhe përdorimin e sigurt të internetit. Janë organizuar 55 takime në shkolla 9-vjeçare në qytete të ndryshme të Shqipërisë me pjesëmarrjen e mbi 1,000 nxënësve të klasave 6–8 dhe mësues të lëndëve të informatikës, gjuhës angleze dhe qytetarisë. Në dhjetor 2022, Komisioneri nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë dhe Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë, për të garantuar aksesin në informacion publik dhe mbrojtjen e të dhënave për këtë kategori. U parashikuan fonde specifike për zbatimin e objektivave të kësaj marrëveshjeje.

Gjatë vitit 2023, në kuadër të 28 Janarit, Ditës së Mbrojtjes së të Dhënave Personale, u publikua një poster ndërgjegjësuës për të rinjtë, ndërsa në bashkëpunim me ASDO dhe Ambasadën Zvicerane u zhvilluan aktivitete në shkolla si “1 Maji”, “Ali Demi” dhe “Elina”, ku nxënësit dhe mësuesit u njohën me parimet e mbrojtjes së të dhënave, rreziqet në rrjetet sociale dhe u prezantua loja edukative “Happy Onlife”.

Në vitin 2024, në partneritet me OSBE-në, janë organizuar 3 takime ndërgjegjësuëse në Tiranë, Shkodër dhe Korçë, për prezantimin e Rekomandimit Unifikues mbi detyrimet ligjore në mbrojtjen e të dhënave personale në arsimin e mesëm të lartë. Përfaqësues të bashkive, ZVA-ve, mësues, psikologë, prindër dhe nxënës u

angazhuan në diskutime mbi konfidencialitetin, privatësinë dhe shmangien e ekspozimit të të miturve në platforma online. Gjithashtu, është prezantuar moduli trajnues “Mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë gjatë lundrimit në internet”, i cili shërben si udhëzues për strukturat arsimore për të edukuar fëmijët mbi rreziqet digjitale dhe mënyrat e sigurt të sjelljes online. Në tërësi, këto ndërhyrje përfaqësojnë një angazhim të qëndrueshëm institucional për rritjen e kulturës digjitale dhe forcimin e mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve në internet, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe angazhimet ndërkombëtare.

Membështetjen e UNICEF-it dhe në bashkëpunim me stafet e NJVV-ve është realizuar shtrirja e modelit BiblioTech pranë bibliotekave të qytetit për aftësimin digjital dhe mbrojtjen *on-line* në Shkodër, Tiranë dhe Korçë. Është realizuar trajnimi i 100 stafëve të bibliotekave vendore dhe është hartuar kurrikula e aftësimit digjital pranë bibliotekave.

Në zbatim të planit të veprimit të “Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020-2025” AKSK-u ka kryer disa trajnime dhe fushata sensibilizuese për promovimin e të drejtave të fëmijëve në botën digjitale. AKSK-u është institucioni i parë që u angazhua për pilotimin e projektit global të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit dhe partneritetit me UNICEF Albania “Krijimi i një mjedisi digjital të sigurt dhe fuqizues për fëmijët”. 37 trajnime³⁷ (750 pjesëmarrës) janë realizuar në këtë kuadër me aktorët e industrisë, përfaqësues nga institucionet publike në 12 qarqe të vendit, nxënësit e shkollave 9-vjeçare të qyteteve Patos, Roskovec, Belsh, Divjakë, Librazhd, Mallakastër, Dimal, Përrenjas, Selenicë dhe Kuçovë si dhe prindërit dhe mësuesit e Shkollave të Mesme dhe 9 vjeçare në Babrru, Kamëz, Paskuqan, Vorë, Kavajë, Kukës, Shkodër, Has, Vau i Dejës, Fushë-Arrëz, Pukë, Tropojë, Dibër, Klos, Burrel, Bulqizë. AKSK me mbështetjen e UNICEF, ka hartuar

37. Informacion i detajuar nga trajnimet, gjendet në linkun: <https://cesk.gov.al/aktivitete/itu/Trajnime%20per%20sigurine%20ne%20internet.pdf>

Gjithashtu, rezultatet e trajnimeve dhe vlerësimi i impaktit për target-grupe të ndryshme, gjenden në linkun: shorturl.at/moEL9.

gjithashtu dy manualë edukues për fëmijët dhe mësuesit, me informacione mbi sigurinë e fëmijëve në internet. Gjithashtu, janë realizuar tri video ndërgjegjësuëse, të cilat janë publikuar në mediat sociale të autoritetit dhe më gjerë, duke arritur një audiencë prej 6000 përdoruesish unikë *on-line*.³⁸ AKSK-u ka hartuar gjithashtu, edhe një mesazh të unifikuar mbi kujdesin që duhet të kenë prindërit dhe fëmijët me shpërndarjen e të dhënave personale *on-line*.

Përgjatë vitit 2023-2024 Në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020–2025 dhe të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) ka ndërmarrë një sërë nismash për rritjen e ndërgjegjësimit dhe forcimin e kapaciteteve të aktorëve publikë, privatë, dhe komunitetit, për të garantuar një mjedis të sigurt online për fëmijët dhe të rinjtë. Një ndër projektet kyçe është “Creating a Safe and Prosperous Cyberspace for Children”, i zbatuar në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Telekomunikacionit (ITU) në periudhën 2021–2023. Ky projekt ka kontribuar në:

- Përgatitjen e Udhëzuesve Kombëtarë për Mbrojtjen e Fëmijëve Online,
- Organizimin e trajnimeve dhe ëorkshop-eve për sektorin publik, shoqërinë civile dhe sektorin privat,
- Krijimin e një rrjeti ndërinstitutional bashkëpunimi për sigurinë e fëmijëve në hapësirën digjitale.

Gjatë vitit 2023, AKSK organizoi trajnime për Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) në bashkitë Dibër, Klos, Tiranë dhe Lushnjë, duke adresuar tema si bullizmi online, ngacmimet seksuale dhe higjiena kibernetike. Në dhjetor 2023, u mbajt ëorkshop-i përmbyllës “Një dekadë ndërgjegjësimi për sigurinë online të fëmijëve”, me përfshirjen e përfaqësuesve nga sektori publik, privat dhe organizatat e shoqërisë civile, me fokus te roli i industrisë në garantimin e sigurisë online të fëmijëve. Gjatë vitit 2024, janë

realizuar 39 aktivitete, përfshirë 5 ëorkshop-e dhe 34 takime ndërgjegjësuëse në shkolla 9-vjeçare dhe të mesme në qytete të ndryshme. Janë ndërgjegjësuar 1,545 fëmijë, ndërsa 423 mësues dhe 174 oficerë sigurie në shkolla janë trajnuar për higjienën digjitale. Janë plotësuar 1,168 pyetësorë nga nxënësit për të vlerësuar perceptimin mbi sigurinë në internet. Gjithashtu, janë grumbulluar mbi 240 raportime për raste të bullizmit online dhe ngacmimeve digjitale, me qytetet Tiranë, Kuçovë, Kukës dhe Gjirokastrë si më të prekurat. Fëmijët janë inkurajuar të përdorin platformën zyrtare ëëë.aksk.gov.al për të raportuar rastet e abuzimit dhe për të kërkuar ndihmë. Këto ndërhyrje synojnë krijimin e një mjedisi digjital të sigurt dhe gjithëpërfshirës, ku fëmijët, prindërit dhe aktorët institucionalë bashkëpunojnë për një kulturë të qëndrueshme të sigurisë online.

Në vitin 2022, WVA-ja së bashku me partnerët lokalë (kryesisht stafe shkollore dhe profesionistë të NJMF-së në bashki) ka nxitur angazhimin e rreth 1210 fëmijëve dhe të rinjve në aktivitete ndërgjegjësuëse me qëllim parandalimin e rrezikut të shkaktuar nga përdorimi i internetit. Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të javës së internetit të sigurt.

Stafi psiko-social në shkolla e në zyrat arsimore përkatëse, punonjësit e mbrojtjes së fëmijës në bashkitë Kavajë, Selenicë, Shijak dhe Vaun e Dejës, kanë zhvilluar aktivitete psiko-sociale të ndryshme në lidhje me ndërgjegjësimin e fëmijëve mbi dhunën kibernetike, si edhe për një përdorim të sigurt të internetit.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) ka ndërmarrë një sërë masash për të garantuar raportimin etik dhe të ndjeshëm të mediave për çështjet që lidhen me fëmijët. Monitorimi ditor i mediave të shkruara, audiovizive dhe online ka mundësuar identifikimin dhe referimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të fëmijëve në raportimet mediatike, kryesisht për mungesë etike, ekspozim të panevojshëm, apo cenim të privatësisë së fëmijëve. Gjatë vitit 2023, janë referuar 9 raste të shkeljeve pranë Autoritetit

38. Video me këshilla për fëmijë: shorturl.at/klnP7; Video me këshilla për prindër dhe edukatorë: shorturl.at/hmël2; Video me këshilla për industrinë: shorturl.at/gkALO. ; Impakti i videove dhe rezultatet e fushatës *on-line*, janë publikuar në raportin: shorturl.at/erëHJ.

të Mediave Audiovizive (AMA), ndërsa në vitin 2024 janë evidentuar 10 raste, ku 8 janë raportuar tek AMA, që ka lëshuar vërejtje ndaj 9 televizioneve, dhe 2 raste janë ndjekur në mediat sociale nga ASHDMF. ASHDMF ka kontribuar gjithashtu me komente mbi Kodin e ri të Transmetimit, aktualisht në proces konsultimi, për të forcuar mbrojtjen e fëmijëve në raportimet mediatike.

- Per vitin 2025 ASHDMF ka reaportuar prane AMA tani 5 raste të shkeljeve pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA),
- Autoriteti i Mediave Audiovizive ka tërhequr vëmendjen (në 9 raste) për shkeljet e dispozitave të mësipërme, kërkoi ndalimin e çdo ritransmetimi të materialeve në fjalë si edhe fshirjen e tyre nga llogaritë përkatëse në YouTube dhe çdo prani tjetër online, duke rikujtuar se përsëritja e shkeljeve penalizohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- Për trajtimet pjesërisht korrekte (3 raste), Autoriteti u solli në vëmendje OSHMA-ve, se përpjekjeve për respektimin e standardeve etike të transmetimit u kishte shpëtuar publikimi i të dhënave rrethanore, që gjithashtu çon në identifikimin e tërthortë të viktimës.

Lidhur me ndërtimin e kapaciteteve, gjatë viteve 2021–2022, ASHDMF organizoi trajnimin e 150 gazetarëve dhe Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) në 10 bashki, me fokus në parimet e raportimit etik dhe mbrojtjen e të miturve nga ekspozimi në media. Rezultatet e këtyre ndërhyrjeve u prezantuan në Forumin Kombëtar për Median me temë “Roli i medias në raportimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve”, zhvilluar në bashkëpunim me AMA, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, dhe CRCA/ECPAT Albania.

AMA, në prill të vitit 2022, ka nisur procesin e rishikimit të kodit të transmetimit, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë mbrojtjes së fëmijëve përmes parandalimit të promovimit në emisione apo programe audio-vizive të dukurisë së bullizimit, abuzimit seksual, dhunës fizike e verbale, si dhe mbrojtjes së fëmijëve nga reklamat për produkte ushqimore të dëmshme dhe produktet e duhanit.

Në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar dhe

direktivat evropiane për mediat audiovizive, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) dhe Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) kanë forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional për të garantuar respektimin e të drejtave të fëmijëve në hapësirën mediatike. Në këtë kuadër është në proces hartimi një marrëveshje ndërinstitucionale që synon të konsolidojë angazhimet për zbatimin e etikës së raportimit dhe mbrojtjen e fëmijëve nga ekspozimi i papërshtatshëm audioviziv.

Ligji nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive”, i harmonizuar me direktivat e BE-së, si dhe Kodi i ri i Transmetimit (VKM nr. 60, datë 10.07.2023), përmbajnë një kapitull të posaçëm mbi mbrojtjen e fëmijëve, që ndalon identifikimin, ekspozimin, apo përfshirjen e tyre në përmbajtje që cenojnë dinjitetin, privatësinë dhe zhvillimin e tyre moral. Kodi përcakton gjithashtu detyrime për shënjat paralajmëruese, ndalimin e reklamave të dëmshme, dhe kriteret për përmbajtje edukuese dhe të përshtatshme për fëmijët. Në drejtim të ndërgjegjësimit publik, AMA ka ndërmarrë një sërë veprimtarish, përfshirë fushatën “Kompetencë mediatike për moshat parashkollore” në 20 kopshte të Tiranës, si dhe publikime të vazhdueshme informuese në rubrikën “Edukimi Mediatik” dhe rrjetet sociale. Për sa i përket trajnimit të gazetarëve, ASHDMF ka organizuar gjatë viteve 2021–2022 trajnime në 10 bashki me pjesëmarrjen e 150 gazetarëve dhe PMF-ve, me fokus raportimin etik të dhunës ndaj fëmijëve. Po ashtu, në bashkëpunim me CRCA/ECPAT, AMA dhe institucionet e linjës, është zhvilluar Forumi Kombëtar për Median, ku u prezantuan standardet dhe rekomandimet për forcimin e mbrojtjes së të miturve në media. Në vitin 2024, AMA ka trajtuar 55 ankesa që përfshijnë fëmijët në përmbajtjet mediatike, ndërsa 236 raste janë monitoruar nga Drejtoria e Monitorimit dhe Analizës. 34 prej tyre kanë përfunduar me masa ndaj OSHMA-ve për shkelje të lidhura me të miturit.

Gjithashtu për periudhën janar - nëntor 2025, Këshilli i Ankesave në AMA ka administruar 31 ankesa që kanë pasur si objekt interesin më të lartë të fëmijës. Në 2 raste është dhënë masë paralajmëruese/tërheqje vëmendje ndaj OSHMA-ve. Ndërsa nga Drejtoria e Monitorimit

dhe Analizës janë identifikuar 42 raste që kanë pasur si objekt interesin më të lartë fëmijës. Në 42 raste të trajtuara, 41 kanë rezultuar në tërheqje vëmendje ndaj OSHMA-ve dhe 1 prej tyre me sanksion me gjobë.

Gjatë vitit 2025, AMA ka intensifikuar përpjekjet për mbrojtjen e të miturve në hapësirën online, duke vendosur marrëveshje bashkëpunimi me platforma të mëdha ndërkombëtare, si Platforma X. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, me Platformën X u krijua një dritare e

dedikuar raportimi, e cila u vu në dispozicion të qytetarëve për të adresuar përmbajtje të dëmshme, përfshirë ato që rrezikojnë shëndetin, zhvillimin dhe integritetin moral e psikologjik të fëmijëve.

Vetëm gjatë periudhës gusht – tetor 2025, në Platformën X u raportuan 41 përmbajtje të dëmshme, ndër të cilat u evidentuan: 3 video për ekspozimin e fëmijëve ndaj pornografisë, narkotikëve, alkoolit, duhanit dhe dhunës.



TABELA 50. STATUSI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETEVE (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Nr. i masave	Nr. i aktiviteteve gjithsej	Nr. i aktiviteteve të raportuara	Përqindja e aktiviteteve të raportuara
3	12	12	100%



TABELA 51. STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

Statusi	Numri i statusit të aktiviteteve	Përqindja e statusit të aktiviteteve
Plotësisht i realizuar	9	75%
Pjesërisht i realizuar	2	17%
I porealizuar	1	8%






TABELA 52. SHPENZIMET SIPAS STATUSIT TË REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR, VLERË DHE PËRQINDJE)

Statusi	Nr. i aktiviteteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti shtetit	Partnerë
Plotësisht i realizuar	9	18,491,192	75.00%	18,491,192	100.00%	35.85%	64.15%
Pjesërisht i realizuar	2	4,191,337	17%	4,191,337	100.00%	35.85%	64.15%
I parealizuar	1	1,972,394	8%	1,972,394	100.00%	35.85%	64.15%

SHPENZIMET FINANCIARE

Objektivi specifik IV.1 përbëhet nga tri masa me gjithsej 12 aktivitete, prej të cilave 7 janë buxhetuar në dy plane të tjera. Për periudhën 2021–2026, plani i veprimit parashikonte që shpenzimet e planifikuara të mbulonin 83.7% të kostove treguese. Nga të dhënat e raportuara: 9 aktivitete janë realizuar plotësisht, me një buxhet të planifikuar prej 18,491,192 lekë (75% e totalit). Shpenzimet faktike janë realizuar në masën 100%, ku 35.85% janë mbuluar nga buxheti i shtetit dhe 64.15% nga partnerët. 2 aktivitete janë realizuar pjesërisht, me një buxhet të planifikuar prej 4,191,337 lekë (17% e totalit).

Edhe këto aktivitete kanë pasur realizim të plotë financiar (100%), me të njëjtën ndarje të burimeve (35.85% buxhet, 64.15% partnerë). 1 aktivitet nuk është realizuar, me një buxhet të planifikuar prej 1,972,394 lekë (8% e totalit). Në total, për periudhën 2021–2025 janë shpenzuar 100% e fondeve të planifikuara për aktivitetet e realizuara (plotësisht dhe pjesërisht). Ndarja e burimeve tregon se pjesa më e madhe e financimit ka ardhur nga partnerët (64.15%), ndërsa buxheti i shtetit ka kontribuar me 35.85%.



PROBLEMATIKAT E IDENTIFIKUARA

Çështjet e trajtuara në këtë kapitull, janë ato të raportuara si sfida nga institucionet raportuese të AKDF-së, si edhe problematika të raportuara në publikime të tjera. Çështjet lidhen gjithashtu me aktivitetet e parealizuara dhe janë të organizuara më poshtë sipas qëllimeve strategjike.

QEVERISJA E MIRË NË FUNKSION TË RESPEKTIMIT, MBROJTJES DHE PËRMBUSHJES SË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Qeverisja e mirë është një parakusht thelbësor për të garantuar respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijëve në të gjitha nivelet e administratës dhe sistemit të shërbimeve publike. Megjithatë Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional për të drejtat e fëmijëve, zbatimi efektiv i këtyre politikave mbetet një sfidë për shkak të një sërë faktorësh të ndërlidhur.

Mungesa e koordinimit të qëndrueshëm ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore, kapacitetet e kufizuara të profesionistëve që punojnë me fëmijët, dhe fragmentimi i përgjegjësisë ndërmjet sektorëve të ndryshëm pengojnë zhvillimin e një qasjeje të integruar dhe gjithëpërfshirëse për fëmijët. Buxheti i pamjaftueshëm dhe mungesa e planifikimit me në fokus fëmijët, veçanërisht ata nga grupet më të cenueshme, kontribuojnë në pabarazi të theksuara në aksesin ndaj shërbimeve dhe mundësive për zhvillim.

Sistemet e monitorimit dhe të vlerësimit të rezultateve për fëmijët janë ende në zhvillim e sipër, duke kufizuar aftësinë për të matur ndikimin real të politikave dhe për të mbajtur

institucionet përgjegjëse. Ndërkohë, pjesëmarrja e fëmijëve në proceset vendimmarrëse është ende e kufizuar dhe kërkon mekanizma më të fuqishëm që promovojnë zërin e tyre në nivel shkollor, komunitar dhe kombëtar.

Edhe pse ASHMDF-ja përfaqëson një nga institucionet kryesore përgjegjëse për monitorimin e realizimit të të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, ajo funksionon ende me strukturë të reduktuar dhe pse së fundmi struktura është shtuar me 2 staf që nga krijimi i saj. Kjo ka krijuar pengesë në përmbushjen e funksioneve, si edhe në realizimin e aktiviteteve të AKDF-së.

Edhe pse është miratuar udhëzuesi i pjesëmarrjes së fëmijëve, monitorimi i zbatimit etik të tij mbetet ende i papërmbytur. Për më tepër, mbetet e rëndësishme ngritja e mekanizmave të përshtatshëm në nivel qendror dhe vendor të përfshirjes kuptimplote të fëmijëve/adoleshentëve.

Fëmijët janë të prekur drejtpërdrejt nga efektet e ndryshimeve klimatike dhe të mjedisit. Ende nuk është hartuar raporti analitik i impaktit të ndryshimeve klimatike dhe të mjedisit të fëmijët në Shqipëri, edhe pse ka disa përpjekje të organizatave për të analizuar dhe për të përfshirë fëmijët në këto praktika. Zëri i fëmijëve në këtë proces është i rëndësishëm dhe do të duhet të konsiderohet në hapat në vijim të realizimit të këtij aktiviteti.

ELIMINIMI I TË GJITHA FORMAVE TË DHUNËS

Mungesa e zbatimit të plotë të ligjeve ekzistuese, stigmës shoqërore dhe mungesa e besimit të fëmijëve dhe familjeve në strukturat mbrojtëse çojnë shpesh në mosraportim apo në ndërhyrje të vonuar. Struktura të dobëta të shërbimeve ndërsektoriale dhe mungesë e shërbimeve të specializuara, veçanërisht në nivel vendor, kufizojnë mundësitë për mbështetje dhe rehabilitim të viktimave.

Përpjekjet për parandalim nuk janë të institucionalizuara dhe shpesh mbështeten në projekte afatshkurtra, ndërkohë që programet e edukimit për prindërimin pozitiv, ndërgjegjësimi publik, trajnimi i profesionistëve dhe përdorimi i të dhënave për vendimmarrje efektive mbeten të fragmentuara.

Mangësi janë evidentuar në ngritjen e programeve të edukimit të prindërve dhe fuqizimit të tyre. Nismat ekzistuese janë vetëm në disa NJVV dhe nuk janë të integruara në shërbime dhe mbështeten kryesisht përmes projekteve.

Edhe pse dispozitat ligjore për mbrojtjen e fëmijëve kërkojnë ekzistencën e një njësie për mbrojtjen e fëmijëve në çdo bashki dhe të paktën një punonjës të dedikuar për mbrojtjen e fëmijëve me kohë të plotë në nivel njësie administrative (për 3,000 fëmijë), kjo nuk është realizuar në të gjitha bashkitë. Ligji gjithashtu, kërkon që të gjitha PMF-të të kenë një përvojë në punën sociale. Në disa bashki, mbulimi i shërbimeve të njësisë për mbrojtjen e fëmijëve, bëhet ende nga punonjës që nuk janë të diplomuar në punë sociale ose që kryejnë edhe funksione të tjera. Punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve, kanë nevojë për trajnime të specializuara në mënyrë të vazhdueshme bazuar në module dhe programe të akredituara, e mbuluar kryesisht nga programet e organizatave/donatorëve. Ende nuk është dakordësuar kostimi i menaxhimit të rastit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve ende nuk ka përgatitjen e mjaftueshme për të trajtuar të gjitha format e ndryshme të dhunës ndaj fëmijëve. Profesionistët (nga shëndetësia, policia, arsimi,

institucione të tjera në kontakt me fëmijët), pjesë e grupeve teknike ndërsektoriale me rol të rëndësishëm për parandalimin, identifikimin, mbrojtjen, hartimin e planeve individuale të mbrojtjes dhe ofrimin e shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese, janë përfshirë pak në paketa të plota trajnuese për ofrimin e shërbimeve të integruara, duke përfshirë fëmijët viktimë të abuzimit seksual apo formave të tjera të dhunës, të vazhdueshme.

Me zhvillimin e teknologjisë dhe përdorimit të internetit, identifikimi dhe trajtimi i abuzimit dhe shfrytëzimit seksual në internet, vazhdon të jetë një çështje shqetësuese në Shqipëri. Është raportuar si problematik funksionimi i bashkëpunimit ndërsektorial me aktorë të linjës, si agjencitë rregullatore, sektori privat dhe industrial TIK, hetimi i efektshëm dhe ndëshkimi i autorëve të krimeve kibernetike ndaj fëmijëve. Mbetet më tepër për t'u realizuar ngritja e kapaciteteve të profesionistëve, prindërve, kujdestarëve, fëmijëve dhe të rinjve, parandalimi i abuzimit seksual të fëmijëve në internet nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe krijimit të hapësirave të sigurta për përdorimin e internetit, forcimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për rritjen e sigurisë së fëmijëve në internet, si dhe investime në zgjidhje teknologjike dhe miqësore ndaj fëmijëve.

Me ngritjen e dy shërbimeve të reja me një ndalesë në Qarkun Fier dhe Shkodër, si pjesë e strukturave të spitaleve rajonale, për trajtimin e rasteve të fëmijëve viktimë të abuzimit seksual dhe të formave të rënda të dhunës, janë shtuar shërbimet që u përgjigjen nevojave të menjëhershme të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Ka nevojë për më tepër përpjekje për ngritjen e shërbimeve të specializuara dhe të integruara ndërsektoriale për fëmijët e mbijetuar të abuzimit seksual dhe të formave të tjera të rënda të dhunës së gjatë në kohë.

SHËRBIMET MIQËSORE NDAJ FËMIJËVE DHE ADOLESHENTËVE

Nga raportimi vihet re se nuk janë realizuar masat që lidhen me hartimin dhe miratimin e metodologjisë së vlerësimit të kënaqësisë së ofrimit të shërbimeve për të gjitha kategoritë, veçanërisht ato me në qendër fëmijët.

Kostimi dhe financimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, mbetet ende një sfidë, kryesisht për pushtetin vendor.

Po kështu, raportohen sfida në ngritjen e strukturave të vlerësimit dhe referimit të nevojave (NJVNR) në çdo bashki sipas përcaktimit ligjor, si edhe në ngritjen e kapaciteteve të atyre ekzistuese.

Zbatimi i planit të deinsitucionalizimit, ka përfshirë deri tani ngritjen e dy shërbimeve të reja të mbështetjes së fëmijës dhe familjes në bashkitë Korçë dhe Vlorë, dhe është në proces shndërrimi i shërbimit rezidencial në shërbim komunitar, proces që po ndodh gradualisht.

Aftësimi i stafit pedagogjik për trajnimin e problemeve të shëndetit mendor, mbetet ende një shqetësim që ka nevojë të ndiqet në vazhdimësi.

Ngritja e kapaciteteve të përfaqësuesve proceduralë për menaxhimin e fëmijëve në konflikt me ligjin sipas përcaktimit ligjor, si edhe strukturave speciale për edukimin special për fëmijet në konflikt me ligjin dhe me sjellje deviante është një proces që ende nuk ka ndodhur, edhe pse janë caktuar përfaqësuesit proceduralë në nivel bashkie.

Ofrimi i programeve të drejtësisë restauruese dhe i ndërmjetësimit për fëmijët në konflikt me ligjin, ende është një praktikë që zbatohet kryesisht nga programet e organizatave/donatorëve, por jo me një qasje të unifikuar dhe të qëndrueshme.

FËMIJËT NË BOTËN DIGJITALE

Pavarësisht përparimeve në rregullimin institucional dhe ngritjen e kapaciteteve, sfidat kryesore mbeten:

- ▶ Vetëm 47% e shkollave kanë krijuar një infrastrukturë të përshtatshme për shfrytëzimin e TIK-ut në shkolla, procesi i ngritjes së infrastrukturës së TIK-ut në shkolla po përparon ngadalë.
- ▶ NJVV-të nuk kanë arritur të krijojnë hapësira publike të përmirësuara me internet të sigurt për fëmijët dhe familjet (qasja Friendly ËIFI). Krijimi i këtyre hapësirave të sigurta, ka nisur si një praktikë pozitive në disa bashki, por nuk është vijuar, duke zvogëluar mundësinë që fëmijët të kenë akses në internet falas, por dhe në informacion të filtruar dhe që promovon një mjedis të sigurt digjital.
- ▶ Krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për shfrytëzimin e TIK-ut në të gjitha shkollat e vendit, shtimi i SMARTLab-ëve dhe “laboratorëve” STEM, shoqëruar me trajnimin e stafit pedagogjik, është një nevojë në vazhdimësi.
- ▶ Mungesa e njohurive dhe kapaciteteve të aktorëve kyç për të identifikuar dhe menaxhuar rastet e abuzimit dhe rreziqeve online.
- ▶ Mungesa e shërbimeve të specializuara për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të abuzimit digjital.
- ▶ Nevoja për kuadër të përditësuar ligjor dhe mekanizma funksionalë të raportimit të shpejtë të përmbajtjeve të paligjshme.
- ▶ Pjesëmarrje e pamjaftueshme e vetë fëmijëve në diskutimet dhe politikat që lidhen me sigurinë në internet.



REKOMANDIME SPECIFIKE PËR FUSHAT E VEPRIMIT

MIRËQEVERISJA

- A. **Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe rolit koordinues të strukturave kombëtare dhe vendore**
 - ▶ Rritja e rolit dhe efektivitetit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në drejtimin strategjik dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave kombëtare për fëmijët, duke përfshirë monitorimin sistematik të Agjendës së fëmijëve.
 - ▶ Konsolidimi i Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës si një organ drejtues me rol udhëheqës për analizën e politikave dhe ofrimin e udhëzimeve teknike për institucionet ekzekutive dhe pushtetin vendor.
 - ▶ Në vijim të sugjerimeve të Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës dhe proceseve të "screening"-ut të BE-së, është i domosdoshëm rishikimi i Agjendës së të Drejtave të Fëmijëve përpara përfundimit të afatit aktual.
- B. **Zgjerimi i përdorimit të të dhënave për planifikim dhe vendimmarrje të bazuar në evidencë**
 - ▶ Përmirësimi i të dhënave administrative që raportojnë statistika mbi fëmijët, për të mundësuar raportim ndërsektorial dhe analizë të integruar të të dhënave nga sektorët e shëndetësisë, arsimit, drejtësisë dhe mbrojtjes sociale. Rritja e transparencës së publikimit dhe përdorimit të të dhënave.
 - ▶ Zgjerimi i fushës dhe cilësisë së statistikave zyrtare – nga burimet administrative dhe anketat, të publikuara nga INSTAT, për të mundësuar matjen e ndikimit të politikave për fëmijët.
- C. **Fuqizimi i qeverisjes vendore dhe decentralizimit të kompetencave për fëmijët**
 - ▶ Rritja e autonomisë së bashkive për të zhvilluar plane vendore të veprimit për të drejtat e fëmijëve, të bazuara në nevoja të identifikuara përmes konsultimit me komunitetin dhe grupet vulnerabël.
 - ▶ Sigurimi i burimeve të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për bashkitë për zbatimin e përgjegjësisë të tyre në fushën e mbrojtjes dhe zhvillimit të fëmijës.
- D. **Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe shoqërisë civile në vendimmarrje**
 - ▶ Krijimi i platformave të qëndrueshme për konsultim me fëmijët në nivel kombëtar dhe lokal, duke siguruar që zëri i tyre të jetë i përfshirë në zhvillimin e politikave që ndikojnë jetën e tyre.
 - ▶ Mbështetja e organizatave të shoqërisë civile për të kontribuar në monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të të drejtave të fëmijëve, nëpërmjet mekanizmave të pavarur të mbikëqyrjes.

E. **Forcimi i kuadrit ligjor dhe institucional për të drejtat e fëmijës**

- ▶ Vlerësimi dhe harmonizimi i legjislacionit kombëtar me instrumentet ndërkombëtare, përfshirë Konventën për të Drejtat e Fëmijës, për të adresuar boshllëqet në mbrojtje dhe akses në drejtësi për fëmijët.
- ▶ Zbatimi i mekanizmave të monitorimit ndërkombëtar (p.sh. raportet periodike ndaj Komitetit për të Drejtat e Fëmijës të OKB-së) si mjete për përmirësimin e politikave kombëtare.

ELIMINIMI I DHUNËS

Për të garantuar një mbrojtje efektive dhe të gjithanshme të fëmijëve nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi, është e nevojshme të ndërmerren hapa të mëtijshëm në forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional si dhe në zhvillimin e kapaciteteve ndërsektoriale:

A. **Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor ekzistues përmes:**

- ▶ Rishikimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 578, "Për menaxhimin e rastit", bazuar në analizat e zbatimit praktik dhe nevojën për të reflektuar sfidat dhe përmirësimet e identifikuar.

- ▶ Rishikimi i VKM-së nr. 111, "Për procedurat dhe rregullat për kthimin dhe riatdhesimin e fëmijës", për të garantuar një qasje më të ndjeshme ndaj nevojave të fëmijëve të riatdhesuar.

B. **Zhvillimi i instrumenteve të reja nënligjore dhe marrëveshjeve ndër-institucionale, për të lehtësuar bashkëpunimin efektiv dhe ndërhyrjen në kohë:**

- ▶ Hartimi i një udhëzimi të posaçëm për njoftimin dhe heqjen e materialeve të paligjshme dhe të dëmshme që lidhen me abuzimin seksual dhe shfrytëzimin e fëmijëve online.
- ▶ Nënshkrimi i një marrëveshjeje ndërminstrore për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në situata të cënueshme, në

përputhje me VKM-në nr. 129, duke fuqizuar ekipet e terrenit për identifikimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve.

C. **Fuqizimi i shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor:**

- ▶ Sigurimi i punësimit të Punonjësve të Mbrojtjes së Fëmijëve në përputhje me kriteret ligjore dhe mbështetja e tyre përmes mentorimit dhe trajnimeve të vazhdueshme.
- ▶ Rritja e buxheteve vendore për të garantuar menaxhim të qëndrueshëm dhe efektiv të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

D. **Përforsimi i kapaciteteve të profesionistëve të linjës së parë:**

- ▶ Trajnimi i mësuesve, psikologëve, punonjësve socialë dhe stafit shëndetësor për të identifikuar, raportuar dhe menaxhuar rastet e dhunës.
- ▶ Rritja e kapaciteteve për strukturat e zbatimit të ligjit, përfshirë policinë, prokurorinë dhe gjyqësorin, në trajtimin e rasteve të abuzimit dhe shfrytëzimit seksual, përfshirë ato online, në bashkëpunim me institucionet përkatëse të trajnimit si Shkolla e Magjistraturës dhe Akademia e Sigurisë.

E. **Krijimi i shërbimeve të specializuara dhe ndërtimi i mekanizmave ndërsektorialë për rehabilitim:**

- ▶ Ngritja/zgjerimi i hartës së shërbimeve me bazë komunitare dhe familjen për fëmijë, si dhe i shërbimeve të specializuara me qasje multidisiplinare për trajtimin dhe riintegrimin e fëmijëve viktimë të dhunës seksuale dhe formave të tjera të rënda të dhunës.

- ▶ Hartimi dhe zbatimi i një protokollit ndër-institucional për menaxhimin e rasteve të tilla, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve të përfshirë.

F. **Forcimi i mekanizmave të raportimit dhe mbikëqyrjes:**

- ▶ Zhvillimi dhe forcimi i sistemit referimit nepermjet protokolleve të unifikuara ndërsektoriale dhe ndër-institucionale nepermjet psikologut-punonjesit social-police dhe shërbimet psikosociale

promovimi i mekanizmave konfidencialë të raportimit në shkolla dhe komunitet.

- ▶ Monitorimi sistematik i rasteve të dhunës dhe përfshirja e fëmijëve në vlerësimin e sigurisë së ambientit të tyre.
- ▶ Rritje e bashkëpunimit ndërinstitucional shkolla-policia-shërbimi social-gjykatat
- ▶ Forcimi i politikave kundër dhunës në shkollat e edukimit special për fëmijët dhe adoleshentet me aftësi të kufizuara
- ▶ Forcimi i monitorimit në qendrat e shërbimit për fëmijët me aftësi të kufizuara

SHËRBIMET MIQËSORE

A. Qeverisje, financim dhe llogaridhënie

- ▶ Krijimi i linjave buxhetore të dedikuara për fëmijët në nivel qendror e vendor dhe rritja graduale e Fondeve Sociale; vendosja e objektivave vjetore të shpenzimit për shërbime për fëmijë.
- ▶ Institucionalizimi i një mekanizmi ndërsektorial për koordinim, planifikim dhe raportim (arsimi, shëndetësia, drejtësia, policia, shërbimet sociale) me matrica të përbashkëta treguesish.
- ▶ Publikimi periodik i një "Child Budget Brief" kombëtar dhe vendor, me analiza të shpenzimeve miqësore për fëmijët.

B. Shërbimet sociale & deinstitutionalizimi

- ▶ Shtrirja territoriale e shërbimeve komunitare (ditore, familjare, emergjente) për fëmijë me standarde të unifikuara dhe rritja e financimit të tyre, nëpërmjet fondit social; kontraktim social konkurrues dhe i qëndrueshëm mes OSHC dhe NJVV), duke respektuar procedurat e prokurimit të shërbimeve sociale
- ▶ Përsheptimi i deinstitutionalizimit, përfshirë fëmijët me AK, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të planit të transformimit të buxhetuar të shërbimeve rezidenciale në shërbime mbështetëse të kujdesit alternativ,

si dhe marrja e masave për zbatimin e tij, brenda vitit 2026

- ▶ Gradualisht do të realizohet edhe transformimi i tre institucioneve rezidenciale publike të grupmoshës 6-15 vjeç në Shtëpi Familje. Ky proces do të fillojë me Shtëpinë e Fëmijës "Zyber Hallulli" me grupmoshë 6-15 vjeç, deri në fund të vitit 2026.

C. Kujdestaria, kujdesi alternativ & prindërimi pozitiv

- ▶ Krijimi i një shërbimi kombëtar të kujdestarisë: standarde, procedura vlerësimi, trajnime/mbikëqyrje, paketa mbështetëse dhe kontroll cilësie.
- ▶ Program kombëtar për prindërimin pozitiv, i integruar në qendrat shëndetësore, shkolla dhe shërbime sociale; certifikim i profesionistëve.

D. Zhvillimi i fëmijërisë së hershme & arsimit

- ▶ Mbështetje e monitorimit të parashkollorit dhe zbatimit të kurrikulës 5-6 vjeç me plane të detajuara, buxhetime të përbashkëta qendër-vend.
- ▶ Tarifim i diferencuar për parashkollorin për fëmijët vulnerabël; zgjerim i mbështetjes financiare (bursa, transport, tekste) dhe programeve pas-shkollore në shkollat me përqendrim komunitetesh rom/egjiptian.
- ▶ Rritje progresive e mësuesve ndihmës, klasa burimore dhe akomodime të arsyeshme për fëmijët me AK; objektiva raporti fëmijë/mësues ndihmës sipas standardeve.

E. Shëndeti & shëndeti mendor

- ▶ Zgjerim i shërbimeve shkollore dhe komunitare (psikologë, linja mbështetje, programe për shëndetin mendor) me financim të dedikuar.
- ▶ Zbatimi i ndërhyrjeve të bazuara në shkollë për ushqyerjen e shëndetshme, aktivitetin fizik, imazhin e trupit dhe mirëqenien mendore; standarde ushqimi në kantina.

F. Drejtësia miqësore për fëmijët

- ▶ Buxhetim i mjaftueshëm për kuadrin e

drejtësisë për fëmijë; zgjerim i drejtësisë restauruese dhe masave alternative për shmangie nga procedimi penal (MD).

- Standardizim, certifikim dhe licencim i profesionistëve (magjistratë, policë, psikologë/punonjës socialë, avokatë, ndërmjetësues) për çështje të fëmijëve.
- Infrastrukturë miqësore në komisarate/gjykata për intervistim sipas standardeve; protokolle një-ndërhyrje.
- Ndihmë juridike falas e aksesueshme dhe proaktive për shkelje të të drejtave të fëmijëve.

G. Sistemet e të dhënave & SMIP

- Funksionalizim i plotë i SMIP si bazë unike për pjesëmarrjen, cilësinë, braktisjen, AK dhe rezultatet e të nxënësve; interoperabilitet me bazat sociale/shëndetësore; raportim i disagreguar (moshë, gjini, etni, AK, status ekonomik).
- Popullim sistematik i databazave të drejtësisë për fëmijë për gjurmim rastesh në të gjithë zinxhirin.

H. Mbrojtja në mjedisin digjital

- Zbatim i një programi kombëtar të sigurisë online: edukim digjital për fëmijë/prindër/mësues; kapacitete për identifikim e referim të shpejtë të abuzimit/shfrytëzimit online; bashkëpunim me ISP/platformat.

I. Barazia dhe përfshirja

- Targetim aktiv i fëmijëve romë/egjiptianë, fëmijëve në varfëri dhe fëmijëve në zonat rurale: paketa mbështetëse, mentorim, ndërhyrje komunitare, parandalim i braktisjes.
- Mekanizma të pjesëmarrjes së fëmijëve në politikë-bërje dhe monitorim (këshilla të fëmijëve, anketa periodike, auditime miqësore për fëmijët).

J. Migracioni & fëmijët e huaj të pashoqëruar (UASC)

- Standardet dhe shërbimet e specializuara për UASC/të ndarë: pritje, vlerësim i interesit më të mirë, kujdes alternativ i përshtatshëm, kujdestari profesionale, integrim/riintegrim.
- Protokolle ndërkufitare dhe ndër-agjencie për referim, mbrojtje dhe mbikëqyrje.

FËMIJËT NË BOTËN DIGJITALE

A. Akses dhe barazi

- Zgjerimi i hapësirave publike digjitale të sigurta për fëmijët dhe familjet, përmes partneriteteve publike–private, duke ofruar internet falas, të filtruar dhe të përshtatur për moshën.
- Sigurimi i pajisjeve dhe lidhjes me internet për fëmijët nga familje vulnerabël dhe zonat rurale, si pjesë e programeve të mbështetjes sociale dhe arsimore.

B. Siguria dhe mbrojtja online

- Zhvillimi i një Strategjie Kombëtare për Sigurinë Online të Fëmijëve, me masa për parandalimin e abuzimit/shfrytëzimit digjital, bashkëpunim me ISP, platformat sociale dhe policinë e shtetit.
- Forcimi i mekanizmave të raportimit dhe referimit të shpejtë për rastet e abuzimit online (linja të dedikuara, aplikacione, bashkëpunim me platforma ndërkombëtare).

C. Edukimi dhe ndërgjegjësimi

- Integrimi i kompetencave digjitale dhe sigurisë online në kurrikulën parauniversitare, duke përfshirë edhe edukimin mediatik dhe kundër dezinformimit.
- Organizimi i fushatave kombëtare ndërgjegjësuere për prindërit, mësuesit dhe profesionistët e fushës sociale mbi zhvillimin digjital të fëmijëve dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre aktive.

- Krijimi i materialeve miqësore për fëmijët (video, aplikacione, lojëra) që nxisin përdorim të sigurt, krijues dhe edukativ të internetit.

D. Pjesëmarrja e fëmijëve

- Përfshirja e këshillave të fëmijëve dhe grupeve rinore në hartimin e politikave digjitale dhe strategjive për sigurinë online
- Organizimi i forumeve kombëtare e lokale të fëmijëve për mjedisin digjital, ku fëmijët shprehin sfidat dhe idetë e tyre për përdorim më të sigurt dhe gjithëpërfshirës.

SHTOJCA

SHTOJCA A. LISTA E INSTITUCIONEVE TË PËRFSHIRA NË RAPORTIM

Institucione në nivel qendror:

1. Ministria e Drejtësisë
2. Ministria e Arsimit
3. Ministria e Brendshme
4. Ministria e Financave
5. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
6. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
7. Instituti i Statistikave të Republikës së Shqipërisë
8. Avokati i Popullit
9. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
10. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
11. Autoriteti i Mediave Audiovizive
12. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
13. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
14. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike
15. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Femijes
16. Sherbimi Social Shtetëror
17. Instituti i Shëndetit Publik

Institucione në nivel vendor:

1. Bashkia Tiranë
2. Bashkia Durrës
3. Bashkia Shkodër
4. Bashkia Vlorë
5. Bashkia Korçë
6. Bashkia Dibër
7. Bashkia Berat
8. Bashkia Gjirokastrë
9. Bashkia Kamëz
10. Bashkia Lushnjë
11. Bashkia Pogradec
12. Bashkia Krujë
13. Bashkia Sarandë
14. Bashkia Malësi e Madhe
15. Bashkia Divjakë
16. Bashkia Vau Dejës
17. Bashkia Cërrik
18. Bashkia Shijak
19. Bashkia Patos
20. Bashkia Devoll
21. Bashkia Librazhd
22. Bashkia Dimal
23. Bashkia Mallakastër
24. Bashkia Finiq
25. Bashkia Vorë
26. Bashkia Mat
27. Bashkia Mirditë
28. Bashkia Selenicë
29. Bashkia Belsh
30. Bashkia Prrenjas
31. Bashkia Dropull
32. Bashkia Has
33. Bashkia Klos
34. Bashkia Delvinë
35. Bashkia Poliçan
36. Bashkia Konispol
37. Bashkia Pustec
38. Bashkia Kukës
39. Bashkia Tropojë
40. Bashkia Maliq
41. Bashkia Himarë
42. Bashkia Skrapar
43. Bashkia Lezhë
44. Bashkia Fushë-Arrëz
45. Bashkia Rrogozhinë
46. Bashkia Fier
47. Bashkia Peqin
48. Bashkia Memaliaj
49. Bashkia Kavajë
50. Bashkia Kuçovë
51. Bashkia Elbasan

